Ylber Sela
Jeton Shasivari
Argëtim Saliu
Jusuf Zejneli
Valbona Hajretin
Llazo Matovski

GJUHA SHQIPE PARA DHE PAS MIRATIMIT TË LIGJIT TË PËRDORIMIT TË GJUHËVE TË VITIT 2019

Shkup, 2021

GJUHA SHQIPE PARA DHE PAS MIRATIMIT TË LIGJIT TË PËRDORIMIT TË GJUHËVE TË VITIT 2019

Prof. dr. Ylber Sela,
drejtor i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së RMV-së

Prof. dr. Jusuf Zejneli,
ligjërues në Fakultetin Juridik - Universiteti i Tetovës

Prof. dr. Jeton Shasivari,
ligjërues në Fakultetin Juridik - Universiteti i Evropës Juglindore – Tetovë

Dr. Valbona Hajretin,
Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

Doc. dr. Argëtim Saliu,
ligjërues në Fakultetin e Shkencave Sociale – Universiteti "Nënë Tereza" – Shkup

Mr. Llazo Matovski,
udhëheqës i Sektorit të mbështetjes së drejtorit – Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

Botues:

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së

Recensentë:

Prof. dr. Adnan Jashari

Prof. dr. Izer Maksuti

Prof. dr. Nuri Bexheti

Lektorë:

Ahmet Selmani

Nebi Bilalli

Realizimi teknik dhe dizajni:

Lirim Shabani

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека “Св. Климент Охридски”, Скопје

81’272:340.132(091)
342.725(497.7)
81’272:[005.57:35.075(497.7)

GJUHA shqipe para dhe pas miratimit të ligjit të përdorimit të gjuhëve të vitit 2019 : punimet e konferencës / Konferenca shkencore ndërkombëtare për ditën ndërkombëtare të gjuhës amtare. - Shkup :
Agjencia e zbatimit të gjuhës e RMV-së, 2021. - 184 стр. ; 25, Тираж: 300
Фусноти кон текстот. - Библиографија: стр. 172-178. - Содржи и: Shtojca

ISBN 978-608-4915-06-5

а) Закон за употреба на јазиците -- Историски осврти -- Македонија -- Истражувања б) Закон за употреба на јазиците -- Употреба -- Македонија -- Истражувања в) Употреба на јазици -- Административна комуникација -- Македонија -- Истражувања
COBISS.MK-ID 55418373

Përmbajtja

I. Parathënie 6

II. Aktualiteti i studimit 7

III. Objekti i hulumtimit 8

IV. Korniza kohore 10

KREU I PARË

RENDET KUSHTETUESE DHE TË DREJTAT GJUHËSORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE NDËR VITE 12

1. Hyrje e shkurtër 12

2. Kushtetuta për organizimin e ardhshëm shtetëror të Maqedonisë të vitit 1880 dhe dizajni i shtetit multietnik 20

3. Kushtetuta e Republikës Populllore të Maqedonisë e vitit 1946 dhe të drejtat gjuhësore dhe kulturore të shqiptarëve 23

4. Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë e vitit 1963 dhe të drejtat gjuhësore dhe kulturore të shqiptarëve 27

5. Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë e vitit 1974 dhe të drejtat gjuhësore dhe kulturore të shqiptarëve 31

6. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e vitit 1974 dhe të drejtat gjuhësore e kulturore të shqiptarëve 41

KREU I DYTË

TË DHËNA EMPIRIKE MBI REALIZIMIN E TË DREJTAVE GJUHËSORE DHE KULTURORE TË SHQIPTARËVE 1946-2001 49

1. Të dhëna për realizimin e të drejtave gjuhësore dhe kulturore sipas zgjidhjeve kushtetuese të vitit 1946 49

2. Të dhëna për realizimin e të drejtave gjuhësore dhe kulturore sipas zgjidhjeve kushtetuese të vitit 1963 51

3. Të dhëna për realizimin e të drejtave gjuhësore dhe kulturore sipas zgjidhjeve kushtetuese të vitit 1974 58

4. Institucionet më të rëndësishme arsimore dhe kulturore, gazetat dhe shoqëritë kulturore dhe artistike që kanë gëzuar të drejtën për t'u shprehur në gjuhën shqipe gjatë viteve në Maqedoni 68

4. 1 Gazeta "Flaka e vëllazërimit" 68

4. 2 Shkolla Fillore Komunale "Liria", Çair-Shkup 70

4. 3 Gjimnazi "Zef Lush Marku" – Shkup 71

4. 4 Fakulteti Pedagogjik "Shën Klementi i Ohrit" – Shkup 73

4. 5 Radiotelevizioni i Maqedonisë – RTVM 74

4. 6 Universiteti i Tetovës 76

4. 7 Universiteti i Europës Juglindore 77

4. 8 Universiteti "Nënë Tereza" - Shkup 78

4. 9 Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup 79

4. 10 SHM "Kiril Pejçinoviq" – Tetovë 80

4. 11 SHF "Rexhep Voka" – Shipkovicë, Tetovë 82

4. 12 SHF "Përparimi" - Reçicë e Madhe, Tetovë 82

4. 13 SHF "Tefejjuz" - Çair, Shkup 83

4. 14 SHF "Liria" - Tetovë 83

4. 15 Shkolla e Mesme "Hajdar Dushi" – Ladorisht, Strugë 84

4. 16 Teatri Shqiptar - Shkup 85

4. 17 Teatri i Tetovës - Tetovë 87

4. 18 SHKA "Xheladin Zeqiri" - Tetovë 87

4. 19 Ansambli "Ibe Palikuqi" - Shkup 88

4. 20 Ansambli "Emin Duraku" - Shkup 88

5. Marrëveshja Kornizë e Ohrit dhe shteti multietnik 89

6. Të drejtat gjuhësore dhe kulturore të shqiptarëve nëpërmjet prizmit të amendamenteve kushtetuese të vitit 2001 92

KREU I TRETË

STATUSI I GJUHËS SHQIPE DE JURE DHE KONTESTIMET KUSHTETUESE TË TIJ 103

1. Korniza ligjore dhe institucionale e Ligjit të Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale të vitit 2008 dhe 2011, me referencë të veçantë për vetëqeverisjen lokale 103

2. Propozimi, debatimi, miratimi dhe hyrja në fuqi e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019 127

3. Përmbajtja e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019 133

4. Analiza e aspekteve ligjore të kontestimeve kushtetuese të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019 në dritën e praktikës gjyqësore- kushtetuese dhe të së drejtës kushtetuese krahasimore 146

4. 1 Për kontestimet e pretenduara procedurale të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019 146

4. 2 Për kontestimet e pretenduara materiale të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019 153

4. 3 Vetoja presidenciale në të drejtën kushtetuese krahasimore 162

VËREJTJE PËRFUNDIMTARE 170

LITERATURA E PËRDORUR 172

SHTOJCAT

SHTOJCA 1. 179

SHTOJCA 2 182

SHTOJCA 3 184

I. Parathënie

Në kuadër të procesit të monitorimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019 është bërë studim shkencor (profesional) mbi nivelin e zbatimit të këtij ligji. Studimi përfshin punën kërkimore, rishikimin e akteve ligjore që rregullojnë çështjet në këtë fushë e cila përfshin qeverisjen qendrore dhe lokale. Në të njëjtën kohë, studimi ofron një analizë të hollësishme të gjendjes, të nevojës, të cilësisë dhe të përgjegjësisë së rregullave ligjore si pjesë thelbësore e këtij procesi të mundimshëm dhe të gjatë. Duke u nisur nga dokumentet kushtetuese, të drejtat e pjesëtarëve të komuniteteve rregullohen në këtë çështje, duke filluar nga *"Deklarata e KAÇKM-së për të drejtat themelore të qytetarit të Maqedonisë demokratike të vitit 1944"*, Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e vitit 1991, Marrëveshja Kornizë e Ohrit e deri te Ligji i Përdorimit të Gjuhëve. Prandaj, qëllimi i hulumtimit është *forcimi i demokracisë dhe i të drejtës së përdorimit të gjuhës, si dhe aftësimi i qytetarëve dhe përfaqësuesve të tyre të zgjedhur për të luajtur një rol aktiv në krijimin dhe zbatimin e politikave në nivel lokal, domethënë në vendosjen e çështjeve me interes lokal.* Suksesi i këtij studimi po dëshmon gjendjen reale në zbatimin e kushtetutës dhe rregullave ligjore, përdorimin e gjuhëve, gjegjësisht në çfarë mase i plotëson kërkesat e qytetarëve në nivel qendror dhe lokal.

Pra, në procesin e zbatimit dhe funksionimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019 në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, gjuha zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Një gjuhë tjetër që flitet së paku nga 20% e qytetarëve (gjuha shqipe) dhe alfabeti i saj, gjithashtu është gjuhë zyrtare. Me miratimin e këtij ligji në të gjitha organet shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj, gjuhë zyrtare është edhe ajo që e flasin 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, pra gjuha shqipe dhe alfabeti i saj, pavarësisht nëse kemi të bëjmë me pushtetin qendror ose me atë lokal.

Qëllimet përfundimtare të këtij studimi janë sqarimi i pozicionit, i funksionit dhe i kuptimit të gjuhës shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019[1].

II. Aktualiteti i studimit

Me zbatimin e procesit të përdorimit të gjuhëve zyrtare, Ligji i Përdorimit të Gjuhëve i vitit 2019 (në tekstin e mëtejmë: LPGJ) u bë mjet lehtësues në njësitë e vetëqeverisjes lokale. Sipas këtij ligji (LPGJ), organet e njësive të vetëqeverisjes lokale janë përgjegjëse për administrimin dhe menaxhimin e përdorimit të gjuhëve dhe të alfabeteve që përdoren nga të paktën dhe më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale.

Sigurisht, përdorimi i gjuhëve është një shoqërues i domosdoshëm i funksionalitetit, nëse synojmë një vetëqeverisje lokale efikase dhe efektive. Kjo është e pamundur pa bashkëpunimin dhe mbështetjen e pushtetit qendror dhe atij lokal. Sidoqoftë, nuk duhet harruar se përdorimi i gjuhës doli në pah në vitin 2019 me krijimin e Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së. Neni 18 i LPGJ-së është një bazë legjislative për themelimin e kësaj agjencie, fushëveprimi i punës dhe kompetencat e së cilës përcaktohen hollësisht në nenin 19, paragrafi (1), nënparagrafi 1-7) të ligjit. Arritja e qëllimeve të LPGJ-së, të cilat synojnë promovimin, mbrojtjen dhe zbatimin e njëtrajtshëm të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe alfabetin e saj, ligjvënësi ia delegoi Agjencisë, arritja e së cilës lidhet me suksesin e procesit të standardizimit dhe të përdorimit të njëtrajtshëm të gjuhës dhe të alfabetit të saj si kompetencë e entitetit institucional të sapoformuar. Në këtë aspekt, është e rëndësishme të theksohet se zbatimi i plotë dhe i qëndrueshëm i zgjidhjes së re ligjore nuk do të ishte i realizueshëm pa siguruar supozime ligjore për mbikëqyrjen dhe monitorimin e zbatimit të LPGJ-së, duke rezultuar në krijimin e një "lojtari" tjetër institucional shtesë - Inspektorati

1 Prof. dr. Ylber Sela, drejtori i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës të RMV-së.

i Përdorimit të Gjuhëve, kompetencat e të cilit, organizimi i inspektimit dhe i procedurave të inspektimit, rregullohen me ligj të veçantë (Ligji i Inspektoratit të Përdorimit të Gjuhëve).

Zbatimi i suksesshëm i LPGJ-së në Republikën e Maqedonisë së Veriut është një detyrim që rrjedh nga ndryshimet kushtetuese përkatësisht amendamentet IV, V, VI, VIII, XVI, XVII, XVIII dhe Marrëveshja Kornizë e Ohrit e vitit 2001. Sidoqoftë, nuk duhet të harrojmë se *reformat ligjore në Republikën e Maqedonisë së Veriut përballen me problemet e zakonshme, që janë karakteristike për reformat komplekse të cilat janë të rregullta në një situatë të vështirë ekonomike, e cila është nën presion shtesë, të shkaktuar nga kriza globale ekonomike dhe shëndetësore*[2].

Ky punim do të mundësojë studimin e gjendjes reale dhe aktuale të gjuhës shqipe para dhe pas Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019. Në fakt, qëllimi është të jepet një kritikë reale, si dhe një analizë e situatës faktike të këtij procesi në Maqedoninë e Veriut, duke filluar nga viti 1944 deri në vitin 2021, duke mbuluar kornizën ligjore e institucionale të rendit kushtetues, zhvillimit, organizimit, funksionimit të pushtetit qendror dhe atij lokal në zbatimin e gjuhës shqipe, duke analizuar situatën nga aspekti juridik dhe faktik. Pa dyshim, në këtë studim analizohet, jo vetëm korniza kushtetuese dhe ligjore, por edhe harmonizimi i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve me standardet dhe dokumentet europiane, si dhe të drejtën kushtetuese krahasuese. Në të njëjtën kohë u identifikuan arsyet, që sollën në nismën e përdorimit të gjuhës shqipe dhe marrëdhëniet dhe problemet u analizuan nga organet e pushtetit qendror dhe atij lokal.

III. Objekti i hulumtimit

Objekt hulumtimi i këtij studimi është zbatimi i gjuhës shqipe, si një proces kompleks shkencor, juridik, sociologjik, politik dhe administrativ, në nivel kombëtar,

2 Dr. Hajretin B. Pjesë e disertacionit të doktoratës "Decentralizimi në Republikën e Maqedonisë: ndërmjet normës dhe të vërtetës", Shkup, 2020, fq: 6

si dhe përcaktimi i mospërputhjes midis normativit dhe reales. Sigurisht, Ligji i Përdorimit të Gjuhëve, në këtë rast të gjuhës shqipe, analizohet nëpërmjet një prizmi kronologjik duke u njohur me të vërtetën dhe situatën reale të këtij procesi të zbatimit nga niveli qendror dhe ai lokal në kohë dhe qeverisje të ndryshme. Me studimin në fjalë bëhet përpjekje për t'u regjistruar shkalla e përparimit në procesin e zbatimit të gjuhës shqipe në Republikën e Maqedonisë së Veriut, problemet me të cilat përballen autoritetet shtetërore dhe lokale në këtë drejtim, si dhe ndikimin e gjuhës shqipe në përdorimin institucional në nivelin qendror dhe atë lokal.

Gjatë përgatitjes së këtij studimi është analizuar legjislacioni nacional, dokumentet nga Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut, Sekretariati i Përgjithshëm i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, kushtetutat e viteve 1946, 1963, 1974 dhe 1991, Marrëveshja Kornizë e Ohrit, vendimet e Gjykatës Kushtetuese, të dhënat nga institucionet, organizatat, shoqëritë kulturore dhe artistike që kontribuan në përdorimin e gjuhës, komunitetet që jetojnë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu për nevojat e këtij studimi janë realizuar edhe pyetësorë anketues nga Agjencia e Zbatimit të Gjuhës dhe është monitoruar progresi i institucioneve qendrore dhe atyre lokale për zbatimin e LPGJ-së. Studimi përfshin një kornizë kohore nga periudha e KAÇKM-së nga viti 1944 deri në vitin 2021.

Në përgjithësi, studimi shtjellon zbatimin e gjuhës shqipe në vendin tonë, rendin kushtetues, zbatimin e gjuhës shqipe. Ky studim ndahet në dy pjesë. Pjesa e parë e studimit analizon: Rendin kushtetues dhe gjuhën shqipe ndër vite; Kushtetutën e Republikës Popullore të Maqedonisë të vitit 1946; Kushtetutën e Republikës Socialiste të Maqedonisë të vitit 1963; Kushtetutën e Republikës Socialiste të Maqedonisë të vitit 1974; Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë të vitit 1991 lidhur me gjuhën shqipe. Studimi i referohet, gjithashtu, Kushtetutës së

Republikës së Maqedonisë të vitit 1991, Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe gjuhës shqipe. Pastaj gjuha shqipe vazhdon nëpërmjet prizmit të ndryshimeve kushtetuese të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë të vitit 2001. Analizë e veçantë jepet sipas amendamentit IV, amendamentit V, amendamentit VI, amendamentit VIII dhe amendamentit XVI.

Pjesa e dytë e studimit shtjellon statusin e gjuhës shqipe në aspektin normativ. Kjo pjesë fillon me kornizën ligjore dhe institucionale të Ligjit të Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale të vitit 2008. Më pas, organizimi territorial i njësive të vetëqeverisjes lokale dhe gjuha shqipe, Ligji i Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019 dhe gjuha shqipe, si dhe grupi punues ndërministror për zbatimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve. Studimi vazhdon me Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019 - përdorimi i gjuhës shqipe në nivel lokal (studim empirik) dhe, së fundmi, e gjithë kjo përmblidhet në dritën e realitetit dhe ideve në zbatimin e gjuhës shqipe. Në të njëjtën kohë, studimi analizon komunikimin midis pushtetit qendror dhe atij lokal. Njëkohësisht u paraqitën mendime, analiza, vlerësime dhe sugjerime për zbatimin më të suksesshëm të gjuhës shqipe, në përputhje me standardet e legjislacionit vendas. Qëllimi praktik i studimit është të propozojë hapa konkretë për intensifikimin e procesit të zbatimit të gjuhës shqipe në vendin tonë.

IV. Korniza kohore

Gjuha shqipe para dhe pas miratimit të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të 2019-ës, në një periudhë prej 75 vjetësh, nga 1946 deri në 2021.

KREU I PARË

RENDET KUSHTETUESE DHE TË DREJTAT GJUHËSORE E KULTURORE TË SHQIPTARËVE NDËR VITE

1. Hyrje e shkurtër

Duke u mbështetur në faktin se Republika e Maqedonisë së Veriut karakterizohet me disa faza të zhvillimit kushtetues, të cilat kanë specifikat e tyre në aspektin e organizimit të sistemit juridik, funksionimit të pushtetit shtetëror, rrethanave shoqërore politike me të cilat janë ballafaquar institucionet, pozitës juridiko-kushtetuese të komuniteteve, në veçanti të shqiptarëve, përdorimit të gjuhëve të komuniteteve, raportit mes pushtetit qendror dhe atij lokal, e shtrojnë nevojën e një studimi të posaçëm edhe të funksionimit të rendit juridik, duke i përfshirë këto veçori. Ekzistimi i kushtetutës dhe zhvillimi i saj pasqyron kahet e ecurisë dhe transformimit të një shoqërie, të së drejtës kushtetuese, të sistemit politik dhe të pikëpamjeve politike të një vendi[3]. Liritë dhe të drejtat e pjesëtarëve të bashkësive janë lëndë e rregullimit të të gjitha dokumenteve kushtetuese të deritanishme të Maqedonisë, duke filluar nga Deklarata e KAÇKM-së për të drejtat themelore të qytetarit të Maqedonisë demokratike të vitit 1944, deri në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë të vitit 1991[4]. Kuvendi i Parë i KAÇKM-së, i mbajtur më 2 gusht të vitit 1944 në Manastirin "Prohori i Pçinjës", duke sanksionuar procesin e deriatëhershëm të ndërtimit të Maqedonisë, në kuadër të Luftës Nacionalçlirimtare që i solli aktet themelore të shtetit të ri, të cilat ishin bazë juridike për funksionimin e organeve të tij dhe pushtetit të Republikës Federale të Maqedonisë, deri në miratimin e Kushtetutës së Republikës Popullore të Maqedonisë, më 31 dhjetor të vitit 1946[5]. Në këtë aspekt duhet theksuar Aktvendimin për shpalljen e KAÇKM-

3 Kurtesh Saliu, E drejta kushtetuese, Libri I (Botimi i katërt), Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2004, fq. 46.

4 Shkariq, Svetomir, Siljanovska-Davkova, Gordana, E drejta kushtetuese, Kultura, Shkup, 2009, fq. 393.

5 Biljana Popovska, Historia Shtetërore dhe Juridike e Maqedonisë-burimet, Shkup, 2005, f. 525.

së si trup më i lartë përfaqësues popullor, ligjvënës dhe ekzekutiv dhe organ më i lartë i pushtetit shtetëror, si dhe Deklaratën për të drejtat e qytetarëve. Bashkësive nacionale të Maqedonisë u sigurohen të gjitha të drejtat e jetës së lirë nacionale[6]. Kjo deklaratë duhej të shërbente si një bazë argumentuese që të drejtat e shqiptarëve dhe komuniteteve të tjera, duke përfshirë këtu edhe statusin e gjuhëve, me qëllim të përkufizimit real të pozitës së tyre juridiko-kushtetuese, duke u bazuar edhe në kontributin e ndërtimit të shtetit multietnik të Maqedonisë së Veriut.

родно-ослободителната борба и степенот на изградувањето на власта во општата држава, а како уште ги нема сите условија за образувањето на Народното правителство на македонската држава, функцијата на Народното правителство ќе ја врши времено ПРЕЗИДИУМОТ на АСНОМ.

Член 6

АСНОМ си избира свој Президиум, кој е составен од претседател, два подпретседатела, два секретара и најмалку други 16 (шеснаесет) члена.

Член 7

За својата работа Президиумот одговара пред АСНОМ.

Член 8

Сите законодателни решенија на АСНОМ и неговиот Президиум се објавуваат со подписите на председателот и секретарот на АСНОМ, односно неговиот Президиум.

Член 9

На територијата на Македонија важат законите на федералната македонска држава и законите на федеративна и демократска Југославија.

Член 10

До формирањето на Народното правителство на македонската држава при Президиумот на АСНОМ се образуваат нужен број отдели за разните гранки на државното управување.

Секој отдел се управлава от началник на отделот. Началникот на отделот ги води работите на отделот, под раководството и контролата на член от Президиумот, а кого и одговара.

Член 11

Народното правителство на македонската држава, односно до неговото образување Президиумот на АСНОМ, има функцијата на народно правителство, основајќи се на решенијата на АСНОМ, а во согласие со решенијата на АВНОЈ, како и заповедите и решенијата на Националниот комитет на ослободувањето на Југославија, донесуе заповеди и решенија и контролира нимното споведуење во македонската држава.

Член 12

Народното правителство на македонската држава, односно до неговото образување Президиумот на АСНОМ, има право да отфрли заклучењата и заповедите на сите народно-ослободителни одбори, ако не се во склад со законите на македонската држава.

ДЕКЛАРАЦИЈА
НА АСНОМ ЗА ОСНОВНИТЕ ПРАВА НА ГРАЃАНИНОТ НА ДЕМОКРАТСКА МАКЕДОНИЈА

1. Сите граѓани на федералната македонска држава се еднакви и равноправни пред законите, не гледајќи нивната народност, пол, раса и вероисповедание.

2. На националните малцинства на Македонија се осигуруваат сите права на слободен национален живот.

3. На секој граѓанин му е гарантирана сигурноста за личноста и имотот, загарантирано е правото на сопственост и часната иницијатива во стопанскиот живот.

4. На секој граѓанин му е загарантирана слободата на вероисповедањето и слободата на савеста.

5. На сите граѓани им се гарантира слободата на говорот, печатот, собирањето, договорот и слободата на дружењето.

6. Изборното право на демократска Македонија го вршат избирачите со тајно гласување на основание на општото, еднаквото, непосредното и личното изборно право.

7. Правото да избират и да бидат избирани во сите изборни тела во народната власт имаат секој граѓанин и секоја граѓанка кој се наполниле 18 години, ако не се провинени за некоје престапление. До дека траје народно-ослободителната војна, по решение на АСНОМ, може да се отстапи от принципите на тајното и непосредното гласување.

Малоумните лица, како и лицата кои са провинат по отношение на интересите на народно-ослободителната војна, се лишавајат од правата по точка 5 и 6 на оваја декларација.

8. Должност и чест е на секој за оружје способен граѓанин, без разлика на народност и вера, да учествуе како војник во редовите на народно-ослободителната војска и партизанските одреди.

9. Се забрануваат и прогонуваат сите фашиски и профашиски дејствија, оти са против слободата и независноста на братската заедница на народите во Југославија.

10. На секој граѓанин му е загарантирано правото на жалба против решенијата на органите на власта по начин предвиден во законот. Секој граѓанин има право на молба и поплака кај сите државни власти.

Gazeta Zyrtare e Njësisë Federale të Maqedonisë në Jugosllavinë Demokratike dhe Federale, nr. 1, viti I, Shkup (18 shkurt 1970, titulli i këtij botimi është identik me botimin e Gazetës Zyrtare të vitit 1945).

Neni 6

KAÇKM-ja zgjedh presidiumin e tij, i cili përbëhet nga kryetari, dy nënkryetarë,

6 Po aty, fq. 528.

dy sekretarë dhe të paktën 16 (gjashtëmbëdhjetë) anëtarë të tjerë.

Neni 7

Presidiumi përgjigjet para KAÇKM-së për punën e tij.

Neni 8

Të gjitha vendimet ligjvënëse të KAÇKM-së dhe presidiumit publikohen me nënshkrimet e kryetarit dhe sekretarit të KAÇKM-së, përkatësisht të presidiumit të tij.

Neni 9

Në territorin e Maqedonisë vlejnë ligjet e shtetit federal të Maqedonisë dhe ligjet e Jugosllavisë Federative Demokratike.

Neni 10

Deri në themelimin e jurisprudencës popullore të shtetit maqedonas gjatë presidiumit të KAÇKM-së, detyrohet një numër i nevojshëm i seksioneve për degët e ndryshme të udhëheqja shtetërore.

Çdo seksion udhëhiqet nga kryeshefi i seksionit. Kryeshefi i seksionit udhëheq punët e seksionit, nën udhëheqjen dhe kontrollin e anëtarit të presidiumit, para të cilit përgjigjet.

Neni 11

Jurisprudenca popullore e shtetit maqedonas, përkatësisht tek arsimimi i tij, Presidiumi i KAÇKM-së ka funksion të jurisprudencës popullore, duke u bazuar në vendimet e KAÇKM-së, në pajtim me vendimet e KAÇKJ-së, si dhe urdhrat dhe vendimet e Komitetit Nacional për Çlirimin e Jugosllavisë, miraton urdhra dhe vendime duke kontrolluar zbatimin e tyre në shtetin maqedonas.

Neni 12

Jurisprudenca popullore e shtetit maqedonas, përkatësisht tek arsimimi i tij, Presidiumi i KAÇKM-së, ka të drejtë t'i hedhë poshtë konkluzat dhe urdhrat e të gjithë këshillave nacional-çlirimtare, nëse nuk janë në pajtim me ligjet e shtetit

maqedonas.

DEKLARATA E KAÇKM-SË PËR TË DREJTAT THEMELORE TË QYTETARIT NË MAQEDONINË DEMOKRATIKE

1. Të gjithë qytetarët e shtetit federal maqedonas janë njëlloj dhe të barabartë para ligjeve, pa marrë parasysh nacionalitetin, gjininë, racën dhe besimin e tyre.

2. Pakicave nacionale në Maqedoni u sigurohen të gjitha të drejtat për një jetë të lirë.

3. Për çdo qytetar garantohet prona, e drejta e pronësisë dhe nisma e ndershme në jetën afariste.

4. Çdo qytetari i garantohet liria e besimit dhe liria e ndërgjegjes.

5. Të gjithë qytetarëve u garantohet liria e shprehjes, e shtypit, e tubimit, e marrëveshjes dhe liria e shoqërimit me këdo.

6. Të drejtën zgjedhore në Maqedoninë demokratike e ushtrojnë zgjedhësit me votim të fshehtë, duke u bazuar në të drejtën e përgjithshme, të barabartë, të drejtpërdrejtë dhe personale.

7. Të drejtën të zgjedhin dhe të zgjidhen në të gjithë trupat zgjedhorë në pushtetin nacional e ka çdo qytetar dhe qytetare, që ka mbushur 18 vjeç, nëse nuk ngarkohet për ndonjë shkelje. Derisa zgjat lufta nacional-çlirimtare, me vendim të KAÇKM-së, mund të bien poshtë parimet e votimit të fshehtë dhe direkt.

Personat (mendjelehtë), si dhe personat që kundërshtojnë interesat e luftës nacional-çlirimtare, privohen nga të drejtat sipas pikave 5 dhe 6 të kësaj deklarate.

8. Është detyrim dhe nder për çdo qytetar i aftë për mbajtjen e armës, pa dallim kombësie apo feje, të marrë pjesë si ushtarë në radhët e ushtrisë nacional-çlirimtare dhe në radhët e partizanëve.

9. Ndalohen dhe ndiqen të gjitha veprimet fashiste dhe profashiste, pasi janë kundër lirisë dhe pavarësisë së komunitetit vëllazërorë të popujve të Jugosllavisë.

10. Çdo qytetari i garantohet e drejta e ankesës kundër vendimeve të organeve

të pushtetit, në mënyrë siç parasheh ligji. Çdo qytetar ka të drejtë lutje dhe ankese te të gjithë organet e shtetit.

Natyrisht, në etapa të ndryshme, këto premisa kanë funksionuar në kushte dhe rrethana të ndryshme, duke përfshirë këtu edhe përcaktimet e ndryshme të cilat ndërlidhen me bazën juridiko-kushtetuese. Duhet theksuar se koha dhe burimet energjetike të pavlerësuara, që u humbën në ish-shtetin e RSFJ-së, duke debatuar me dekada për tema minore, jorelevante dhe ideologjike, na shkaktuan shumë humbje kohe[7]. Në periudhën e sistemit socialist në Republikën Socialiste të Maqedonisë, por edhe në ish-Jugosllavinë Socialiste, në të cilën Republika e Maqedonisë ishte njësi federale dhe e barabartë me republikat e tjera, zhvillimi kushtetues kaloi nëpër faza të ndryshme duke pasur çdo etapë në këtë drejtim edhe karakteristikat dhe veçoritë e veta në bazë të të cilave bëhet edhe dallimi ndërmjet tyre[8]. Në këtë aspekt, rëndësi të veçantë paraqet ndriçimi i fakteve lidhur me statusin dhe përdorimin e gjuhës shqipe në të gjitha nivelet e organizimit dhe të funksionimit të sistemit juridiko-kushtetues. Përderisa flitet për disa faza të zhvillimit kushtetues brenda vendit, sigurisht edhe statusi i gjuhëve nuk ka qenë i njëjtë, krejt kjo në varësi, jo vetëm të përcaktimeve kushtetuese dhe ligjore, por edhe të vetë vullnetit politik të bartësve të funksioneve publike në periudhat përkatëse. Në këtë aspekt, vlen të theksohet edhe rëndësia e Deklaratës së KAÇKM-së, lidhur me të drejtat themelore të qytetarëve dhe në veçanti të pjesëtarëve të komuniteteve.

Në Aktvendimin e Kuvendit të Parë të KAÇKM-së për shpalljen e KAÇKM-së si organ më i lartë përfaqësues, popullor, ligjvënës dhe ekzekutiv dhe organ më i lartë i pushtetit shtetëror të Maqedonisë Demokratike, flitet për vullnetin sovran të popullit të Maqedonisë dhe jo të vullnetit sovran të popullit maqedonas[9]: *"Me*

7 Dimitar Mirçev, Maqedonia në tunelin e tranzicionit, politoskop dhe satirikon i pesë viteve të fundit, Shkup, 2011, fq. 84.

8 Osman Kadriu, Rregullimi kushtetues i Maqedonisë, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Fakulteti Juridik, Shkup, 2006, fq. 46

9 Shkariq, Svetomir, Siljanovska-Davkova, Gordana, E drejta kushtetuese, Kultura, Shkup, 2009, fq. 291.

këtë akt shtetndërtues, bazuar në vullnetin sovran dhe të drejtën e vetëvendosjes së popullit të Maqedonisë"[10], gjë që këtë koncept e përafron me konceptin e "shtetit-demos" shumë më i gjerë se sa koncepti francez, sepse vendimet e KAÇKM-së i njohin edhe të drejtat kolektive[11]. Ky është një fakt shumë i rëndësishëm kushtetues, meqë në këtë rast si subjekt kushtetues, respektivisht si burim i sovranitetit në shtet, theksohet populli i Maqedonisë dhe jo vetëm njëra pjesë e tij.

Për të ndriçuar pjesën e veprimtarisë së KAÇKM-së, në vijim do të prezantohen dokumentet e siguruara nga Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, lidhur me pjesëmarrjen e shqiptarëve në këto zhvillime. Në shpalljen e përfaqësuesve të popullit në KAÇKM nga përbërja IV dhe shtabi IV dhe zonës operative deri te populli i rrethit të Kërçovës dhe të Dibrës për vazhdimin e luftës kundër okupatorit dhe shërbëtorëve të brendshëm, shihet qartë lista e këshillave popullore nacionalçlirimtare, ku merrnin pjesë edhe shqiptarë dhe pjesëtarë të komuniteteve të tjera, ndër ta edhe: Kemal Agolli – anëtar i Presidiumit nga Dibra, Nafi Sylejman – komandant i rajonit të Dibrës, Hasan Shukri nga Shkupi, Gjushe Deli nga Kukushi dhe Nexhat Agolli nga Dibra[12]. Në mesin e përfaqësuesve të popullit në KAÇKM, nga komunitetet, gjithashtu merrnin pjesë edhe: Reshad Zajazi, Mehmed Daut Mehmedov nga Kërçova, Mamuti nga Gostivari, një shqiptar nga Tetova i evidentuar si "Arnautin", Nafis Sylejman nga Manastiri, Nexhat Agolli dhe Hamdi Demo nga Dibra, Esad Doko nga Struga, Qemal Sejfulla nga Shkupi, Genadije Leshkov nga Brodi, Isak Sion nga Shtipi, Kamber Asan nga Disani i Poshtëm dhe Abdulla Alia nga Presheva[13]. Përbërja e listës së artistëve të Teatrit Popullor "Kosta Racin" dhe të punonjësve të kinemave

10 AKTET E SEANCËS SË PARË TË KAÇKM-së, në dispozicion në internet në linkun: https://sobranie.mk/content/%D0%9F%D0%B0%D1%80%D0%BB%D0%B0%D0%BC%D0%B5%D0%BD%D1%82%D0%B0%D1%80%D0%B5%D0%BD%20%D0%B8%D0%BD%D1%81%D1%82%D0%B8%D1%82%D1%83%D1%82/%D0%90%D0%A1%D0%9D%D0%9E%D0%9C_MK.pdf, fq. 1.


11 Shkariq Svetomir, E drejta kushtetuese, Botimi i tetë, Kultura, Shkup, 2015, fq. 326.

12 Më gjerësisht shih në: Arkivi i Maqedonisë, KAÇKM-ja (Këshilli Antifashist i Çlirimit Kombëtar Maqedonas), Dokumente nga Seanca e Parë dhe e Dytë e KAÇKM-së, VËLLIMI 1, LIBRI 1, Shkup, 1984, fq. 245-330.

13 Po aty, fq. 99-170.

të Shkupit, përfaqëson edhe këto komunitete: Zekir Fejzullov dhe Amdi Moov[14].

Në procesverbalin nr. 5 nga mbledhja e pestë e grupit punues të udhëheqjes së Presidiumit të KAÇKM-së[15], në pikën e 16-të, theksohet se Ali Shehu emërohet sekretar i nënkryetarit të udhëheqjes së KAÇKM-së – Nexhat Agollit. Njëri nga anëtarët e qeverisë, i zgjedhur nga Presidiumi i Kuvendit Populllor të Maqedonisë në vitin 1945, ishte edhe Akif Lleshi.



Këtu e kemi edhe nënshkrimin e dokumenteve të rëndësishme nga Nënkryetari i KAÇKM-së, Dr. Nexhat Agolli.

Me krijimin e këshillave nacionalçlirimtare, në përbërjen e tyre haset edhe Esat Doku, avokat nga Struga, gjithashtu si procesverbalist i referatit të departamentit administrativ të Këshillit Nacionalçlirimtar në Kumanovë haset edhe Ali A. në

14 Më tepër shih në: Arkivi i Maqedonisë, KAÇKM-ja (Këshilli Antifashist i Çlirimit Kombëtar Maqedonas), Dokumente nga Seanca e Parë dhe e Dytë e KAÇKM-së, VËLLIMI 1, LIBRI 2, Shkup, 1984, fq. 323.

15 Më tepër shih në: Arkivi i Maqedonisë, KAÇKM-ja (Këshilli Antifashist i Çlirimit Kombëtar Maqedonas), VËLLIMI 1, LIBRI 3, Shkup, 1987, fq. 240-243.

shkurt të 1945-ës[16]. Arsimtarë të emëruar në gjimnazet e disa qyteteve janë edhe: Dida Qazim Ali nga Shkupi, Ibraim Rexhep Ibraimoski nga Prilepi dhe njëkohësisht në Kuvendin e Dytë të KAÇKM-së, vendoset për hapjen e shkollave në gjuhën shqipe dhe atë turke[17].

Në bazë të nenit 2 të Ligjit të Zgjedhjes së Qeverisë Populllore të Maqedonisë Federale, Kryesia e Kuvendit Populllor të Maqedonisë e emëron këtë përbërje të Qeverisë së Maqedonisë Federale, siç vijon:

Kryetar i Qeverisë – Llazar Kolishevski, nënkryetar i parë dhe ministër i Financave – Lupço Arsov, nënkryetar i dytë – Abduraim Mehmed, Kiro Petrushev – ministër i Punëve të Brendshme, Nikolla Minçev – ministër i Arsimit, Pavell Shatev – ministër i Drejtësisë, Strahil Gigov – ministër i Industrisë dhe i Xehetarisë, Tode Noshpall – ministër i Tregtisë dhe i Furnizimeve, Bogoja Fotev – ministër i Bujqësisë dhe i Pylltarisë, dr. Vukashin Popadiç – ministër i Shëndetësisë, dr. Nexhat Agolli – ministër i Politikës Sociale dhe Georgi Vasilev – ministër i Ndërtimtarisë[18].

Pra, siç shihet, në kuadër të kësaj përbërjeje qeveritare të vitit 1945, janë edhe dy anëtarë shqiptarë, duke qenë kontribues real të zhvillimeve të kësaj periudhe.

16 Më tepër shih në: Arkivi i Maqedonisë-Matica Makedonska, DOKUMENTET, KAÇKM-ja, Këshilli Antifashist i Çlirimit Kombëtar Maqedonas, VËLLIMI 1, LIBRI 4, Shkup, 1994, fq. 173 dhe 258.

17 Po aty, fq. 377-392.

18 Më gjerësisht shih në: Arkivat Shtetërore të Republikës së Maqedonisë, KAÇKM-ja, DOKUMENTE, VËLLIMI 1, LIBRI 7, Shkup, 2004, fq. 620.

2. Kushtetuta për organizimin e ardhshëm shtetëror të Maqedonisë të vitit 1880 dhe dizajni i shtetit multietnik

Idetë e kushtetutshmërisë europiane të shek. XIX gjetën shprehje edhe në Maqedoninë e asaj kohe nëpërmjet Kushtetutës për rregullimin e ardhshëm shtetëror të Maqedonisë së vitit 1880[19], e cila për nga struktura e saj është shumë identike me Kushtetutën e Belgjikës së vitit 1831, e cila edhe pse asnjëherë nuk ka hyrë në fuqi, megjithatë ka një rëndësi të veçantë historike, aktuale dhe zhvillimore kushtetuese për vendin tonë.[20] Kjo kushtetutë ka preambulën dhe pjesën e saj normative të përbërë prej 103 neneve, e ndarë në 15 kaptina.

Preambula e saj paraqet një tekst të shkurtër dhe integral që gjendet në hyrje të saj dhe që ka një formë të vazhduar pa paragrafë dhe pa nënparagrafë, ku thuhet: *"Duke interpretuar synimin dhe dëshirën e shumicës së madhe të popullsisë së territorit që me shekuj e mban emrin Maqedoni, por me qëllim që njëherë e përgjithmonë të pamundësohen intrigat dhe ngatërresat rreth rrëmbimit të saj nga ana e shteteve ballkanike, duke pasur parasysh nenin 23 të Marrëveshjes së Berlinit për dhënien e autonomisë pjesëve të caktuara të Turqisë Europiane, Liga Maqedonase, përfaqësuese e vetme e shumicës sllave të popullsisë në Maqedoni, e përgatiti këtë kushtetutë për rregullimin e ardhshëm shtetëror të Maqedonisë"[21].*

Pjesa normative e kësaj kushtetute është një tekst relativisht i gjatë që përbëhet prej 103 neneve dhe që është e ndarë në 15 kaptina. Për qëllimet e këtij studimi, në vijim do të përqëndrohemi vetëm në kaptinën e parë, e cila i përmban dispozitat për kufijtë, popullsinë dhe veçoritë e përgjithshme të shtetit, pra dispozitat kushtetuese të neneve 1-3. Me rregullimin e përpiktë të kufijve shtetërorë, kjo kushtetutë është ndër të rrallat e asaj kohe në Europë që çështjen e kufijve e trajtonte si materie

19 Teksti i kësaj kushtetute i shtypur në maqinë shkrimi në versionin origjinal gendet në Arkivin sekret të Patriarkut bullgar Qirilit në Manastirin e Dragalevës, vëllimi 23, fq. 1-23 me titull: "Liga Bullgaro-Maqedonase". Më gjerësisht shih në: Dimevski, Slavko; Popovski, Vlado; Shkariq, Svetomir; dhe Apostollski Mihajllo; Lidhja Maqedonase dhe Kushtetuta për organizimin e ardhshëm shtetëror të Maqedonisë nga 1880, Mislla, Shkup, 1985, f. 261.

20 Më gjerësisht shih në: Jeton Shasivari, E drejta kushtetuese, Botimi i dytë, Furkan-ISM, Shkup, 2020, fq. 103-112.

21 Po aty, fq. 105-106.

kushtetuese e jo si materie ligjore. Për sa i përket popullsisë, në nenin 3 të kësaj kushtetute theksohet: *"Shteti autonom i Maqedonisë është i populluar nga një popullsi multietnike, siç janë: sllavomaqedonas: 705.000; turq e pomakë (myslimanë): 450.000; arnautë (ortodoksë e myslimanë): 75.000*[22]*; hebrenj: 65.000; grekë: 61.000; vlleh dhe të tjerë: 41.000"*[23]. Me këtë koncept multietnik si bazë kushtetuese për konstituimin e shtetit të ardhshëm të Maqedonisë dhe për rregullimin e brendshëm të marrëdhënieve politike, kjo kushtetutë përmbajtësisht dallohet nga kushtetutat e atëhershme të principatave ballkanike që ngërthenin në vete konceptin monoetnik (etnocentrik), si p.sh.: Kushtetuta e Rumanisë e vitit 1866 që flet vetëm për rumunët, Kushtetuta e Serbisë e vitit 1869 që flet vetëm për serbët, Kushtetuta e Greqisë e vitit 1866 që flet vetëm për grekët dhe Kushtetuta e Bullgarisë e vitit 1879 që flet vetëm për bullgarët[24].

Veçoritë e përgjithshme të shtetit të ardhshëm rregullohen në nenin 2 të kësaj kushtetute, sipas të cilit Maqedonia si shtet ka tri veçori: e para, ajo është shtet tributar (vazal); e dyta, ajo është shtet autonom, dhe e treta, ajo është shtet multietnik. Maqedonia sipas kësaj kushtetute është shtet tributar ngaqë konsiderohet si pjesë përbërëse e Perandorisë Osmane duke pranuar obligimin që t'i paguajë asaj një tatim të caktuar. Vazaliteti i Maqedonisë ndaj Portës së Lartë në atë kohë ka qenë një fazë e domosdoshme në procesin e konstituimit të saj në të ardhmen si një shtet i pavarur, mbase nëpër këtë proces të vazalitetit kanë kaluar edhe principatat fqinje

22 Edhe pse kushtetutëvënësi në nenin 3 nuk tregon burimin autentik të këtyre të dhënave statistikore të popullsisë multietnike, megjithatë lidhur me emërtimin "arnautë" si dhe me këtë numër të shqiptarëve (75.000), vlen të theksohet fakti se regjistrimi i popullsisë në kohën e Perandorisë Osmane është bërë në saje të përkatësisë fetare, e jo të përkatësisë kombëtare, prandaj, numri i shqiptarëve sigurisht se ka qenë shumë më i madh. Në këtë drejtim, po ashtu vlen të theksohet fakti se regjistrimet zyrtare osmane të kryera para vitit 1870 e përshkruanin popullsinë e Maqedonisë brenda tri kategorive ekskluzive, edhe atë: popullsia jobesimtare, popullsia myslimane dhe popullsia hebreje, sepse osmanët nuk kishin interes në strukturën etnike të popullsisë jomyslimane. Popullsia klasifikohej ekskluzivisht sipas përkatësisë fetare, me ç'rast turqit nuk dalloheshin nga myslimanët e tjerë. Sipas përkatësisë fetare, turqit dhe shqiptarët gjatë regjistrimeve zyrtare osmane klasifikoheshin së bashku. Më gjerësisht shih në: Balkanicus, The Aspirations of Bulgaria, London, 1915, fq. 225-226.

23 Më gjerësisht shih në: Dimevski, Sllavko; Popovski, Vllado; Shkariq, Svetomir; dhe Apostollski Mihajllo; Lidhja Maqedonase dhe Kushtetuta për organizimin e ardhshëm shtetëror të Maqedonisë nga 1880, Mislla, Shkup, 1985, f. 238.

24 Po aty, fq. 194-195.

si: Serbia dhe Bullgaria. Maqedonia, sipas kësaj kushtetute, paraqet shtetin autonom nën sovranitetin e sulltanit dhe nën patronatin e fuqive europiane. Kjo kushtetutë Maqedoninë e përkufizon si shtet multietnik dhe paraqet një model kushtetues të shtetit multietnik duke hedhur poshtë konceptin mbizotërues të mendimit kushtetues të asaj kohe: një komb-një shtet, duke hapur mundësi për procese të reja në zhvillimin kushtetues dhe demokratizimin e shtetit sipas konceptit multietnik ose shumëkombësh: shumë kombe-një shtet[25]. Gjatë shtrimit të konceptit, të përmbajtjes dhe të përbërjes së kësaj kushtetute, bie në sy se ajo ka një interaksion mjaft të afërt me amendamentet kushtetuese të vitit 2001 për Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut që u miratuan si pasojë e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit[26].

Kur lexohet teksti i kushtetutës për rregullimin e ardhshëm shtetëror të Maqedonisë së vitit 1880, para lexuesit shtrohen pyetjet: Nëse Republika e Maqedonisë së Veriut me nënalfabetin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit të vitit 2001, e riktheu konceptin e shtetit multietnik të vitit 1880 dhe nëse kushtetuta për rregullimin e ardhshëm shtetëror të Maqedonisë së vitit 1880, i parashikon idetë që gjenden në zgjidhjet e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit[27].

25 Më gjerësisht shih në: Jeton Shasivari, E drejta kushtetuese, Botimi i dytë, Furkan-ISM, Shkup, 2020, fq. 107.
26 Po aty, fq. 112.
27 Më gjerësisht shih në: Shkariq Svetomir, E drejta kushtetuese, Botimi i tetë, Kultura, Shkup, 2015, f. 316, dhe Vllado Popovski etj., Krijimi i shtetit modern maqedonas, Fjalori maqedonas-Letërsia maqedonase, Shkup, 2014, f. 37.

3. Kushtetuta e Republikës Populllore të Maqedonisë e vitit 1946 dhe të drejtat gjuhësore dhe kulturore të shqiptarëve

Kushtetuta është një lidhje e pandërprerë mes shtetit dhe së drejtës nga njëra anë, si dhe shtetit dhe shoqërisë nga ana tjetër[28]. Pikërisht ky konstatim duhet të jetë pjesë e çdo sistemi kushtetues (si në aspektin juridik, ashtu edhe në atë praktik), nga fakti se kjo lidhshmëri mundëson që të kemi një kushtetutë reale dhe jo fiktive, ku gjërat ndodhin ndryshe, pra ndryshe proklamohet dhe ndryshe zbatohet, sidomos kjo gjë ka rëndësi të posaçme në shtetet multietnike, siç është Maqedonia e Veriut.

Në këtë distancë kohore miratohen kushtetutat e Republikës së Maqedonisë të viteve 1946, 1963 dhe 1974 dhe periodizimi i zhvillimit kushtetues bëhet nga aspekti dhe momenti i miratimit të kushtetutave në fjalë[29]. Me qëllim të shqyrtimit të statusit të gjuhës shqipe në këtë periudhë kohore, paraqitet edhe nevoja e prezantimit të funksionimit të rendit kushtetues-juridik, me të gjitha specifikat e tij. Sipas Kushtetutës së vitit 1946 (e cila nuk ka preambulë, por vetëm tekst normativ prej 129 neneve), Republika Populllore e Maqedonisë[30] është shtet populllor me formë republikane[31]: *"Në Republikën Populllore të Maqedonisë i tërë pushteti buron nga populli dhe i përket populllit. Populli e ushtron pushtetin e tij nëpërmjet zgjedhjes së lirë të organeve përfaqësuese të pushtetit shtetëror, këshillave populllore, të cilat, nga këshillat populllore vendore deri te Kuvendi Populllor i RPM-së, lindin dhe zhvillohen në Luftën Nacionalçlirimtare kundër fashizmit dhe reaksionit dhe të cilat bazohen në fitoren e asaj lufte"*[32]. Sipas kësaj kushtetute, të gjitha organet përfaqësuese zgjidhen nga populli, me votim të fshehtë, me të drejtë të zgjedhjes së drejtpërdrejtë dhe të

28 Shkariq, Svetomir, Siljanovska-Davkova, Gordana, E drejta kushtetuese, Kultura, Shkup, 2009, f. 143.

29 Osman Kadriu, Rregullimi kushtetues i Maqedonisë, Universiteti Shtetëror i Tetovës, Fakulteti Juridik, Shkup 2006, fq. 46.

30 Sipas Kushtetutës së vitit 1946 Republika e Maqedonisë së Veriut e kishte emërtimin kushtetues: "Republika Populllore e Maqedonisë", por, në faza të ndryshme të zhvillimit kushtetues paraqiten edhe ndryshime të tjera të emrit kushtetues të shtetit.

31 Kushtetuta e Republikës Populllore të Maqedonisë e v. 1946, "Gazeta Zyrtare e RPM-së", nr. 1/47, (01.01.1947), neni 1, në dispozicion në internet në linkun:
https://www.slvesnik.com.mk/Issues/571D5D9AF0DB42A3A37F220F77476EB5.pdf.

32 Po aty, neni 6.

barabartë dhe ata përgjigjen para votuesve, me çka zgjedhjet rregullohen me ligj. Me këtë kushtetutë njëkohësisht përcaktohen edhe të drejtat themelore të popullit të cilat, sipas saj, burojnë nga Kushtetuta e Republikës Federative Popullore të Jugosllavisë. Që nga paraqitja e institucionit të lirive dhe të të drejtave në deklarata, e pastaj në kushtetutat e para të shkruara, e deri më sot dukshëm është zgjeruar dhe pasuruar katalogu i të drejtave të proklamuara dhe të garantuara me kushtetutë[33]. Nënkuptohet se ambienti ekonomik dhe politik nuk ndryshohet brenda natës, por, hap pas hapi, me durim, vëmendje, paramendim dhe në një periudhë të gjatë kohore[34]. Andaj, rëndësi të veçantë ka studimi i zhvillimit të lirive dhe të të drejtave themelore si një nga shtyllat kryesore të demokracisë dhe të zhvillimit të përgjithshëm shoqëror. Në këtë aspekt, Kushtetuta e Republikës Popullore të Maqedonisë ka tri karakteristika themelore: e para, ajo është kushtetutë reale; e dyta, ajo është kushtetutë popullore-demokratike dhe e treta, ajo është kushtetutë e njësisë federale[35]. Kjo kushtetutë bën pjesë në grupin e kushtetutave popullore-demokratike, të miratuar pas Luftës së Dytë Popullore me përcaktimin kryesor për të ndërtuar socializmin, prandaj ajo operonte me një terminologji specifike kushtetuese, si: "republika popullore", "shteti popullor", "këshillat popullore", "deputetët popullorë", "kuvendi popullor" etj., mirëpo në realitet ajo funksiononte si një "shtet avangard", ku e drejta administrative dominonte ndaj së drejtës kushtetuese[36].

Lidhur me çështjen e përdorimit të gjuhëve dhe të zhvillimit kulturor të komuniteteve, kjo kushtetutë përcaktonte si vijon: *"Pakicat kombëtare në Republikën Popullore të Maqedonisë e gëzojnë të drejtën dhe mbrojtjen e zhvillimit të tyre kulturor dhe të drejtën e përdorimit të lirë të gjuhës së tyre"*[37]. Kështu, edhe

33 Kurtesh Saliu, E drejta kushtetuese, Libri I (Botimi i katërt), Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2004, fq. 209.

34 Harmonizimi i sistemit juridik të Republikës së Maqedonisë me ligjin e Bashkimit Evropian, Evolucioni i sistemit kushtetues të Republikës së Maqedonisë në pritje të miratimit të marrëveshjes kushtetuese të Bashkimit Evropian, Punimet e debatit shkencor të mbajtur në Shkup më 10 dhjetor 2007, AShAM & GTZ, Shkup, 2008, f. 235.

35 Shkariq Svetomir, E drejta kushtetuese, Botimi i tetë, Kultura, Shkup, 2015, f. 327.

36 Po aty.

37 Kushtetuta e Republikës Popullore të Maqedonisë e v. 1946, "Gazeta Zyrtare e RPM-së", nr. 1/47, (01.01.1947),

pse përkufizohet sfera e përdorimit të gjuhëve, megjithatë ajo nuk përkufizohet në mënyrë taksative se a mund të përdoret në të gjitha nivelet dhe të përkufizohet konkretisht se për cilat gjuhë bëhet fjalë. Në vazhdimësi përcaktohen edhe të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, duke theksuar se të gjithë qytetarët janë të barabartë dhe se nuk lejohet asnjë privilegj në sferat përkatëse: *"Është në kundërshtim me Kushtetutën dhe do t'i nënshtrohet dënimit çdo akt me të cilin qytetarëve u jepen privilegje ose u kufizohen të drejtat në bazë të dallimeve nacionale, racore dhe të besimit fetar, si dhe çdo predikim i urrejtjes dhe i përçarjes nacionale, racore ose të besimit fetar"*[38]. Sigurisht kjo dispozitë kushtetuese e garanton mbrojten e qytetarëve nga privilegjet dhe diskriminimet eventuale, mirëpo aspekti praktik i zbatimit të saj, për fat të keq, e tregon të kundërtën. Edhe në vazhdimësi ka dispozita të tjera kushtetuese të cilat ndërlidhen me mbrojtjen e popullatës nga diskriminimi: *"Të gjithë qytetarët e Republikës Populllore të Maqedonisë, pa dallim gjinie, kombësie, race, besimi fetar, niveli të shkollimit dhe vendi të banimit, që kanë mbushur 18 vjet, kanë të drejtë të zgjedhin dhe të jenë të zgjedhur në të gjitha organet e pushtetit shtetëror"*[39]. Mirëpo, edhe këto përcaktime kushtetuese praktikisht hasin në vështirësi në kuadër të zbatimit të tyre, për sa i përket aspektit të mosdiskriminimit. Kjo kushtetutë njëkohësisht i përkufizon edhe çështjet lidhur me lirinë e shtypit, e shprehjes, e bashkimit, e tubimeve, mirëpo edhe këtu hasen zhgënjimet e shumta të popullatës, për shkak se ajo që përcaktohet në këtë kushtetutë nuk gjen zbatim në jetën praktike, për faktin se në çlirimin e vendit kanë marrë pjesë edhe shqiptarët, natyrisht ky fakt ndërlidhet edhe me çështjen e të drejtave, të cilat duhet t'i gëzojnë brenda shtetit dhe jo të jenë të diskriminuar e të ballafaqohen me shumë vështirësi në aspektin e realizimit të tyre. Shteti siguron shkollimin dhe aspektet kulturore

neni 12, në dispozicion në internet në linkun:
https://www.slvesnik.com.mk/Issues/571D5D9AF0DB42A3A37F220F77476EB5.pdf.

38 Po aty, neni 20, paragrafi 3.

39 Po aty, neni 22, paragrafi 1.

që të jenë të arritshme për të gjithë, duke mos përkufizuar saktësisht aspektin e gjuhëve në të cilat mund të organizohen ato, çështje këto që bien ndesh me aspektin e proklamimit të të drejtave të popullatës në mënyrë të barabartë dhe të drejtë.

Në kuadër të organizimit të pushtetit shtetëror si element i dytë i përmbajtjes së kushtetutës, si organe më të larta shtetërore janë: Kuvendi Popullor i RPM-së, Presidiumi i Kuvendit Popullor i RPM-së, organet e administratës shtetërore të RPM-së (Qeveria e RPM-së), organet e pushtetit shtetëror të njësive territoriale-administrative, gjykatat popullore dhe prokuroria publike. Pikërisht këto janë edhe institucionet themelore të Kushtetutës së RPM-së të vitit 1946, të cilat duhej t'i zbatonin parimet dhe vlerat e kësaj kushtetute. Edhe pse këto përcaktime nuk përkonin me realitetin e popullatës në vend, prapëseprapë do të hasen vështirësi të shumta për zbatimin e tyre për sa i përket popullit shqiptar, si dhe komuniteteve të tjera që jetojnë në këtë shtet. Njëkohësisht, një sfidë në vete paraqiste edhe çështja e përfaqësimit të komuniteteve në të gjitha institucionet e sistemit juridik dhe politik në vend, në këtë aspekt nëse e vështrojmë strukturën udhëheqëse të Presidiumit të Kuvendit kushtetutëvënës të Republikës Popullore të Maqedonisë, do të vërejmë një përfaqësues nga komunitete si nënkryetar të këtij organi, i cili quhet Abduraman Memet. Gjithashtu, në vendimin për shpalljen e Ligjit për ndryshimin e Ligjit Kushtetues për Organizimin Shoqëror dhe Politik të organeve të pushtetit të Republikës Popullore të Maqedonisë, shihet edhe një tjetër përfaqësues nga komunitetet, përkatësisht Firuz Nazim, në cilësinë e sekretarit të Kuvendit Popullor të RPM-së. Aspektet e mangësive të shumta të rregullimit kushtetues të vitit 1946 janë më evidente, si në aspektin e mossanksionimit taksativ të përdorimit të gjuhës shqipe dhe gjuhëve të komuniteteve të tjera të cilat jetojnë në këtë shtet, ashtu edhe në përfaqësimin e drejtë dhe adekuat në të gjitha organet shtetërore dhe në të gjitha nivelet, si dhe në aspektin e mosdiskriminimit.

4. Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë e vitit 1963 dhe të drejtat gjuhësore dhe kulturore të shqiptarëve

Maqedonia e Veriut, që nga fillimi si njësi federative e Republikës Demokratike Federative të Jugosllavisë (më vonë Republika Populllore Federative e Jugosllavisë e vitit 1946 deri 1974 dhe më pas Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë), deri në shpalljen e pavarësisë së saj, në shtator të vitit 1991, e ka ndarë fatin e shtetit federativ, si pjesë përbërëse e të cilit ka qenë, duke ndërtuar dhe zhvilluar marrëdhëniet socialiste shoqërore mbi bazën e pronës shoqërore dhe të vetëqeverisjes jugosllave[40]. Me Kushtetutën e vitit 1963 shteti emërtohet si Republika Socialiste e Maqedonisë, ndryshe nga kushtetuta paraprake e vitit 1946, ku shteti emërtohej si Republika Populllore e Maqedonisë. Kjo kushtetutë ka preambulën dhe tekstin normativ me gjithsej 242 nene. Në preambulën e saj, mes të tjerash, theksohet: *"Duke u nisur nga fakti historik që populli maqedonas i udhëhequr nga klasa punëtore me në krye Partinë Komuniste, me luftën e bashkuar me popujt e tjerë jugosllavë në Luftën Nacionalçlirimtare dhe Revolucionin Socialist... krijoi shtetin e vet, Republikën Populllore të Maqedonisë, në të cilin i realizoi aspiratat historike të populllit maqedonas për liri kombëtare dhe pavarësi shtetërore, të kombësive-pakicave kombëtare për barazi dhe të popujve punonjës për liri sociale dhe në bazë të së drejtës për vetëvendosje, duke përfshirë të drejtën për shkëputje, të bashkuar vullnetarisht me popujt e tjerë të Jugosllavisë në një bashkësi federative socialiste të kombeve dhe të kombësive të lira dhe të barabarta, i vetëdijshëm se vetëm në të mund t'i sigurojë kushtet për zhvillimin e vet të lirë dhe gjithëpërfshirës kombëtar, material, politik dhe kulturor..."*[41].

Neni 1 i kësaj kushtetute e përkufizonte RSM-në, si: *"Bashkësi shtetërore*

40 Milaim Fetai, Marrëveshja e Ohrit, bazë e demokratizimit dhe e integrimit euroatlantik të Maqedonisë, Instituti për studime politike dhe ndërkombëtare, Shkup, 2017, fq. 19.

41 Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë e vitit 1963, "Gazeta Zyrtare e RSM-së", nr. 15/63, (12.04.1963), Preambula, paragrafët 1 dhe 3, në dispozicion në internet në linkun: https://www.slvesnik.com.mk/Issues/37EB0C4961424D1286094520A974BBC9.pdf.

socialiste demokratike e popullit të Maqedonisë bazuar në pushtetin e popullit punonjës dhe në vetëqeverisjen"[42].

Kur analizohet preambula e mësipërme, si dhe përkufizimi kushtetues i RSM-së, rrjedh se preambula e saj e promovon teorinë e sovranitetit kombëtar të ndërlidhur me sovranitetin e klasës punëtore, popullit punonjës dhe të vetëqeverisjes shoqërore, ndërkaq, nga ana tjetër, RSM-ja nuk përkufizohet si shtet, por si bashkësi shtetërore, me çka përkufizimi i tillë e dobëson sovranitetin shtetëror të RSM-së si pasojë e bindjes së këtij kushtetutëvënësi për fuqinë e vetëqeverisjes shoqërore si një formë e zhdukjes së shtetit. Kësaj duhet shtuar faktin se në këtë kushtetutë, qytetari ka pasur një rol periferik në realizimin e sovranitetit sepse populli punonjës ka qenë bartësi i vetëm i tij[43].

Po ashtu, siç shihet në këtë kushtetutë, edhe pse shqiptarët dhe komunitetet e tjera nuk përmenden fare, pra nuk kishin emër në të, ato trajtohen si kombësi-pakicë kombëtare[44].

Për qëllimet e këtij studimi me rëndësi janë dispozitat e Kushtetutës së RSM-së të vitit 1963, si vijon:

Në nenin 61 të kësaj kushtetute përcaktohet: *"Puna e të gjitha organeve shtetërore, organeve të vetëqeverisjes shoqërore dhe organizatave që kryejnë veprimtari me interes publik bëhet në gjuhën maqedonase. Mosnjohja e gjuhës maqedonase nuk mund të jetë pengesë për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave dhe interesave të justifikuara të qytetarëve dhe organizatave. Secilit i garantohet e drejta në procedurën para gjykatës ose organeve të tjera shtetërore dhe organizatave që gjatë ushtrimit të kompetencave publike vendosin për të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, të përdorin gjuhën e tyre dhe në atë procedurë të njihen me faktet në*

42 Po aty, neni 1 parag. 1.

43 Më gjerësisht shih në: Шкарић Светомир, Уставно право, осмо издание, Култура, Скопје, 2015, стр. 375.

44 Më gjerësisht shih në: Jeton Shasivari, "The Past and the Present of the Constitutional Systems of the Republic of Macedonia in terms of the position of Albanians", European Scientific Journal, June 2013 edition vol. 9, No. 17, fq. 191

gjuhën e tyre"[45].

Në nenin 73 të kësaj kushtetute përcaktohet: *"Çdo kombësie-pakice kombëtare i garantohet e drejta për të përdorur lirisht gjuhën e vet, për të shprehur dhe zhvilluar kulturën e vet dhe për të krijuar institucione dhe organizata që i sigurojnë këto të drejta"*[46].

Në nenin 74 të kësaj kushtetute përcaktohet: *"Në vendet ku jetojnë kombësitë-pakicat kombëtare, arsimimi dhe edukimi i anëtarëve të kombësive-pakicave kombëtare realizohet në shkollat, përkatësisht departamentet dhe institucionet arsimore ku mësimi dhe edukimi realizohen në gjuhën e kombësisë-pakicës kombëtare përkatëse. Me ligj rregullohen kushtet për krijimin, organizimin dhe punën e shkollave dhe departamenteve në të cilat zhvillohet mësimi në gjuhët e kombësive-pakicave kombëtare"*[47].

Në nenin 75 të kësaj kushtetute përcaktohet: *"Në komunat, përkatësisht në rrethet brenda territorit të të cilave jetojnë një numër i madh i anëtarëve të kombësive-pakicave kombëtare, vendimet dhe aktet e tjera të rëndësishme të kuvendeve komunale dhe të rretheve botohen në gjuhën e kombësisë-pakicës kombëtare. Të gjithë banorët e zonave të përziera etnikisht në Republikën Socialiste të Maqedonisë, kanë të drejta të barabarta për ta përdorur gjuhën e tyre në procedurat administrative dhe gjyqësore. Mbishkrimet publike në këto zona janë dygjuhëshe. Statuti i komunës, përkatësisht i rrethit, në pajtim me kushtet e përgjithshme të rregulluara me ligj, përcakton kushte dhe procedura më të afërta që sigurojnë realizimin e të drejtave të pjesëtarëve të kombësive-pakicave kombëtare"*[48].

Në nenin 210 të kësaj kushtetute përcaktohet: *"Procedura para gjykatave*

45 Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë e vitit 1963, "Gazeta Zyrtare e RSM-së", nr. 15/63, (12.04.1963), neni 61, në dispozicion në internet në linkun:
https://www.slvesnik.com.mk/Issues/37EB0C4961424D1286094520A974BBC9.pdf.

46 Po aty, neni 73.

47 Po aty, neni 74.

48 Po aty, neni 75.

zhvillohet në gjuhën maqedonase. Personat që nuk e dinë gjuhën maqedonase, kanë të drejtë të përdorin gjuhën e tyre para gjykatave"[49].

Në nenin 226 të kësaj kushtetute përcaktohet: *"Ligjet dhe dispozitat e tjera të organeve republikane, publikohen në gjuhën maqedonase në "Gazetën Zyrtare të Republikës Socialiste të Maqedonisë""*[50].

49 Po aty, neni 210.
50 Po aty, neni 226.

5. Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë e vitit 1974 dhe të drejtat gjuhësore dhe kulturore të shqiptarëve

Edhe Kushtetuta e vitit 1974 e Republikës Socialiste të Maqedonisë, si një nga fazat e zhvillimit kushtetues të vendit, cilësohet me përcaktime të ndryshme të pozitës së komuniteteve dhe të specifikave të organizimit të institucioneve themelore kushtetuese dhe në veçanti të funksionimit të administratës shtetërore. Kushtetuta e RSM-së e vitit 1974 kishte preambulën dhe tekstin normativ prej 450 neneve[51]. Në preambulën e saj, mes të tjerash, theksohej: *"Kombi maqedonas, së bashku me kombësitë e Maqedonisë, në Luftën e përbashkët Nacionalçlirimtare me kombet dhe kombësitë e tjera jugosllave, krijuan Republikën Socialiste të Maqedonisë, si shtet kombëtar i kombit maqedonas dhe shtet i kombësisë shqiptare dhe turke në të, në të cilën u realizuan aspiratat historike të kombit maqedonas për liri kombëtare dhe pavarësi shtetërore, të kombësive për barazi dhe të klasës punëtore dhe të të gjithë njerëzve punonjës për një shoqëri socialiste... se kombi maqedonas, në bazë të së drejtës për vetëvendosje, përfshirë edhe të drejtën për shkëputje, u bashkua vullnetarisht me kombet e tjera të Jugosllavisë, së bashku me kombësitë me të cilat jetojnë në një bashkësi federative socialiste të kombeve dhe kombësive të lira dhe të barabarta, i vetëdijshëm se vetëm në të mund të sigurojë kushte për zhvillimin e tij të lirë dhe gjithëpërfshirës kombëtar, material, politik dhe kulturor..."*[52].

Neni 1 i kësaj kushtetute RSM-në e përkufizonte: *"Shtet kombëtar i popullit maqedonas dhe shtet i kombësisë shqiptare dhe turke në të, bazuar në sovranitetin e popullit dhe në pushtetin dhe vetëqeverisjen e klasës punëtore dhe të të gjithë njerëzve punonjës dhe bashkësi demokratike socialiste vetëqeverisëse e njerëzve punonjës dhe qytetarëve, të kombit maqedonas dhe të kombësive shqiptare dhe turke*

51 Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë e vitit 1974, "Gazeta Zyrtare e RSM-së", nr. 7/74, (25.02.1974), në dispozicion në internet në vegzën:
https://www.slvesnik.com.mk/Issues/0AF2E0456C964935B7705FB5BF6F31F9.pdf.

52 Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë e vitit 1974, "Gazeta Zyrtare e RSM-së", nr. 7/74, (25.02.1974), pjesë nga preambula e saj, në dispozicion në internet në linkun:
https://www.slvesnik.com.mk/Issues/0AF2E0456C964935B7705FB5BF6F31F9.pdf.

të barabarta me të"[53]. Kur analizohet preambula e mësipërme, si dhe përkufizimi kushtetues i RSM-së, rrjedh se në këto përkufizime kushtetuese ishin të përziera tre lloje sovranitetesh, siç vijon: sovraniteti multietnik, sovraniteti qytetar dhe sovraniteti i klasës punëtore[54]. Po ashtu, kjo kushtetutë në raport me kushtetutën paraprake të vitit 1963 e avancoi pozitën kushtetuese të shqiptarëve dhe të turqve, për arsye se, nga njëra anë, edhe shqiptarët edhe turqit përcaktoheshin si subjekte konstituive së bashku me maqedonasit[55], ndërkaq, nga ana tjetër, shqiptarët dhe turqit nuk përkufizoheshin më si pakicë kombëtare, por si kombësi. Sipas kësaj kushtetute, në tërësi pozita e shqiptarëve si në Republikën Socialiste të Maqedonisë, po ashtu edhe në tërësi në kuadër të federatës jugosllave, ka qenë dukshëm më e avancuar, duke përfshirë këtu edhe statusin juridik kushtetues dhe politik të Kosovës. Pozita kushtetuese juridike e Kosovës, sipas Kushtetutës së ish-RSFJ-së të vitit 1974, në shumë sfera ishte e ngjashme (por jo krejtësisht e barabartë) me pozitën e republikave socialiste[56]. Për qëllimet e këtij studimi me rëndësi janë dispozitat e Kushtetutës së RSM-së të vitit 1974, si vijon:

Në nenin 173 të kësaj kushtetute përcaktohet: *"Puna e të gjitha organeve shtetërore, organeve të vetëqeverisjes shoqërore dhe organizatave që kryejnë veprimtari me interes publik bëhet në gjuhën maqedonase. Mosnjohja e gjuhës maqedonase nuk mund të jetë pengesë për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave dhe interesave të justifikuara të qytetarëve dhe të organizatave. Secilit i garantohet e drejta në procedurën para gjykatës ose organeve të tjera shtetërore dhe organizatave që gjatë ushtrimit të kompetencave publike vendosin për të drejtat dhe detyrimet e qytetarëve, të përdorin gjuhën e tyre dhe në atë procedurë të njihen me faktet në*

53 Po aty, neni 1.

54 Më gjerësisht shih në: Shkariq Svetomir, E drejta kushtetuese, botimi i tetë, Kultura, Shkup, 2015, f. 376-377.

55 Më gjerësisht shih në: Shkariq, Svetomir, Siljanovska-Davkova, Gordana, E drejta kushtetuese, Kultura, Shkup, 2009, fq. 394.

56 Arsim Bajrami, Sistemi kushtetues i Republikës së Kosovës, Prishtinë, 2011, fq. 47.

gjuhën e tyre"[57].

Në nenin 177 të kësaj kushtetute përcaktohet: *"Kombi maqedonas dhe kombësitë në Republikën Socialiste të Maqedonisë janë të barabartë dhe kanë të drejta dhe detyrime të njëjta. Komunat dhe Republika sigurojnë që kombësitë të përfaqësohen proporcionalisht në këshillat e komunave dhe në Kuvendin e Republikës Socialiste të Maqedonisë, si dhe të përfaqësohen në mënyrë adekuate në organet e tyre"*[58].

Në nenin 178 të kësaj kushtetute përcaktohet: *"Çdo kombësie i garantohet e drejta për të përdorur lirisht gjuhën e vet, për të shprehur dhe zhvilluar kulturën e vet dhe për të krijuar institucione dhe organizata që i sigurojnë këto të drejta. Komunat dhe Republika kujdesen për zhvillimin e edukimit dhe të arsimit, si dhe zhvillimin e shtypit, radios, televizionit dhe veprimtarive kulturore në gjuhët e kombësive. Kombësitë kanë të drejtë të përdorin flamurin e kombësisë së tyre"*[59].

Në nenin 179 të kësaj kushtetute përcaktohet: *"Në vendet ku jetojnë kombësitë, arsimimi dhe edukimi i anëtarëve të kombësive realizohet në shkollat, përkatësisht departamentet dhe institucionet arsimore, ku mësimi dhe edukimi realizohen në gjuhën e kombësisë përkatëse. Me ligj rregullohen kushtet për krijimin, organizimin dhe punën e shkollave dhe të departamenteve, ku zhvillohet mësimi në gjuhët e kombësive"*[60].

Në nenin 180 të kësaj kushtetute përcaktohet: *"Në zonat ku jetojnë pjesëtarët e kombësive, në jetën publike dhe shoqërore, gjuhët dhe alfabetet e kombësive janë të barabarta me gjuhën maqedonase. Në komunat ku jetojnë pjesëtarët e kombësive, vendimet dhe aktet e tjera të rëndësishme të këshillave komunale dhe të organizatave të punës së bashkuar dhe të organizatave të tjera vetëqeverisëse,*

57 Kushtetuta e Republikës Socialiste të Maqedonisë e vitit 1974, "Gazeta Zyrtare e RSM-së", nr. 7/74, (25.02.1974), neni 173, në dispozicion në internet në linkun:
https://www.slvesnik.com.mk/Issues/0AF2E0456C964935B7705FB5BF6F31F9.pdf.
58 Po aty, neni 177.
59 Po aty, neni 178.
60 Po aty, neni 179.

publikohen në gjuhët e kombësive. Mbishkrimet publike në këto zona janë gjithashtu edhe në gjuhët e kombësive"[61].

Në nenin 181 të kësaj kushtetute përcaktohet: *"Pjesëtarët e kombësive kanë të drejtë ta përdorin gjuhën dhe alfabetin e tyre në realizimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre, si dhe në procedurën para organeve shtetërore dhe organizatave që kryejnë autorizime publike"*[62].

Në nenin 182 të kësaj kushtetute përcaktohet: *"Me ligjin dhe statutin e komunës, përcaktohen kushtet dhe procedurat që sigurojnë realizimin e të drejtave të kombësive, si dhe mënyrën dhe kushtet për zbatimin e barazisë së gjuhëve dhe të alfabeteve të kombësive me gjuhën maqedonase, në zonat ku jetojnë kombësitë. Aktet e përgjithshme të organizatave të punës së bashkuar dhe të organizatave të tjera vetëqeverisëse, përcaktojnë mënyrën dhe kushtet për zbatimin e barazisë së gjuhëve dhe të alfabeteve të kombësive me gjuhën maqedonase, në zonat ku jetojnë kombësitë"*[63].

Në nenin 183 të kësaj kushtetute përcaktohet: *"Në këshillat e komunave, në territorin e të cilave jetojnë pjesëtarët e kombësive dhe në Kuvendin e Republikës Socialiste të Maqedonisë, formohet komisioni i marrëdhënieve ndëretnike. Komisioni monitoron dhe shqyrton realizimin e barazisë së kombësive dhe të drejtave të tyre të tjera të përcaktuara me kushtetutë dhe ligje dhe propozon masa për realizimin e tyre. Në komisionin e marrëdhënieve ndëretnike zgjidhet një numër i barabartë i pjesëtarëve të kombit maqedonas dhe kombësisë shqiptare dhe asaj turke"*[64].

Në nenin 220 të kësaj kushtetute përcaktohet: *"Qytetarit i garantohet liria e deklarimit të përkatësisë së një kombi ose kombësie ose grupi etnik, liria e shprehjes së kulturës kombëtare dhe liria e përdorimit të gjuhës dhe alfabetit të tyre. Qytetari*

61 Po aty, neni 180.
62 Po aty, neni 181.
63 Po aty, neni 182.
64 Po aty, neni 183.

nuk është i detyruar të deklarojë se cilit komb ose cilës kombësi ose grupi etnik i përket, as të përcaktohet për përkatësinë ndaj njërit prej kombeve, kombësive ose grupeve etnike. Është kundërkushtetuese dhe e ndëshkueshme çdo propagandë ose zbatim i pabarazisë kombëtare, si dhe çdo nxitje e urrejtjes dhe mostolerancës kombëtare, racore ose fetare"[65].

Në nenin 263 të kësaj kushtetute përcaktohet: *"Ligjet dhe dispozitat e tjera të organeve republikane publikohen në gjuhën maqedonase në "Gazetën Zyrtare të Republikës Socialiste të Maqedonisë""*[66].

Në nenin 293 të kësaj kushtetute përcaktohet: *"Mbrojtja territoriale është pjesë e mbrojtjes së përgjithshme të Republikës, një pjesë integrale e forcave të armatosura të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe forma më e gjerë e organizimit të popullit për rezistencë të armatosur. Mbrojtja territoriale përbëhet nga shtabet, njësitë, institucionet dhe format e tjera të rezistencës së përgjithshme të armatosur popullore, të cilat formohen dhe organizohen nga Republika, komunat dhe organizatat e punës së bashkuar. Në shtabet, njësitë dhe institucionet e mbrojtjes territoriale zbatohet parimi për përfaqësimin më proporcional të pjesëtarëve të kombësive të Republikës, si dhe barazia e gjuhëve dhe e alfabetit të tyre. Në njësitë e mbrojtjes territoriale, të përbëra nga pjesëtarët e kombësive, në komandimin dhe stërvitjen e tyre përdoret gjuha e asaj kombësie"*[67].

Në këtë aspekt, vlen të theksohet se çështja rreth përdorimit të gjuhës në komunikimin publik, përkatësisht çështja e barazisë së gjuhëve dhe alfabeteve të bashkësive etnike ka një rëndësi të madhe juridike kushtetuese dhe politike në shtetet multietnike, siç është Maqedonia e Veriut dhe siç ishte edhe ish-federata jugosllave për arsye se "gjuha si mjet komunikimi dhe si dukuri shoqërore i afron njerëzit dhe njëherësh cilësohet si mjaft e rëndësishme që karakterizon një bashkësi

65 Po aty, neni 220.
66 Po aty, neni 263.
67 Po aty, neni 293.

etnike të njerëzve (kombin)"[68]. "Në mesin e çdo bashkësie zhvillohet gjuha përkatëse, e cila u nënshtrohet ndryshimeve gjatë historisë së vet, derisa nuk ka marrë formën e një gjuhe të popullit në gjirin e një bashkësie etnike"[69]. "Gjuha është mjet i shprehjes së vetëdijes së njeriut... dhe instrument i demokracisë së drejtpërdrejtë..."[70].

Kushtetuta e ish-RSFJ-së këtë çështje e rregullonte në mënyrë parimore, domethënë u jepte mundësinë kushtetutave të republikave dhe të krahinave autonome, që këtë çështje ta përpunojnë dhe ta zgjerojnë edhe më tej në pajtim me të[71]. Mirëpo, "dispozitat kushtetuese të ish-RSM-së, përkundër faktit se paraqesin shtetin e kombit maqedonas dhe të kombësisë shqiptare dhe asaj turke, ato si të tilla ngelnin herë-herë formale, meqë përdorimi dhe aplikimi i tyre në jetën e përditshme nuk ishte i kënaqshëm, veçanërisht në territoret përkatëse ku jetojnë pjesëtarët e një kombësie apo të kombësive të përziera"[72]. Prandaj mund të konkludohet se çështja e përdorimit të gjuhëve në ish-RSFJ, në aspektin normativ, është zgjidhur pa vështirësi të mëdha dhe në mënyrë parimore, por vështirësitë kanë qenë të natyrës praktike rreth zbatimit të dispozitave të saj kushtetuese. Kështu Kushtetuta e ish-RSFJ-së parashihte: "Pjesëtarët e kombësive, në pajtim me kushtetutën dhe ligjin, kanë të drejtë të përdorin gjuhën dhe alfabetin e vet në realizimin e të drejtave dhe detyrimeve të tyre, si dhe në procedurën para organeve shtetërore dhe organizatave që ushtrojnë autorizime publike" (neni 171 parag.1); "Gjuhët dhe alfabetet e kombeve dhe të kombësive janë të barabarta në territorin e Jugosllavisë. Në RSFJ, në përdorim

68 Osman Ismaili, "Si është shtruar çështja e barazisë së gjuhës dhe shkrimeve të kombeve e të kombësive në kushtetutat e republikave dhe të krahinave socialiste autonome", E DREJTA-PRAVO, 3-4, 1981, Prishtinë; fq. 183. (Cituar sipas: Lukič, Radomir, Uvod u pravo, Beograd, 1971, fq. 37).

69 Po aty, cituar sipas: Esat Stavileci, "Ravnopravna upotreba jezika i pisama naroda i narodnosti Jugoslavije u upravnom postupku (Stanje i problemi u praksi)", Obilježje, nr.3/1978, Priština, fq.143.

70 Po aty, fq. 187.

71 Po aty, fq. 184.

72 Po aty, fq. 188. Në këtë drejtim autori dhe profesori i Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës Osman Ismaili i sjell edhe rastet ku gjatë realizimit të të drejtave dhe detyrimeve në procedurën e rregullt të gjykatës komunale në Tetovë, nuk janë respektuar dispozitat përkatëse kushtetuese, edhe atëherë kur personi zyrtar ka qenë i përkatësisë kombëtare të palëve kontestimore, p.sh.: lëndët penale K.br.108/83; K.br.138/83, lëndët kontestimore p.sh.: P.1378/82, P.br.334/83, etj, duke konkluduar se: "Aplikimi i drejtë i gjuhëve dhe i shkrimeve të kombeve dhe të kombësive nuk lë hapësirë dhe mundësi për majorizimin e një kombi ndaj kombit dhe kombësive të tjera". Po aty, fq.189.

zyrtar janë gjuhët e kombeve, ndërkaq gjuhët e kombësive përcaktohen në pajtim me këtë kushtetutë dhe me ligjin federativ". (Neni 246)[73]. Mirëpo, degradimi i këtij statusi të mësipërm kushtetues të shqiptarëve, por edhe të turqve, sipas zgjidhjeve kushtetuese të vitit 1974, erdhi nëpërmjet agresionit kushtetues të vitit 1989 me amendamentet e atëhershme kushtetuese të RSM-së të vitit 1974, me çka kombësia shqiptare dhe ajo turke i fshinë si subjekte konstituive të shtetit dhe, po ashtu, u degraduan të drejtat gjuhësore kushtetuese të tyre, si dhe përdorimi i flamurit kombëtar, ndërkaq kombi maqedonas u përurua si subjekti i vetëm konstituiv i shtetit, duke e përkufizuar RSM-në si shtet vetëm të kombit maqedonas dhe gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, u bë gjuha e vetme në përdorim zyrtar dhe publik në RSM, gjë që ishte edhe pasojë e ndikimit të drejtpërdrejtë të asaj kohe të politikës gjenocidale të diktatorit serb Sllobodan Millosheviq në Maqedoni, paralelisht me shfuqizimin e autonomisë kushtetuese të Kosovës, duke shënuar kështu zbatimin e politikave agresive dhe planeve për prishjen e federatës jugosllave, e cila më pas e shkaktoi luftën civile në ish-Jugosllavi[74]. Në këtë pikëpamje, së pari më 14 prill të vitit 1989 Kuvendi i Republikës Socialiste të Maqedonisë e miratoi Vendimin e shpalljes së amendamenteve kushtetuese prej XXIV deri LV për Kushtetutën e Republikës Socialiste të Maqedonisë, me çka për qëllimet e këtij studimi është me rëndësi amendamenti kushtetues XLIII, sipas të cilit: *"Në Republikën Socialiste të Maqedonisë, gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik janë në përdorim zyrtar dhe publik. Pjesëtarët e kombësive kanë të drejtë ta përdorin lirisht gjuhën dhe alfabetin e tyre dhe ta shprehin dhe ta zhvillojnë kulturën e tyre, dhe për këtë arsye të themelojnë organizata. Pjesëtarët e kombësive kanë të drejtën e mësimit në gjuhën e tyre në*

73 Arsen Janevski, "Përdorimi i gjuhës para gjykatës në proces gjyqësor", Procedura-Integrimi Europian-idetë, kushtet, realizimi, Fakulteti Juridik, Shkup, 2002, f. 55-56.


74 Më gjerësisht shih në: Jeton Shasivari, "The Past and the Present of the Constitutional Systems of the Republic of Macedonia in terms of the position of Albanians", European Scientific Journal, June 2013 edition vol. 9, No. 17, fq. 191, në dispozicion në internet në linkun:
file:///C:/Users/hp/Downloads/1166-Article%20Text-3472-1-10-20130630%20(2).pdf.

pajtim me kushtetutën dhe ligjin"[75]. Ky amendament kushtetues përmbajtësisht i degradoi të drejtat e fituara kombëtare të shqiptarëve, por edhe të turqve sipas Kushtetutës së RSM-së të vitit 1974 lidhur me të drejtat gjuhësore dhe të drejtën e përdorimit të flamurit kombëtar, për arsye se, sipas tij, në RSM, në përdorim zyrtar dhe publik, është vetëm gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, ndërsa kombësitë nuk kanë më të drejtë ta përdorin flamurin e kombësisë së tyre, ndërkaq, po ashtu degradohet edhe statusi kushtetues i gjuhës shqipe dhe asaj turke, sepse sipas tij, pjesëtarët e kombësive nuk e kanë më të garantuar dhe të siguruar me kushtetutë të drejtën për ta përdorur lirisht gjuhën dhe alfabetin e tyre, ndërkaq, nga ana tjetër, edhe e drejta e mësimit në gjuhën e kombësisë do të realizohet sipas statusit tashmë degradues kushtetues të të drejtave gjuhësore. Në këtë aspekt, agresioni i dytë kushtetues ndaj statusit kushtetues të shqiptarëve, por edhe të turqve, ndodhi më 19 korrik të vitit 1989, kur Kuvendi i Republikës Socialiste të Maqedonisë e miratoi Vendimin e shpalljes së amendamentit kushtetues LVI për Kushtetutën e Republikës Socialiste të Maqedonisë, me çka, sipas këtij amendamenti kushtetues,"Republika Socialiste e Maqedonisë është shtet kombëtar i kombit maqedonas, i bazuar në sovranitetin e popullit dhe pushtetin dhe vetëqeverisjen e klasës punëtore dhe të gjithë njerëzve punonjës, si dhe bashkësi socialiste demokratike vetëqeverisëse e njerëzve punonjës dhe qytetarëve, e kombit maqedonas dhe të barabartë me të, e pjesëtarëve të popujve të tjerë dhe të kombësive që jetojnë në të"[76]. Po ashtu ky amendament përmbajtësisht e degradoi statusin kushtetues të shqiptarëve, por

75 Vendimi për shpalljen e amendamenteve kushtetuese XXIV deri LV për Kushtetutën e Republikës Socialiste të Maqedonisë, Amendamenti Kushtetues XLIII, "Gazeta Zyrtare e RSM-së", nr. 16/89 (15.04.1989), fq. 9, në dispozicion në internet në linkun:
https://www.slvesnik.com.mk/Issues/87E1D2E9B0BF4693BCF5A50D69BE170C.pdf. Pika 1 zëvendëson paragrafin 1 të nenit 173 dhe paragrafin 4 të nenit 293; pika 2 zëvendëson paragrafët 1 dhe 3 të nenit 178; pika 3 zëvendëson nenin 179 të Kushtetutës së RSM-së të vitit 1974.

76 Vendimi për shpalljen e Amendamentit Kushtetues LVI për Kushtetutën e Republikës Socialiste të Maqedonisë, "Gazeta Zyrtare e RSM-së", nr. 29/89 (26.07.1989), fq. 6, në dispozicion në internet në linkun:
https://www.slvesnik.com.mk/Issues/245BBB86D1354148B0725DC74D5D893A.pdf. Me këtë Amendament Kushtetues fshihen fjalët: "dhe shtet i kombësisë shqiptare dhe turke në të", në alinenë 2 të paragrafit 1 të Preambulës; zëvendësohet paragrafi 1 i nenit 1; shfuqizohet neni 2; dhe shtohen fjalët: "pjesëtarët e popujve të tjerë" në nenet 3 dhe 4 të Kushtetutës së RSM-së.

edhe të turqve, sepse e zëvendësoi sovranitetin multietnik të Kushtetutës së RSM-së të vitit 1974 me sovranitetin monoetnik dhe shtetin e RSM-së e përkufizoi si shtet kombëtar të kombit maqedonas, me çka kombësia shqiptare dhe ajo turke nuk ishin më subjekte konstituive të shtetit të RSM-së[77].



АМАНДМАН XLIII

1. Во Социјалистичка Република Македонија во службена и јавна употреба е македонскиот јазик и неговото писмо кирилица.

2. Припадниците на народностите имаат право слободно да го употребуваат својот јазик и писмо и да ја изразуваат и развиваат својата култура и заради тоа да основаат организации.

3. Припадниците на народностите имаат право на настава на својот јазик во согласност со уставот и со закон.

4. Со точка 1 се заменуваат став 1 на член 173 и став 4 на член 293; со точка 2 се заменуваат ставовите 1 и 5 на член 178; со точка 3 се заменува член 179 од Уставот на СРМ.

Amendamenti kushtetues XLIII i vitit 1989 për Kushtetutën e RSM-së të vitit 1974.

Amendamenti XLIII

1. Në Republikën Socialiste të Maqedonisë në përdorim zyrtar dhe publik është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.


2. Pjesëtarët e popujve kanë të drejtë ta përdorin lirshëm gjuhën dhe alfabetin e tyre, si dhe ta shprehin dhe zhvillojnë kulturën e tyre, si dhe me këtë të themelojnë organizata.

3. Pjesëtarët e popujve kanë të drejtën e mësimit në gjuhën e tyre, në pajtim me

77 Më gjërësisht shih në: Shkariq, Svetomir, Siljanovska-Davkova, Gordana, E drejta kushtetuese, Kultura, Shkup, 2009, fq. 377. Jeton Shasivari, E drejta kushtetuese, botimi i dytë, Furkan-ISM, Shkup, 2020, fq. 49.

kushtetutën dhe ligjin.

4. Me pikën 1, zëvendësohet paragrafi (1) i nenit 173 dhe paragrafi (4) i nenit 293; me pikën 2 zëvendësohen paragrafët (1) dhe (3) të nenit 178; me pikën 3, zëvendësohet neni 179 të Kushtetutës së RSM-së.



АМАНДМАН
НА УСТАВОТ НА СОЦИЈАЛИСТИЧКА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Овој амандман е составен дел на Уставот на Социјалистичка Република Македонија и влегува во сила со денот на неговото прогласување.

АМАНДМАН LVI

1. Социјалистичка Република Македонија е национална држава на македонскиот народ, заснована врз суверенеста на народот и врз власта и самоуправувањето на работничката класа и на сите работни луѓе, и социјалистичка самоуправна демократска заедница на работните луѓе и граѓаните, на македонскиот народ и на рамноправните со него припадници на другите народи и на народностите кои живеат во неа.

2. Со овој амандман се бришат зборовите: „и држава на албанската и турската народност во неа" во алинеја 2 на став 1 на преамбулата; се заменува став 1 на член 1; се укинува член 2; се додаваат зборовите: „припадниците на другите народи" во членовите 3 и 4 од Уставот на СРМ.

Amendamenti kushtetues LVI i vitit 1989 për Kushtetutën e RSM-së të vitit 1974.


AMENDAMENTET E KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SOCIALISTE TË MAQEDONISË

Ky amendament është pjesë përbërëse e Kushtetutës së Republikës Socialiste të Maqedonisë dhe hyn në fuqi në ditën e shpalljes.

AMENDAMENTI LVI

1. Republika Socialiste e Maqedonisë është shteti i popullit maqedonas, e bazuar mbi sovranitetin e popullit, pushtetit dhe vetë udhëheqjes së klasës punëtore dhe të gjithë personave punëtorë, si dhe të komunitetit socialist vetudhëheqës demokratik të personave punëtorë dhe qytetarëve të popullit maqedonas dhe të barabartë me pjesëtarët e popujve të tjerë dhe popujt që jetojnë në të.

6. Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e vitit 1974 dhe të drejtat gjuhësore e kulturore të shqiptarëve



СЛУЖБЕН ВЕСНИК
НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

„Службен весник на Република Македонија" излегува по потреба. Рок за рекламации 15 дена.

Петок, 22 ноември 1991
Скопје
Број 52 Год. XLVII

Аконтацијата за 1991 година изнесува 1.300 динари. Овој број чини 40 динари. Жиро сметка 40100-603-12498

998.

Врз основа на член 443 од Уставот на Република Македонија, Собранието на Република Македонија на седницата одржана на 17 ноември 1991 година, донесе

ОДЛУКА

ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА УСТАВОТ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Се прогласува Уставот на Република Македонија, што го усвои Собранието на Република Македонија на седницата одржана на 17 ноември 1991 година.

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Бр. 08-4642/1
17 ноември 1991 година
Скопје

Претседател
на Собранието на Република Македонија,

УСТАВ
НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

I. ОСНОВНИ ОДРЕДБИ

Член 1

Република Македонија е суверена, самостојна, демократска и социјална држава.

Суверенитетот на Република Македонија е неделлив, неотуѓив и непренослив.

Член 2

Во Република Македонија суверенитетот произлегува од граѓаните и им припаѓа на граѓаните.

Граѓаните на Република Македонија власта ја остваруваат преку демократски избрани претставници, по пат на референдум и други облици на непосредно изјаснување.

Член 3

Територијата на Република Македонија е неделива и неотуѓива.

Постојната граница на Република Македонија е неповредлива.

Kushtetuta e RM-së e vitit 1991.

GAZETA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Në bazë të nenit 443 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në seancën e mbajtur më 17 nëntor 1991, miratoi:

VENDIM PËR SHPALLJEN E KUSHTETUTËS SË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Shpallet Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë që e miratoi Kuvendi i Republikës së Maqedonisë në seancën e mbajtur më 17 nëntor të vitit 1991.

KUVENDI I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Nr. 08-4642/1

17 nëntor 1991 Shkup

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

I. DISPOZITAT THEMELORE

Neni 1

Republika e Maqedonisë është shtet sovran, i pavarur, demokratik dhe social.

Sovraniteti i Republikës së Maqedonisë është i pandarë, i patjetërsueshëm dhe i pabartshëm.

Neni 2

Në Republikën e Maqedonisë, sovraniteti del nga qytetarët dhe u takon qytetarëve.

Qytetarët e Republikës së Maqedonisë, pushtetin e ushtrojnë nëpërmjet përfaqësueseve të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet referendumit dhe formave të tjera të shprehjes së drejtpërdrejtë.

Neni 3

Territori i Republikës së Maqedonisë është e pandarë dhe i patjetërsueshëm.

Kufiri ekzistues i Republikës së Maqedonisë është i pacenueshëm.

Pas pavarësimit të Maqedonisë së Veriut në vitin 1991, zhvillimi kushtetues i saj shënon dy faza: fazën e parë që përfshin periudhën kohore nga miratimi i Kushtetutës së RM-së më 17.11.1991 deri në nënalfabetin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit më 13.8.2001 dhe fazën e dytë që përfshin periudhën kohore pas nënalfabetit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit deri në ditët e sotme[78].

Faza e parë e zhvillimit kushtetues karakterizohet me miratimin e kushtetutës së vendit, që kaloi pa konsensusin e duhur themeltar ndëretnik, përkatësisht vetë themelimi i RM-së si shtet sovran dhe i pavarur, u veçua me ekskluzivitetin nacionalist të politikanëve të atëhershëm maqedonas përballë kërkesave të politikanëve shqiptarë për shqiptarët si popull konstituiv në sistemin kushtetues dhe politik të vendit, përkatësisht për konstituimin e RM-së si një shtet multietnik.

78 Më gjerësisht shih në: Jeton Shasivari, "Statusi i Shqiptarëve në sistemin kushtetues, juridik dhe politik të Republikës së Maqedonisë", Revista për çështje juridike dhe shoqërore: E DREJTA, viti XXXVII, Nr 1-2012, fq. 99-114, Fakulteti juridik, Prishtinë.

Si pasojë e kësaj, Kushtetuta e RM-së nuk e mori përkrahjen e deputetëve të atëhershëm shqiptarë, të cilët nuk u pajtuan me konceptin e imponuar të kombit shtet. Krejt kjo ishte një refleksion i qëndrimit mbizotërues të asaj kohe se kushtetuta medoemos duhet të miratohet (imponohet) me çfarëdo çmimi, madje edhe përkundër pakënaqësisë së popullit shqiptar dhe të përfaqësuesve të tij, gjë që paraqiste një zgjidhje jodemokratike dhe të padrejtë, sepse nënkuptonte imponimin e vullnetit nëpërmjet së drejtës formale të votes, përkatësisht nëpërmjet tiranisë së shumicës, sepse pas tij nuk qëndronte edhe vullneti i shqiptarëve si popull i dytë për nga numri brenda vendit[79]. Një veçori e tillë është më se e qartë, kur në njëzetvjetorin e miratimit të kësaj kushtetute, disa nga protagonistët e asaj kohe publikisht e pranuan se atëherë nuk ekzistonin botëkuptimet vizionare për të drejtat e shqiptarëve brenda vendit[80], përkatësisht se kushtetuta ishte një gabim i madh[81] ose nuk u tha qartë se çfarë Maqedonie do të ndërtohej në të ardhmen[82]. Për këto arsye Kushtetuta e RM-së e vitit 1991 nuk e dha provimin e pjekurisë demokratike si çdo kushtetutë demokratike në

79 Po aty.

80 Po aty. "Kur përkujtojmë atë kohë, duhet thënë se VMRO-DPMNE dhe personalisht unë, vërtet kishim një koncept të shprehur nacional për vendin, të mos e quaj koncept nacionalist, që nuk kishte të bënte vetëm me pavarësimin e vendit, por edhe me rregullimin e brendshëm. Atë periudhë e vlerësoj si një koncept jovizionar. Kur bëj analizën e asaj periudhe, absolutisht nuk e paskam kuptuar nevojën e shqiptarëve që të kenë më tepër të drejta. Ky nuk ishte vetëm gabimi im, por ishte një atmosferë e përgjithshme në Maqedoni, ndoshta ishte një ndikim i tërthortë i Millosheviqit në vendin tonë. Partitë politike maqedonase, të proveniencës së majtë dhe të djathtë, (përfshirë këtu edhe Kiro Gligorovin) nuk arritën që në një mënyrë vizionare t'i shikojnë shqiptarët dhe qysh në start t'u jepen më tepër të drejta që të parandalohen disa ngjarje të mëvonshme". Intervistë e Ljubço Georgievskit, ish-lider i VMRO-DPMNE-së për gazetën ditore: "УТРИНСКИ ВЕСНИК", me titull: "Бевме многу наивни"-"Ishim shumë naivë", numër 3668, të datës: 29.8.2011.

81 Po aty. "Gabimi i tretë ishte Kushtetuta. Unë isha udhëheqës i Komisionit për çështje kushtetuese dhe nuk kishim sukses që te shqiptarët të ruajmë të drejtën e fituar për përdorimin e gjuhës. Ne madje i privuam ata edhe nga të drejtat e fituara, dhe prapseprapë Kushtetuta u mbiquajt si një akt tradhtie. Kishim një marrëveshje që më 14.11.1991 të votojmë, mirëpo VMRO-DPMNE bëri të ditur se u ka ndaluar deputetëve të votojnë për një kushtetutë të tillë, që e mbiquajtën si tradhtare dhe organizuan demonstrata të mëdha. Por, ne nuk lëshuam pe përballë demonstratave, mirëpo megjithatë ndërhymë në të drejtat e fituara të shqiptarëve me Kushtetutën paraprake të vitit 1974 dhe i zvogëluam ato. Ky ishte një gabim i madh dhe një prej atuve kryesore që faktori i huaj, më pas vazhdimisht të na thoshte se ne e degraduam pozitën e shqiptarëve". Intervistë e Stojan Andovit, Kryetarit të parë të Kuvendit shumëpartiak të RM-së për gazetën ditore: "УТРИНСКИ ВЕСНИК", me titull: "Македонија доцна го фати чекорот"-"Maqedonia vonë e kapi hapin", numër 3656, të datës: 15.8.2011.

82 Po aty. "Gabimi i parë brenda Kushtetutës ishte se nuk u pranua ideja për përkufizimin e shtetit si një shtet qytetar ose, meqë kishte nevojë që të përmenden kolektivitetet, atëherë duhej përmendur edhe shqiptarët. Aty ishin edhe zgjidhjet rigjide për gjuhën, për arsimimin e lartë, për mënyrën e vendimmarjes në Kuvend. Mosbesimi ishte evident sepse as ne nuk u besonim partive politike maqedonase e as ato nuk u besonin partive politike shqiptare". Intervista e Abdurrahman Alitit për revistën javore: "PUBLIKA" me titull: "Nuk e thamë qartë se çfarë Maqedonie do të ndërtojmë", numër 4, të datës: 4.1.2011;

botë, përkatësisht secila kushtetutë demokratike i përshtatet realitetit dhe njerëzve për të cilët edhe shkruhet. Prandaj, këtë kushtetutë mund ta numërojmë në grupin e kushtetutave nominale sepse u shkrua për një realitet tjetër që nuk përputhej me realitetin në të cilin duhej të zbatohej, sepse nuk ishte kushtetutë që i përshtatej popullit shqiptar, por kushtetutë së cilës populli shqiptar duhej t'i përshtatej[83], andaj kjo kushtetutë nuk bashkëjetoi me realitetin, por vetëm me letrën ku ishte e shtypur dhe e shkruar[84].

Pra, faza e parë e zhvillimit kushtetues u veçua me modelin e autokracisë monoetnike të demokracisë multietnike brenda vendit, përkatësisht regjimin e privilegjuar kushtetues të rezervuar për maqedonasit etnikë, me çka çfarëdo orvatje për marrëveshje politike, konsensusi dhe dialogu për të drejtat legjitime të shqiptarëve përfundonte me mbivotim (majorizim) si në kuvend, ashtu edhe në institucionet e tjera. Po ashtu, disa nga kërkesat legjitime ishin edhe statusi konstituiv për shqiptarët, gjuha shqipe si gjuhë zyrtare me kushtetutë, përdorimi i flamurit kombëtar, arsimi sipëror në gjuhën shqipe, përfaqësimi i plotë i shqiptarëve në jetën shtetërore dhe publike në të gjitha nivelet[85], barazia kombëtare, mosdiskriminimi ku në veçanti diskriminimi ekonomik kishte të bënte me procesin e privatizimit të kapitalit shoqëror në vitin 1993, me çka një pjesë e papërfillshme e kapitalit shoqëror kaloi në duar të shqiptarëve për shkaqe politike dhe etnokratike[86].

83 Loewenstein, Karl, Political Power and the Governmental Process, Chicago, 1957, p. 203-205.

84 Më gjerësisht shih në: Jeton Shasivari, "Statusi i Shqiptarëve në sistemin kushtetues, juridik dhe politik të Republikës së Maqedonisë", Revista për çështje juridike dhe shoqërore: E DREJTA, viti XXXVII, Nr 1-2012, fq. 99-114, Fakulteti juridik, Prishtinë.

85 Të dhënat e vitit 1991 tregojnë se në sektorin shtetëror dhe publik sipas përkatësisë kombëtare: 85% e të punësuarve ishin maqedonas; vetëm 7% e të punësuarve ishin shqiptarë; 2.4% ishin serbë; 1.7% ishin turq; 1.4% ishin romë; 0.4% ishin vlleh etj. Më gjerësisht shih në: Славко Милосавлевски, Мирче Томовски, Албанците во Република Македонија 1945-1995, легислатива, политичка документација, статистика, НИП Студентски збор, Скопје, 1997, стр. 318.

86 Po aty. "Bëmë një privatizim të keq. Tek ekspertët mbizotëronte mendimi për modelin e vauçerëve si më të pranueshëm për RM-në. Unë nuk kam qenë i pranishëm kur është marrë qëndrimi përfundimtar për modelin e privatizimit, mirëpo, shumë mirë e di dhe absolutisht është e vërtetë se në momentin e fundit, motivi vendimtar ka qenë ai politik, e jo ekonomik. Të gjithë i ka heshtur formulimi i dhënë nga Kryetari Gligorov: "Po, ndoshta është ashtu, mirëpo a jeni të vetëdishëm se nëse e pranojmë modelin e vauçerëve, mbi 40% e kapitalit shoqëror do të kalojë në duar të jomaqedonasve, kurse me këtë që propozoj unë, ne do të arrijmë që kapitali shoqëror të kalojë në duart e maqedonasve me mbi 90%, dhe tani ju zgjedhni modelin më të mirë". Intervista e Abdurahman Alitit për revistën javore: "PUBLIKA" me titull: "Nuk thamë qartë se çfarë Maqedonie do të ndërtojmë", numër 4, të datës: 04.01.2011.

Kjo kushtetutë nuk e kishte përkrahjen e deputetëve shqiptarë, të cilët, si përfaqësues të popullit shqiptar në Kuvendin e RM-së, nuk ishin të kënaqur me statusin kushtetues të shqiptarëve, sidomos me statusin e gjuhës shqipe dhe të drejtat kulturore, dhe një gjë e tillë, dhjetë vjet më pas u vlerësua si shkaku kryesor për konfliktin e armatosur të vitit 2001[87].

Kushtetuta e RM-së e vitit 1991 ka preambulën dhe tekstin normativ prej 134 neneve[88].

Në preambulën e Kushtetutës së RM-së të vitit 1991 thuhej: *"Duke u nisur nga trashëgimia historike, kulturore, shpirtërore dhe shtetërore e popullit maqedonas, dhe nga lufta e tij shekullore për liri nacionale dhe sociale, dhe për krijimin e shtetit të vet, e veçanërisht nga traditat shtetërore juridike të Republikës së Krushevës, dhe vendimeve historike të KAÇKM-së dhe kontinuitetit kushtetues juridik të shtetit maqedonas si republikë sovrane në federatën jugosllave, nga vullneti i shprehur lirisht i qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në Referendumin e 8 shtatorit të vitit 1991, si dhe nga fakti historik se Maqedonia është konstituuar si shtet nacional i popullit maqedonas në të cilin sigurohet barazia e plotë qytetare dhe bashkëjetesa e përhershme e popullit maqedonas me shqiptarët, turqit, vllehtë, romët dhe nacionalitetet e tjera që jetojnë në Republikën e Maqedonisë, e me qëllim që:*

- Republika e Maqedonisë të konstituohet si shtet sovran dhe i pavarur dhe si shtet qytetar dhe demokratik;

- të vendoset dhe të ndërtohet sundimi i së drejtës si sistem themelor i pushtetit;

- të garantohen të drejtat e njeriut, liritë qytetare dhe barazia nacionale;

- të sigurohet paqja dhe bashkëjetesa e popullit maqedonas me kombësitë që jetojnë në Republikën e Maqedonisë; dhe

87 Më gjërësisht shih në: Shkariq Svetomir, E drejta kushtetuese, botimi i tetë, "Kultura", Shkup, 2015, f. 256.

88 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e v. 1991, "Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 52/91 (22.11.1991), në dispozicion në internet në linkun:
https://www.slvesnik.com.mk/Issues/19D704B29EC040A1968D7996AA0F1A56.pdf.

- të sigurohet drejtësia sociale, mirëqenia ekonomike dhe përparimi i jetës personale dhe të përbashkët. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë miraton Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë"[89].

Për qëllimet e këtij studimi lidhur me të drejtat gjuhësore dhe kulturore, me rëndësi janë dispozitat kushtetuese të nenit 7 dhe të nenit 48 të kësaj kushtetute. Kështu, në nenin 7 të Kushtetutës së RM-së të vitit 1991 përcaktohet: *"Në Republikën e Maqedonisë gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Në njësitë e vetadministrimit lokal, në të cilat si shumicë jetojnë pjesëtarët e nacionaliteteve, në përdorim zyrtar, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik, janë edhe gjuha dhe alfabeti i nacionaliteteve në mënyrë të përcaktuar me ligj. Në njësitë e vetadministrimit lokal, ku në numër të konsiderueshëm jetojnë pjesëtarët e nacionaliteteve, në përdorim zyrtar, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit cirilik, janë edhe gjuha dhe alfabeti i nacionaliteteve, në kushte dhe në mënyrë të përcaktuar me ligj"*[90]. Ndërkaq, në nenin 48 të Kushtetutës së RM-së të vitit 1991 përcaktohet: *"Pjesëtarët e nacionaliteteve kanë të drejtë lirisht t'i shprehin, kultivojnë dhe zhvillojnë identitetin e tyre dhe veçoritë nacionale. Republika ua garanton nacionaliteteve mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar. Pjesëtarët e nacionaliteteve kanë të drejtë të themelojnë institucione kulturore dhe artistike, shoqata shkencore dhe shoqata të tjera me qëllim të shprehjes, kultivimit dhe zhvillimit të identitetit të tyre. Pjesëtarët e nacionaliteteve kanë të drejtë për mësim në gjuhën e tyre në arsimin fillor dhe atë të mesëm, në mënyrën e përcaktuar me ligj. Në shkollat, ku arsimimi zhvillohet në gjuhën e nacionalitetit, mësohet edhe gjuha maqedonase"*[91].

Në këtë aspekt, kur analizohet preambula e kësaj kushtetute e ndërlidhur me

89 Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë e v. 1991, "Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 52/91 (22.11.1991), Preambula, në dispozicion në internet në linkun:
https://www.slvesnik.com.mk/Issues/19D704B29EC040A1968D7996AA0F1A56.pdf.
90 Po aty, neni 7.
91 Po aty, neni 48.

dispozitat kushtetuese të neneve 7 dhe 48, mund të konkludohet fakti se, sado që qytetari është burim dhe bartës i sovranitetit (sovraniteti qytetar), prapëseprapë, edhe kjo kushtetutë vazhdoi me konceptin e sovranitetit monoetnik, meqë nuk e riktheu sovranitetin multietnik sipas Kushtetutës së RSM-së të vitit 1974, andaj, si rrjedhojë e kësaj, edhe në këtë kushtetutë shqiptarët nuk ishin subjekt konstituiv i shtetit dhe gjuha shqipe nuk e gëzonte statusin kushtetues të gjuhës zyrtare, dhe nuk njihej e drejta kushtetuese e përdorimit të flamurit kombëtar, si dhe nuk njihej e drejta për arsimimin sipëror në gjuhën shqipe.

Ky fakt i mësipërm është rrjedhojë e mungesës së konsensusit themeltar lidhur me miratimin e kësaj kushtetute si një parakusht i domosdoshëm për themelimin dhe funksionimin e shtetit demokratik. Siç shprehet profesori Denko Maleski, *"në vitin 1991 u përcaktuam për strategjinë që është karakteristike për shtetin në të cilin, krahas kombit titullar, nuk ekziston ndonjë komb tjetër. Në pajtim me këtë logjikë, ne vetë e votuam kushtetutën. Kështu liderët tanë politikë e dërguan porosinë se Maqedonia është e maqedonasve etnikë, sepse çdo shtet synon të bëhet shtet-komb, ndërkaq, çdo komb synon të bëhet shtet. Kjo gjë dikur edhe mund të shpallej, si në Francën e shek. XIX, dhe të realizohej në praktikë. Mirëpo sot, në fillim të shek. XXI, kjo politikë paraprakisht është e dënuar të dështojë"*[92].


92 Më gjerësisht shih në: Денко Малески, „Етничкиот баланс е можен само со консензуална демократија„, Утрински Весник, 04.10.2003, стр. 6.

KREU I DYTË

TË DHËNA EMPIRIKE MBI REALIZIMIN E TË DREJTAVE GJUHËSORE DHE KULTURORE TË SHQIPTARËVE 1946-2001

1. Të dhëna për realizimin e të drejtave gjuhësore dhe kulturore sipas zgjidhjeve kushtetuese të vitit 1946

Krahas përcaktimit të pozitës juridike kushtetuese të komuniteteve në periudha të ndryshme kohore, rëndësi të posaçme ka edhe aspekti i zbatimit praktik të këtyre zgjidhjeve kushtetuese, pavarësisht se sa kanë qenë adekuate dhe të duhura. Këtu qëndron edhe esenca e statusit juridik kushtetues të gjuhës shqipe dhe të gjuhëve të komuniteteve të tjera, sikurse sanksionimi në pakon e ligjeve, të cilat i përfshinë këto periudha dhe aspekti i zbatimit të tyre nga ana e organeve të administratës shtetërore dhe publike. Këtu është konkursi për shkollat e mesme, ku njëkohësisht potencohet se për nxënësit shqiptarë dhe për ata turq do të mbahet një kurs i veçantë, sipas të cilit ata duhet të kenë kryer klasën IV, pra të paktën theksohet edhe aspekti i komuniteteve.



останат на редовна учителска служба, како и за оние кои не се на учителска служба, а сакат да станат учители. Министерството на просветата ке организира два вида курса за нивното стручно подготвување.

I КУРС

Во овој курс ке се примат кандидати со завршен VI, VII и VIII класс гимназија и студенти кои имат еден или два семестра и кои до сега не биле учители а сакат да станат редовни основни учители. Во овој курс ке се примат и ученици кои завршиле III и IV клас на учителските школи. На курсистите кои ке го завршат со успех курсот ке им се издадат свидетелства за положениот испит кои ке им дадат законско право да бидат редовни основни учители.

II КУРС

Во овој курс ке се примат кандидати со завршен IV и V клас гимназија и со некој клас од некое средно стручно училиште (средно стопанско училиште, трговска академија, средно земјоделско училиште и т. н.) и ученици кои имат завршен I или II клас на учителските школи или педагошки институти. Исто така на овој курс ке се примат и учителки со завршено ниже стопанско училиште (раѓинишка школа), кои се сега на учителска служба.

Ако курсистите го завршат со успех курсот ке бидат назначени за привремени учители, кои ке вршат учителска служба и ке се добиваат плата. На курсистите кои го завршат со успех курсот ке им се издадат свидетелства. Привремените учители после едногодишна успешна учителска служба, ке се земат за уште еден курс за стручно подготвување и ако го успешно завршат и вториот курс ке бидат назначени за редовни учители. Исто така ке добијат свидетелство кое ке им даде законско право да бидат редовни основни учители.

Курсовите ке траијат од 10 јули до 30 септември 1945 година. Кандидатите треба да поднесат молба то Министерството најдоцна до 20 јуни. Молбите се поднесуват преку околиските народни одбори. Во молбата ке се назначи какво образование има кандидатот од каде е родом кога година е роден и на каква е работа. Кандидатите за овие курсови не можат да бидат помлади од 17 години. Поподробно ке се извести каде ке се држат курсовите и кои учители во кое место ке бидат распределени. Министерството предвидува дека за овие курсови ке се јават многу кандидати и затоа истите ке се држат во неколку места.

За албанските и турските учители ке се отворат одделни курсеви во гр. Скопје и тие треба да поднесат молба. За нив не важи предвиденото образование за учители македонци. Албанските и турските учители треба да имат најмалку IV одделение основна школа и школа стручна школа или некој клас гимназија. Нивните задолженија и права се исти како и за учителите македонци.

Од Министерството на просветата

положбјот кои завземат во државната администрација".

99 Më gjerësisht shih në: Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup: "Flaka e Vëllazërimit", abetare e dytë për shqiptarët, 04.04.2015, në dispozicion në internet në linkun: https://www.itsh.edu.mk/flaka-e-vellazerimit-abetare-e-dyte-per-shqiptaret/.

sportive. Sot shkolla numëron 937 nxënës, prej tyre 494 nxënës janë të ciklit të ulët dhe 443 janë të ciklit të lartë, me 76 të punësuar, ku prej tyre 20 janë me mësim klasor, 38 me mësim lëndor, 3 bashkëpunëtorë profesionalë dhe 15 kuadro administrativë teknikë[100].



JUGOSLLAVIJA FEDERATIVE
DEMOKRATIKE
ДЕМОКРАТСКА ФЕДЕРАТИВНА ЈУГОСЛАВИЈА
PARLAMENTI POPULLUER I MAKEDONISË
НАРОДНО СОБРАНИЕ НА МАКЕДОНИЈА

SHKOLLA FILLORE POPULLORE
НАРОДНО ОСНОВНО УЧИЛИШТЕ

Qytet. Kat. rrethi
во гр. сел околија
Qarku
Okrug
Nr. i amzës
Главна книга бр. 10

DËFTESË
СВИДЕТЕЛСТВО

i biri e bija
сен - керка на
nënshtetas
по народност
në
во
shteti
држава
për të parën herë në klasën dhe tregoj këtë zotësi:
за пат во одделение и го покажа овој успех:

lindur me 19
rrethi околија
qarku округ
vazhdoj vitin shkolluer 194 / 4
учение во учебната

Gjuhë shqip Албански јазик	Mjaft mirë	(3)
" makedonisht Македонски јазик	Mjaft mirë	(3)
Histori Историја	Mjaft mirë	(3)
Gjografi Географија	Mjaft mirë	(3)
H. Nature Природознание	Mjaft mirë	(3)
Arithmetikë Аритметика	Mjaft mirë	(3)
Kangë Песје	Shum mirë	(5)
Vizatim Цртање	Mjaft mirë	(3)
Bukurshkrim Краснопис	Mjaft mirë	(3)
Gjymnastik Гимнастика	Shum mirë	(5)
Punë dore Рачна работа	Mjaft mirë	3
Besim Веронаука	Shum mirë	(5)

Sjellje Shumë mirë (5)
Поведение
Mungesa: T'arrësyeshme të pa arrësyeshme
Изостанци: оправдани неоправдани
Në bazë të notavet të sipërme nxanësi (a) mbaroj me sukses klasën e
Според горните оценки учени го свршија со успех одделение

Mësuesi i Klasës
Учител на одделението

Vula M. P.

Drejtori
Раководител

Shum mirë (5) Mirë (4) Mjaft mirë (3) Mjaftueshëm (2) Dobët (1)
Одличен Многу добар Добар Доволен Недоволен

Dëftesë e vitit 1945 për nxënës të shkollës fillore në gjuhën shqipe dhe maqedonase.

4. 3 Gjimnazi "Zef Lush Marku" – Shkup

Gjimnazi "Zef Lush Marku" – Shkup është themeluar para 71 vitesh. Emri i tij ndërlidhet me heroin Zef Lush Marku, i lindur në vjeshtën e vitit 1885, në një familje të varfër zejtarësh prizrenase. Në kërkim të një jete më të mirë, i ati i Zefit, Gjergj

100 Më gjerësisht shih në ueb faqen e shkollës në dispozicion në internet në linkun: https://liria.edu.mk/per-ne/.

Marku, me familje shpërngulet në Shkup, atëherë qendër e shqiptarëve, ku ende pa i shijuar mirë bukuritë shkupjane, ndërron jetë. Humbja e babait e ngarkon edhe më shumë Zefin. Si djalë më i madh që ishte, mbi supe i bie barra të kujdeset për mirëqenien e familjes. Në fillim punon si punëtor krahu te punëdhënës të ndryshëm, e më pas punësohet në fabrikën e duhanit "Monopolin e Shkupit". Gjatë punës së tij frymëzohet dhe do të kultivojë ndjenjat liridashëse patriotike. Të vitit 1912, Zefi, punësohet në bankën serbo-franceze në Shkup, në fillim si korrier, e pastaj si nëpunës deri në likuidimin e tij. Zefi, që të vitit 1909, inkuadrohet në lëvizjet politike, me orientim socialdemokrat. Aktiviteti i tij shpejtë do t'u bjerë në sy organeve të pushtetit serb dhe do të jetë në përcjellje të vazhdueshme. Gjatë një udhëtimi, natën mes 2 dhe 3 dhjetorit të vitit 1920, i përcjellë, në Gjakovë, kapet nga forcat serbe. Nga tortura dhe keqtrajtimi mizor, në moshën 35-vjeçare ndërron jetë, duke u shndërruar në simbol të sakrificës së kauzës kombëtare. Në shenjë nderi dhe krenarie, emri i tij u përcoll brez pas brezi, duke emërtuar rrugë, shoqëri kulturoro-artistike dhe institucione, ndër to edhe ky gjimnaz.

Pushteti i atëhershëm i Republikës Popullore të Maqedonisë në kuadër të Republikës Popullore Federative të Jugosllavisë kishte hartuar plane dhe masa të shumta për organizimin e sistemit arsimor, i cili mund të ndahet në disa faza:

- Faza e kurseve të mësuesisë (1945-1953)
- Faza e seminareve të mësuesisë (1953-1961)
- Faza e arsimit të lartë pedagogjik dhe atij superior (1971 deri në ditët e sotme).

"Zef Lush Marku", si institucion arsimor, daton që nga faza e parë, ajo e kurseve të mësuesisë (1945-1953), atëherë me emrin Shkolla Normale Shqiptare "Liria", e më vonë, në vitin 1960, do të riemërtohet Shkolla Normale Shqiptare "Zef Lush Marku". Profesorët e parë të këtij gjimnazi ishin Vlash Gjelaj, Petro Janura, Xhavit Kaba, Pjetër Kavaja, Josif Todi, Abedin Krasniqi, Nadire Krasniqi, Sadudin Gjura, Shazije Hoxha, Eshref Saraçini, e shumë të tjerë, përplot vullnet dhe dëshirë shumë shpejt

"Zef Lush Markun" e shndërrojnë në qendër arsimore dhe kulturore shqiptare, duke përgatitur kuadro arsimore për shkollat shqipe[101]



СОЦИЈАЛИСТИЧКА ФЕДЕРАТИВНА РЕПУБЛИКА ЈУГОСЛАВИЈА
СОЦИЈАЛИСТИЧКА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Shkolla normale „Zef Lush Markun"

во SKKUP

Главна книга бр. 4

СВИДЕТЕЛСТВО

Begiri Bega Ramazan

Begiri Bega, родена на 6-III- 1949 г.

во K. Kosuriq, општина e Pejes, област —

Социјалистичка Република e Serbisë, државјанство R.S.F.J.

учениче во учебната 1966/1967 година Gjenie што во më 4 bekim клас

и го покажа овој успех:

Gjuja	Shkëlqyshem	(5)
Maqedonisht	Shkelqyshem	(5)
Anglisht	Shkelqyshem	(5)
Pedagogji	Shkelqyshem	(5)
Psikologji	Shkelqyshem	(5)
Fizikë	Sh. mirë	(4)
Matematikë	Sh. mirë	(4)
Bot me fq	Shkelqyshem	(5)
Histori	Sh. mirë	(4)
Geografi	Shkelqyshem	(5)
Biologji	Shkelqyshem	(5)
Muzikë	Shkelqyshem	(5)
Edukatë fizike	Shkëlqyshem	(5)
Punë praktike	Sh. mirë	(4)
Ansambël	Shkëlqyshem	(5)
Bot fizike	Shkëlqyshem	(5)

Владање: Shembullore

Изостаноци: извинети 1 неизвинети 1

Според горните оценки ученикот го стекна klasen e tetë - të клас

со општ успех Shkëlqyshem (5)

Во Shkup, 10-6- 1968 год. Бр. 563 ns 1968 год.

Класен раководител Директор

Образец за стекнат клас во сите стручни училишта

Оценки на успехот: одличен (5), многу добар (4), добар (3), доволен (2), недоволен (1).

Оценки на однесувањето: примерно, добро, незадоволително.

Одобрено од Републичкиот секретаријат за просвета со бр. 624/1203 од 20. III. 1964 година

Просветно дело — Скопје

тис 1221-67

Dëftesë e vitit 1968 për nxënës të shkollës fillore në vetëm në gjuhën maqedonase.

4. 4 Fakulteti Pedagogjik "Shën Klementi i Ohrit" – Shkup

Shkolla e Lartë Pedagogjike "Klementi i Ohrit" – Shkup, u hap me dekret të Qeverisë së Republikës Populllore të Maqedonisë në vitin 1947. Në fillim mësimi u mbajt në pesë grupe studimi, ndërkohë ky numër u rrit në 13, duke përfshirë edhe grupet e studimit në gjuhën shqipe dhe atë turke, dhe në vitin 1953 ky numër u rrit

101 Më gjerësisht shih në: Naser Miftari, "Zef Lush Marku", shkolla që jetësoi vizionin e rilindësve shqiptar!, KOHA, e përditshme informative, 30.04.2020, në dispozicion në internet në linkun: https://www.koha.mk/zef-lush-marku-shkolla-qe-jetesoi-vizionin-e-rilindesve-shqiptar/.

në 17. Kjo shkollë, në pajtim me Ligjin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, që në vitin 1961, u shndërrua në Akademi Pedagogjike. Nga themelimi i Shkollës Pedagogjike në vitin 1947 deri në fillimin e punës së Fakultetit Pedagogjik në vitin 1995, shkollimin për arsimtarë të gjuhës maqedonase, shqipe dhe asaj turke e kanë përfunduar 13.000 studentë. Aktualisht, Fakulteti Pedagogjik "Shën Klementi i Ohrit" është njësi brenda Universitetit "Shën Cirili dhe Metodi" në Shkup[102].

4. 5 Radiotelevizioni i Maqedonisë – RTVM

Radiotelevizioni i Maqedonisë (RTVM) është ndërrmarje publike, themelues i të cilit është Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Veprimtaria e RTVM-së është e definuar në mënyrë ligjore dhe konsiston në prodhim dhe emetim të programit radioteleviziv, nga të gjitha zhanret, të cilat duhet t'i përmbushin nevojat informative, kulturore, arsimore, edukative dhe ato rekreative të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Radiotelevizioni publik emeton program të ndarë në dy pjesë, programe radiofonike në 3 kanalet e radios dhe në programet televizive në 5 kanalet e Televizionit të Maqedonisë, si dhe në 2 kanale satelitore dhe atë të kuvendit. Radioja e Maqedonisë ka filluar punën më 28 dhjetor të vitit 1944, (me emrin Radio Shkupi), me transmetimin e Mbledhjes së Dytë të KAÇKM-së. Kjo datë shënohet si Dita e RTVM-së. Më 28 janar 1945 në eterin radiofonik është dëgjuar për herë të parë edhe gjuha shqipe, dhe kjo datë merret si datë e lindjes edhe e radios shqipe në Maqedoni. Kanali i Tretë i Radios së Maqedonisë - Radio Shkupi, emeton çdo ditë 17 orë e gjysmë program në gjuhën shqipe, duke përmbushur misionin fisnik të informacionit, edukimit dhe argëtimit të dëgjuesve të medies publike në gjuhën shqipe. Gjithashtu, Kanali i Tretë i Radios së Maqedonisë - Radio Shkupi, emeton program edhe në gjuhët e komuniteteve joshumicë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Si fillim zyrtar i punës së Televizionit të Maqedonisë (më herët

102 Më gjerësisht shih në ueb faqen e këtij institucioni të lartë arsimor në: https://www.pfsko.ukim.edu.mk/?page_id=62

Televizioni i Shkupit) merret 14 dhjetori i vitit 1964. Në vitin 1993 radiotelevizioni ndahet nga Bashkësia e Radiotelevizioneve Jugosllave. Me Ligjin e Veprimtarisë Radiodifuzive (24 prill 1997), Radiotelevizioni i Maqedonisë u nda në dy pjesë: Radiodifuzioni i Maqedonisë dhe Radiotelevizioni i Maqedonisë. Sipas nenit 77 të Ligjit të Radiodifuzionit, Radiotelevizionit të Maqedonisë i takonte në atë kohë 61% nga taksa e grumbulluar radiodifuzive. Aktualisht kjo taksë është shfuqizuar dhe TVM-ja financohet drejtpërdrejt nga buxheti shtetëror. TVM-ja aktualisht emeton program në 5 kanale dhe në programe satelitore në shqip dhe maqedonisht. Kanali i parë i TVM-së emeton program në gjuhën maqedonase. Fillimi i emetimit të emisioneve në gjuhën shqipe është 17 prill 1967, me kronikën javore televizive. Kjo kronikë shënon edhe emetimin për herë të parë të emisioneve në gjuhën shqipe në të gjitha trevat shqipfolëse (Shqipëri, Kosovë, Mali i Zi, Lugina e Preshevës). TVM2 që nga marsi i vitit 2020 emeton 24 orë program ditor në gjuhën shqipe. Shikuesit e TVM2 në ekranin e kanalit në shqip mund të ndjekin emisione të shumta duke filluar nga ato edukative për fëmijë dhe të rinj, informative me aktualisht 6 edicione ditore (ditarët televizivë çdo ditë në orën 16:00,18:30 dhe 22:00, lajmet e mesditës në orën 12:00 dhe 3 edicione lajmesh flesh, në orën 09:00, 00:00, dhe 01:00). Duke përmbushur misionin e tij parësor, informimin, edukimin dhe argëtimin për shikuesit e vet, TVM2 ofron një spektër të gjerë programesh, me çka përfshin nevojat e të gjitha kategorive të shikuesve të medies publike. Katër programet e TVM2, programi informativ, programi arsimor shkencor, programi kulturor argëtues dhe programi i filmit dhe i dokumentarit, të ndarë në redaksi të veçanta, plotësojnë spektrin e larmishëm të programit duke përmbushur jo vetëm kërkesën e shikuesve, por edhe standardet e kërkuara ndërkombëtare të medies publike. Në kanalin e ri, TVM4, tashmë emetohen programet në gjuhën turke, serbe, rome, vllahe dhe boshnjake. TVM3 emeton program sportiv, e disa prej përmbajtjeve janë në audio dual, maqedonisht dhe në shqip. TVM5 është kanali televiziv që u kushtohet fëmijëve. Kanali i Kuvendit është

formuar në vitin 1991, atëherë si kanal eksperimental, kurse tani është dedikuar për aktivitetet e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut[103].

4. 6 Universiteti i Tetovës

Universiteti i Tetovës ka histori të shkurtër, por një të kaluar shumë të gjatë. Ky institucion u themelua më 17 dhjetor të vitit 1994 si iniciativë e intelektualëve shqiptarë, të shoqatave dhe asociacioneve të ndryshme apolitike dhe të gjithë dashamirëve të arsimit të lartë në vend dhe më gjerë. Nga ky këndvështrim, veprimtarinë dhe zhvillimin e UT-së mund ta ndajmë në dy periudha:

- Periudha 1994-2003 është koha historike e krijimit të Universitetit të Tetovës.

- Periudha 2004-2010 është periudha e zhvillimit institucional të këtij universiteti dhe koha e modernizimit akademik dhe fizik.

Universiteti nga gjendja e emergjencës filloi të kalojë në shkallën e reformimit akademik, konceptual dhe institucional. Fryt i këtij aktiviteti të pakursyer dhe i dimensionimit, është fizionomia e re e UT-së. Së këndejmi UT-ja është afirmuar si një institucion universitar i reformuar, si një qendër e vetme publike në gjuhën shqipe në Maqedoninë e Veriut për kualifikim, specializim dhe kërkim shkencor. UT-ja është anëtare e Konferencës së Universiteteve Europiane.

Sot UT-ja është strukturuar në 13 fakultete, 65 programe studimore, 115 drejtime studimore dhe 3 institute kërkimore-shkencore. Stafin akademik e përbëjnë 273 mësimdhënës të rregullt dhe 355 mësimdhënës të angazhuar me kohë të caktuar, respektivisht për një vit akademik, me tendencë të rritjes progresive. Në rrafshin e procesit edukativo-mësimor, rëndësi të veçantë i kushton zbatimit të reformave të Bolonjës, si dhe atyre në sferën e kërkimeve profesionale-shkencore, edhe pse ky komponent është akoma larg synimeve të UT-së në krahasim me vendet e zhvilluara. Këto kërkime realizohen nëpërmjet projekteve bilaterale në saje të projekteve për kërkime dhe zhvillim Erasmus, DAD, Tempus etj. Duke u mbështetur në standardet

103 Më gjerësisht shih në: http://al.mrt.com.mk/.

europiane, cilësia akademike dhe studimore është gjithnjë në rritje. Për sa i përket Kartës së Bolonjës, UT-ja hyn aktualisht në një fazë të re të zhvillimit të vet, në fazën e zbatimit dhe të konceptimit të modelit të Bolonjës sipas skemës 3+2+3 ose 4+1+3 (Bachelor+Master+PhD).

Duke zbatuar sistemin e ri europian të studimeve, UT-ja synon të jetë shumë shpejt pjesë integrale e universiteteve europiane, stud

entët të përfitojnë një formim profesional më cilësor, diplomat universitare të përafrohen me ato të vendeve të zhvilluara[104].

4. 7 Universiteti i Europës Juglindore

Në pranverë të vitit 2000, duke u përkrahur nga donatorë ndërkombëtarë, komisioneri i lartë i OSBE -së për pakicat nacionale, ka iniciuar diskutimet për themelimin e një universiteti të ri në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Pas miratimit të Ligjit të Arsimit të Lartë nga Kuvendi i Maqedonisë së Veriut, i cili lejoi krijimin e universiteteve nga themelues që nuk kanë të bëjnë me shtetin dhe i cili përkrahu mësimin në gjuhën shqipe, filloi planifikimi për krijimin e universitetit në fund të vitit 2000. Ndërtimi filloi në mars të vitit 2001 dhe Universiteti i Europës Juglindore (UEJL) u hap gjashtë muaj më vonë. Në nëntor të vitit 2002, numri i studentëve arriti në 2250, ndërsa në tetor të vitit 2003, numri i studentëve arriti në 3700. Që nga themelimi, në tetor të vitit 2001, ka arritur ta dëshmojë veten si universitet lider i cilësisë, financiarisht i qëndrueshëm dhe tashmë i marrë si model i arsimimit të lartë shumetnik dhe shumëgjuhësor në Europën Juglindore. Aq më tepër, UEJL-ja e ka dëshmuar veten edhe në kombinimin e qëlluar të përvojës së universiteteve amerikane dhe europiane, duke vazhduar të përfitojë nga bashkëpunimi akademik i sponsorizuar nga Komisioni i BE-së dhe USAID-i, si dhe donatorë të tjerë. Universiteti dhe studentët kanë përfituar edhe nga bursat që janë ndarë nga Holanda dhe Instituti Shoqëria e Hapur. Historia e këtij universiteti është magjepsëse për shkak të mënyrës

104 Më gjerësisht shin në ueb faqen e Universitetit të Tetovës: https://unite.edu.mk/rreth-nesh/.

se si UEJL-ja e ka arritur këtë pozicion, duke luftuar kundër pasigurisë ekonomike dhe politike në rajon. Tani UEJL-ja ndihmon institucionet e tjera dhe komunitetin në promovimin e bashkëpunimit për qëllime hulumtimi dhe lëvizjen e studentëve dhe të stafit. Universiteti është i pajisur me shumë mundësi të cilat u shërbejnë studentëve në arritjen e qëllimeve në kuadër të disiplinave që i kanë zgjedhur. Duke dashur që të gjithë të diplomuarit të përfitojnë shtyllë akademike sa më solide, po ashtu universiteti ofron përkrahje dhe këshilla praktike për sa i përket karrierës dhe ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me ndërmarrje private dhe publike, që të mund t'i inkuadrojë studentët në punë praktike të vazhdueshme dhe të mund t'i përdorin maksimalisht njohuritë dhe aftësitë e fituara në UEJL[105].

4. 8 Universiteti "Nënë Tereza" - Shkup

Universiteti "Nënë Tereza" në Shkup është themeluar nga ana e Kuvendit të RMV-së me Ligjin e Themelimit të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 226 të datës 25 dhjetor 2015). Në kuadër të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup funksionojnë pesë (5) fakultete, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe i Arkitekturës (me programet studimore: arkitekturë dhe dizajn, ndërtimtari, gjeodezi dhe gjeoinformatikë), Fakulteti i Shkencave të Informatikës (me programet studimore: informatikë dhe informatikë në gjuhën angleze), Fakulteti i Shkencave Teknike (me programet studimore: sistemet elektro-energjetike, inxhinieri makinerie dhe menaxhment, inxhinieri e komunikacionit dhe e transportit, inxhinieri ekonomike, mekatronikë), Fakulteti i Shkencave Teknologjike (me programet studimore: inxhinieri e materialeve dhe nano-teknologjive, teknologjia ushqimore) dhe Fakulteti i Shkencave Sociale (me programet studimore: politika sociale dhe puna sociale, studimet europiane). Ky universitet është një mjedis i promovimit të vlerave të mirëfillta arsimore e shkencore, si një qendër që nxjerr kuadro që do ta çojnë shoqërinë dhe kombin përpara. Universiteti funksionon

105 Më gjerësisht shih në ueb faqen e UEJL-së: https://www.seeu.edu.mk/sq/about/history.

pajtim me standardet më të larta ndërkombëtare, duke sjellë cilësi dhe studentë të përgatitur që t'i bëjnë ballë ekonomisë së tregut dhe globalizimit shoqëror[106].

4. 9 Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve - Shkup

Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve në Maqedoni (ITSHKSHM) me seli në Shkup, është institucioni i parë dhe i vetëm në Republikën e Maqedonisë së Veriut, i cili merret me ruajtjen, kultivimin dhe avancimin e trashëgimisë kulturore-historike të shqiptarëve në këtë pjesë të Ballkanit. ITSHKSHM-ja u themelua me vendim të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, më 27.3.2007, si institucion publik shkencor, dhe u përurua solemnisht më 22 nëntor të vitit 2007, me rastin e 99 vjetorit të Kongresit të Alfabetit në Manastir. Është njëri nga shtatë institutet publike shkencore në Republikën e Maqedonisë së Veriut, puna e të cilit rregullohet në bazë të Ligjit të Veprimtarisë Hulumtuese-Shkencore. Selia e parë e këtij instituti ishte te Hani i Plumbtë (Kurshumlihan) në Çarshinë e Vjetër, ndërsa tani ndodhet në objektin e ish-ambasadës amerikane në Shkup, i pajisur me orendi dhe kushte relativisht të mira të punës kërkimore-shkencore. Prej themelimit e deri tani, ITSHKSHM-ja u drejtua nga dr. Mirushe Hoxha, dr. Ramiz Abdyli, dr. Naim Halimi (u.d.), dr. Shefqet Zekolli, ndërsa drejtor aktual është dr. Skender Asani. Në këtë institut janë të angazhuar afër 30 punëtorë, kryesisht magjistra dhe doktorë të shkencave filologjike dhe historike. Në kuadër të ITSHKSH-së, funksionojnë pesë departamente:

- Departamenti i gjuhës shqipe
- Departamenti i letërsisë shqiptare
- Departamenti i historisë së shqiptarëve në Maqedoni dhe i lëvizjeve demografike
- Departamenti i etnologjisë, i historisë së artit dhe i arkitekturës popullore
- Departamenti i lidhjeve të ndërsjella kulturore, historike dhe gjuhësore mes

106 Më gjerësisht shih në ueb faqen e Universitetit "Nënë Tereza" në: https://unt.edu.mk/sq/.

shqiptarëve dhe maqedonasve me popujt e tjerë të rajonit.

Ndërsa prej vitit 2019 u shtuan edhe tri departamente të reja:

- Departamenti i marrëdhënieve shqiptaro-osmane;

- Departamenti për edukimin dhe studimin e Holokaustit;

- Departamenti i muzeologjisë.

ITSHKSH-ja ka organin e vet, revistën shkencore "Studime albanologjike", në të cilën botohen materiale nga sfera të ndryshme të gjuhësisë, letërsisë, folklorit, etnologjisë, historisë etj., që ndërlidhen me albanologjinë dhe përgjithësisht me shqiptarët e këtyre trevave. Prej vitit 2014, Ministria e Arsimit e Republikës së Maqedonisë ka akredituar studimet pasuniversitare në ITSHKSH. Programet studimore janë dyvjeçare, sipas sistemit të kredive ECTS, në drejtimet: gjuhë shqipe, letërsi shqiptare dhe histori e marrëdhënie ndërkombëtare. ITSHKSH-ja ka bashkëpunim të ngushtë me shumë institucione relevante vendore dhe ndërkombëtare, ku fokus të interesimit kanë ruajtjen e trashëgimisë shpirtërore dhe kulturore[107].

4. 10 SHM "Kiril Pejçinoviq" – Tetovë

Gjimnazi i Tetovës ka të kaluar shumë të lashtë. Filloi punën në vitin 1910, në objektin e shkollës së atëhershme të mjekësisë. Prej vitit 1912 e deri më 1929 procesi edukativo-arsimor zhvillohej në gjuhën serbokroate me disa ndërprerje, për shkak të luftërave ballkanike dhe Luftës së Parë Botërore. Nga viti 1929 e deri më 1940, në kohën e Mbretërisë Serbo-Kroato-Sllovene, procesi mësimor zhvillohej pa ndërprerë. Në atë kohë gjimnazi mbante emrin "Gjimnazi Real Shtetëror i Tetovës". Arsimimi në këtë gjimnaz atëherë ishte i mundur vetëm për një numër të kufizuar fëmijësh që vinin nga familjet e pasura të qytetit dhe të fshatrave përreth.

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, duke filluar nga 17 shkurti i vitit 1941, procesi edukativo-mësimor zhvillohej në gjuhën shqipe, kurse gjimnazi e mori emrin "Hasan

107 Më gjerësisht shih në ueb faqen e Institutit në: https://www.itsh.edu.mk/per-ne/historiku/.

Tahsini", ku si drejtor i parë i këtij institucioni u emërua z. Kel Gashi. Procesi mësimor vazhdoi të zhvillohet deri në vitin 1944, kur sërish u ndërpre. Pas luftës, gjimnazi "Kiril Pejçinoviq" filloi sërish punën më 27 shkurt të vitit 1945. Ky vendim u mor në Mbledhjen e KAÇKM-së më 3 nëntor të vitit 1944. Në vitin e parë shkollor kushtet e punës ishin mjaft të vështira, por me ndihmën e profesorëve dhe falë punës së nxënësve për një kohë të shkurtër u krijuan kushte normale për ndjekjen e procesit edukativo-arsimor. Edhe pse fondi i orëve mësimore ishte mjaft i madh, përsëri procesi mësimor zhvillohej në vazhdimësi dhe me sukses. Në vitin shkollor 1945-1946 u regjistruan gjithsej 277 nxënës në 8 paralele nga klasa I deri VIII. Procesi mësimor udhëhiqej nga gjithsej 11 mësimdhënës dhe drejtori i atëhershëm Jovan Mojsov. Gjenerata e parë e maturantëve, gjithsej 13, diplomoi në vitin 1946-1947. Për çdo vit shkollor numri i maturantëve vazhdonte të rritej, fakt ky i cili dëshmonte qartë interesimin e madh të nxënësve dhe prindërve të tyre për arsimim në gjimnazin e asaj kohe. Një numër i madh i maturantëve më tej vazhdonin arsimimin e tyre në shkollat e larta dhe në fakultete, brenda dhe jashtë vendit. Duhet theksuar faktin se 96% e mësimdhënësve që punonin në atë kolektiv kishin qenë vetë nxënës të kësaj shkolle. Pothuajse përqindja ishte identike edhe në organet dhe organizatat e tjera që ishin në përbërje të Komunës së Tetovës. Gjimnazi i Tetovës ishte dhe mbeti burim kryesor për kuadro cilësore profesionale, në veprimtaritë shoqërore, ekonomike dhe të tjera. Veprimtari kryesore e këtij institucioni është edukimi dhe arsimimi i nxënësve. Çështja e punës cilësore edukativo-arsimore, paraqet një nga shtyllat kryesore rreth së cilës mbështeten detyrat e organeve profesionale të këtij institucioni arsimor, siç janë: Këshilli i mësimdhënësve, Këshilli i aktivit profesional dhe Këshilli i paraleleve. Në gjimnazin e Tetovës ishin të përfaqësuara këto drejtime: arsimi gjimnazor (drejtimi i përgjithshëm, matematiko-natyror dhe ai gjuhësor), si dhe ai pedagogjik, matematiko-informatik, metalurgjiko-minierik dhe kimi-teknologji. Në vitin shkollor 1982-1983, u zbatua koncepti edukativ për

drejtimet në shkollat e mesme, i cili vazhdoi deri në vitin shkollor 1991-1992. Mirëpo, në vitin shkollor 1992-1993 përsëri u zbatua koncepti i arsimit gjimnazor. Që nga ky vit e këndej, sukseset e gjimnazit gradualisht u rritën dhe paralelisht me këtë, u rrit edhe interesimi i nxënësve për të ndjekur shkollimin në këtë institucion të arsimit të mesëm[108].

4. 11 SHF "Rexhep Voka" – Shipkovicë, Tetovë

Mësimi në këtë shkollë zhvillohet që nga viti 1917 deri më sot. Me aktvendimin nr. 06-11777/1, datë 20.9.1945 është themeluar si shkollë fillore. Në vitin 1962 shkollës i bashkëngjitet SHF "Liria" e fshatit Brodec. Në vitin 1970 i bashkëngjitet SHF "Besa" e fshatit Veshallë deri më 30.8.2000. Emri i shkollës është ndryshuar disa herë, prej vitit 1945 deri 1950 e ka pasur emrin "Bab Duda", prej vitit 1950 deri 1953 e ka pasur emrin "Rexhep Voka", prej vitit 1953 deri më 1993 e ka pasur emrin "Jeta e Re", ndërsa prej vitit 1993 e deri më sot e ka emrin "Rexhep Voka". Në vitin shkollor 2012-2013 numri i nxënësve ka qenë 361, numri i paraleleve ishte 24, mësimi zhvillohej në dy gjuhë dhe në dy objekte shkollore. Shkolla numëron gjithsej 44 punonjës, 35 mësimdhënës, 3 administratorë (drejtori, pedagogu, sekretari) dhe 6 personel teknikë[109].

4. 12 SHF "Përparimi" - Reçicë e Madhe, Tetovë

Themelimi i shkollës së parë fillore katërvjeçare në fshatin Reçicë e Madhe të Tetovës u bë më l.2.1921, me emrin "Velika Reçica". Shkolla në fjalë, në atë kohë kishte dy paralele, klasën e parë dhe një paralele përgatitore. Mësimi mbahej në gjuhën serbe. Në vitin 1942 me dekret të ministrit shqiptar të Arsimit, Ernest Koliqi, është emëruar z. Idriz Idrizi, si mësuesi i parë në fshatin Reçicë e Madhe. Ai në vitin shkollor 1942-43 hapi shkollën e parë fillore me emrin "Aleksandër Xhuvani". Në fillim të vitit shkollor janë regjistruar 45 nxënës, asnjë vajzë. Krahas klasës së parë u formua edhe një klasë tjetër me 40 nxënës me moshë madhore (të cilët në kohën e para luftës, kanë mësuar

108 Më gjerësisht shih në ueb faqen e Komunës së Tetovës: https://www.tetova.gov.mk/getartm.aspx?aid=129&men=3&lan=1&sub=39.
109 Po aty.

në gjuhën serbe), me qëllim që ta mësojnë alfabetin shqip. Në atë kohë është mësuar 6 ditë në javë, numri i nxënësve rritej me përmasa të mëdha, si nga gjinia femërore, ashtu edhe ajo mashkullore, ku i përmblidhte në vete nxënësit e fshatrave Reçicë e Madhe, Reçicë e Vogël, Rasadishte dhe Pallçisht i Epërm. Shkolla Fillore "Përparimi" është themeluar në vitin 1965 nga Kuvendi i Komunës së Tetovës, me vendim nr. 06-1777/1. Drejtor i parë që nga themelimi i kësaj shkolle ka qenë z. Idriz Idrizi e më pas Bajram Memeti, Refik Rexhepi, Akik Jusufi, Afet Jonuzi, Rakip Mazllami, Vebi Ademi, Isenazmi Neziri, Xhemalidin Jonuzi, Xhevair Aliji, Hatip Shabani, Besnik Alili dhe Ejup Rustemi. Sot kjo shkollë ka gjithsej 731 nxënës, 392 meshkuj dhe 338 femra, gjithsej 34 paralele, 62 të punësuar, prej të cilëve 22 meshkuj dhe 40 femra, siç janë: 1 drejtor, 1 pedagog, 1 psikolog, 1 bibliotekare, 1 sekretar, 51 arsimtarë dhe 6 punonjës teknikë. Mësimi zhvillohet në gjuhën shqipe[110].

4. 13 SHF "Tefejjuz" - Çair, Shkup

Shkolla Fillore "Tefejjuz" filloi punën që nga viti 1884, në ndërtesën e Hilmi Bej Derallës, e cila më vonë është blerë nga pushtetarët e Perandorisë Osmane dhe është emëruar si "Tefeyyüz İptidai Okulu" ("Shkolla Fillore Tefejjuz"). Ashtu si të gjitha shkollat e këtij rajoni, ashtu edhe kjo shkollë, në vitin shkollor 1919-20, hyri nën udhëheqjen e Mbretërisë së Jugosllavisë, pas së cilës vazhdoi me veprimtarinë e saj me emrin "Osman Xhikiç". Këto informata janë shënuar në librin e Muharem Parapoviçit dhe të Muharem Musiçit "Historia e shkollave të Shkupit", e përgatitur në vitin 1932-33. Mësimi në këtë shkollë zhvillohej në gjuhën shqipe dhe atë turke[111].

4. 14 SHF "Liria" - Tetovë

Për popullatën shqiptare në këto anë mësimi në gjuhën shqipe ka filluar që nga Lufta e Dytë Botërore. Pas kësaj lufte vazhdoi mësimi në gjuhën shqipe në shkollat fillore. Që nga 1 marsi i vitit 1945 në këtë vend ku ende nuk ishte ndërtuar objekti

110 Po aty.

111 Më gjerësisht shih në ueb faqen e Komunës së Çairit: https://cair.gov.mk/shfk-tefejjuz/.

i shkollës, u hap shkolla fillore me emrin "Liria", ku nxënësit mësonin në objekte të vjetra, të mbetura nga medresetë. Në këtë kohë numri i nxënësve arrinte 1.085, prej të cilëve 579 meshkuj dhe 506 femra. Në këtë vit shkollor ishin të angazhuar 6 mësues, edhe atë: Gani Jahja, Hikmet Kasapi, Ahmet Haxhi Hasani, Burhan Muhedini, Zija Sadiku dhe Hyreme Tresi. Drejtor i shkollës ka qenë Vehap Kadriu. Vlen të përmendet edhe kontributi i madh i mësuesve nga Shqipëria, që vepronin në këtë shkollë gjatë kësaj periudhe, si: Abedin Faja, Elbasan; Zija Zendeli, Dibër; Hasan Teteli, Korçë etj. Në grupin e këtyre mësuesve vepronin edhe dy mësues nga Tetova, Vehap Kadriu dhe Xhevahir Veseli. Objekti i sotëm shkollor u ndërtua në vitin 1948-1949, në të cilin filloi mësimi më 28.2.1950. Mësimi zhvillohej në 22 paralele dhe me 1.197 nxënës. Këtë proces e realizonin 23 mësues. Në vitin 1950-1952 në këtë objekt ka punuar edhe Normalja e parë Shqipe, e cila më vonë u transferua në Shkup. Në vitin shkollor 1958-1959 qeveria e atëhershme bëri disa reforma dhe urdhëroi që në këtë objekt të mësojnë edhe nxënësit maqedonas. Që atëherë e deri më sot mësimi në këtë shkollë zhvillohet në gjuhën shqipe dhe maqedonase[112].

4. 15 Shkolla e Mesme "Hajdar Dushi" – Ladorisht, Strugë

Më 2 Tetor 1991, bashkësitë lokale të fshatit dhe fshatrave përreth formalisht themeluan shkollën e mesme "Hajdar Dushi" dhe kjo ditë merret si ditë e themelimit dhe e fillimit të punës së shkollës. Në vitin shkollor 1991-92, në vitin I u regjistruan 80 nxënës nga mbarë rrethi i Strugës e më gjerë dhe më vonë u formua edhe viti II, ku u regjistruan 12 nxënës. Shpejt pas hapjes së SHM "Hajdar Dushi" në Ladorisht, pasoi hapja në të njëjtën mënyrë e dy shkollave të mesme në Kërçovë dhe Kumanovë dhe dy shkollave fillore në Ballancë të Dibrës dhe Baçisht të Kërçovës, por më e mira ishte themelimi i Universitetit të Tetovës në vitin 1994 sipas modelit të "Hajdar Dushit" në Ladorisht. Hap pas hapi SHM "Niko Nestor" në Strugë detyrohet t'i hapë dyert për

112 Më gjerësisht shih në ueb faqen e Komunës së Tetovës: https://www.tetova.gov.mk/getartm.aspx?aid=65&men=3&lan=1&sub=38.


nxënësit shqiptarë, sepse nuk kishte formë tjetër që të mbyllej SHM "Hajdar Dushi" në Ladorisht. Pas rreth 10 vitesh nga pezullimi i "Hajdar Dushit", në kompleksin e shkollës së mesme në Strugë u hap SHM Gjimnazi "Dr. Ibrahim Temo", që është thjesht riaktivizimi i "Hajdar Dushit", por me emër tjetër. Ky ishte misioni i "Hajdar Dushit", jo thjesht mjet presioni për rihapjen e paraleleve shqipe, por shkollë e mesme e mëvetësishme shqipe[113].

4. 16 Teatri Shqiptar - Shkup

Teatri i sotëm Shqiptar është themeluar më 20 janar të vitit 1950 si pjesë e atëhershme e Teatrit Popullor të Pakicave. Më 1968, ky emërtim ndryshohet në Teatrin Shqiptar-Turk, Shkup dhe mban këtë emër deri në vitin 1974, kur formohet Organizata Themelore e Punës së Bashkuar - Drama Shqipe, Organizata Themelore e Punës së Bashkuar - Drama Turke, si dhe Shërbimet e Përbashkëta pranë Teatrit të Kombësive. Emërtimi i sotëm i institucionit, Institucioni Nacional "Teatri Shqiptar" - Shkup, daton nga 25.2.2005[114]. Historiku i themelimit të Teatrit Shqiptar të Shkupit ndërlidhet me aktorët nga Gjilani, Muharrem Shahiqi dhe Zija Berisha. Ish-Komiteti Qendror i Partisë Komuniste i Maqedonisë, në atë kohë kërkoi që në Shkup të formohet një institucion kulturor, gjegjësisht një teatër profesional, ku të gjitha kombësitë, siç i kishin emëruar pakicat kombëtare të Maqedonisë, të formohet teatri i pakicave kombëtare-Teatar na mallcinstvata. Në atë kohë ekzistonte Teatri i Amatorëve në Shkup, i formuar nga Muharrem Shahiqi, Mark Marku dhe Zija Berisha, aktorë shqiptarë. Këta dy artistë meritorë kosovarë, kanë qenë të përndjekur nga UDB-ja serbe e Kosovës. Për këtë, ata vendosën të arratisen nga ky qytet dhe u vendosën në Shkup, për të punuar për kafshatën e gojës. Disa vite pas luftës, këta artistë punuan si arsimtarë në arsimin fillor, si mësimdhënës, duke bredhur prej një fshati në fshat tjetër, me të vetmin qëllim që ta jetojnë jetën e tyre në këtë kohë të rëndë. Andaj duke

113 Më gjerësisht: https://strugalajm.com/gjimnazi-hajdar-dushi-ladorisht-gezuar-29-vite/
114 Më gjerësisht shih në: https://portalb.mk/188971-teatri-shqiptar-shkup-shenon-65-vjetorin/.

mos parë perspektivën e jetës, Muharrem Shahiqi, si djalë i komandantit të ballistëve, Lamë Shahiqi, i cili luftoi dhe u vra në malet e Gjyrishecit kundër trupave partizane, e la Gjilanin dhe u vendos në Shkup. Të njëjtin fat e kishte edhe Zija Berisha, djalë i një familjeje siç e quanin asokohe "familje antirevolucionare", i cili u shpërngul nga Kosova dhe u gjend në Maqedoni, sepse edhe ai ishte i përndjekur nga regjimi i asaj kohe. Në atë kohë këtij teatri iu nda vendi në pallatin "Ilinden", i cili gjendet afër qendrës tregtare të qytetit. Teatri kishte dy hapësira në përdhes, ku me një mund të madh këta dy burra artistësh arritën të krijojnë kushte minimale për funksionimin e teatrit, duke ndërtuar skenën, grimoret, dhomat e garderobës etj. Pas formimit të Teatrit Shqiptar të Shkupit, ky teatër me plot të drejtë mund të thuhet se ishte qendër e kulturës dhe e elitës intelektuale të shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Në këtë teatër punuan edhe shumë kosovarë të tjerë, siç kuptohet: Muharrem Shahiqi (plot 28 vite ka punuar si aktor meritor në Teatrin Shqiptar të Shkupit, deri në vitin 1978, kur është kthyer në Gjilan, për ta formuar Teatrin e Qytetit të Gjilanit), Zija Berisha, Agron Berisha, Fetah Mehmeti (Gjilan), Luan Ahmeti (Gjilan), Ismajl Rama (Ferizaj), Sylejman Loka (Gjakovë), Silvana Bajqinovci, (Gjilan), Bajrush Mjaku (Kaçanik), Muharem Qena (Prishtinë) e shumë të tjerë. Në këtë Teatër punonte si regjisor i rregullt edhe Mirko Stefanovski me prejardhje shqiptare, i cili kishte thënë "babai im vdiq me kapuç të bardhë, të cilin e kishte mbajtur tërë jetën". Përndryshe, regjisori Mirko Stefanovski, ishte babai i kitaristit më të famshëm maqedonas Vllatko Stefanovski[115].



Muharem Shahiqi, aktori gjilanas.

115 Më gjerësisht shih në: "Muharrem Shahiqi e Zija Berisha-themelues të Teatrit Shqiptar në Shkup", Rajonipress, 06.01.2015, në dispozicion në internet në linkun: https://rajonipress.com/muharrem-shahiqi-e-zija-berisha-themelues-te-teatrit-shqiptar-ne-shkup/.

4. 17 Teatri i Tetovës - Tetovë

Teatri i Tetovës është një ndër teatrot më të reja në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Pas një kërkese këmbëngulëse të aktorëve të Tetovës për krijimin e një hapësire skenike, ku ata do të mund të interpretojnë, në vitin 2007 formohet Institucioni Nacional-Teatri i Tetovës, me një ekip të përbërë prej 15 aktorëve dhe 15 punonjësve administrativë dhe skenikë. Inaugurimi i këtij institucioni u bë me premierën e shfaqjes "Çmendina", më 22 tetor 2007[116].

4. 18 SHKA "Xheladin Zeqiri" - Tetovë

Aktiviteti i kësaj shoqërie daton që në vitin 1943 me emrin "Rinia Shqiptare". Shtytës të kësaj veprimtarie ishin aktivistë të çështjes kombëtare nga Shqipëria dhe Tetova, të cilët aktivitetet e tyre i zhvillonin në ndërtesën e Shoqatës së Kulturës Fizike "Partizani", në Tetovë. Në atë kohë shfaqet edhe drama e parë shqipe "Lulja e kujtimit", me regji të Qemal Haxhiosmanit nga Elbasani, ndërsa rolin kryesor të femrës e luan Vera Tetova nga Tirana. Kjo shoqëri, me lejen e Lidhjes së Shoqërive Kulturore-Artistike, në Tetovë më 13.4.1949, regjistrohet me emrin Shoqëria Kulturore-Artistike Shqiptare "Xheladin Zeqiri", sipas emrit të dëshmorit tetovar Xheladin Zeqiri, që për ideale kombëtare me brigadën VII luftoi dhe u vra në Frontin e Sremit. Në periudhën pas themelimit, kjo shoqëri shënoi hapa të rëndësishëm në zbulimin e traditës autoktone të këtij nënqielli, kultivoi me etje arritjet bashkëkohore shqiptare në lëmin e kulturës shpirtërore dhe ishte dritare e vetme e hapur nga ardhmëria dhe dritë në tunelin e pafund, që kaloi populli shqiptar e posaçërisht popullata e kësaj ane. Ajo luajti një rol të rëndësishëm në emancipimin dhe barazimin e femrës dhe të mashkullit, ndikoi pozitivisht në krijimin e idealit të ri ndaj bashkëkohësisë sonë. Shumë femra, tanimë gjyshe dhe shumë prej tyre të ndjera, që dikur ishin aktiviste të dalluara, këtë shoqëri e kanë pasur shtëpi të dytë. Grupet që me sukses me dekada

116 Më gjerësisht shih në ueb faqen e Komunës së Tetovës: https://www.tetova.gov.mk/getartm.aspx?aid=48&men=3&lan=1&sub=8.

kanë vepruar në gjirin e "Xheladin Zeqirit" janë: grupi i këngëve dhe i valleve, grupi i dramës, grupi letrar, seksioni i piktorëve, grupi i muzikës argëtuese, kori i përzier dhe ai i femrave etj. Në këto grupe kanë vepruar artistë, shkrimtarë, piktorë të njohur etj.

Nga këto seksione më vonë u themeluan: Shoqata e Shkrimtarëve të Tetovës, Kolonia e Artistëve të Pikturës dhe Teatri i Tetovës. Gjatë lëvizjeve demokratike, më 1991, me angazhimin e anëtarëve të vjetër dhe entuziastëve të rinj, kjo shoqëri u rimëkëmb përsëri me të gjitha seksionet e saj, por që aktivitetet ishte e detyruar t'i zhvillojë në një shtëpi private. Edhe pse në kushte shumë të rënda, falë entuziazmit të kryesisë dhe anëtarëve, kjo shoqëri për një kohë të shkurtër arriti një nivel të lartë dhe pasojnë paraqitje shumë të suksesshme para publikut me koncerte dhe pjesë dramatike, që përjetuan nga disa reprizime, të cilat kishin vlerësime shumë të larta pozitive nga publiku dhe ekspertët. Kjo shoqëri është fituese e festivalit të parë të këngës së vjetër qytetare shqiptare, si dhe fituese e shumë festivaleve të këngëve dhe valleve në Kosovë dhe në Maqedoni. SHKA "Xheladin Zeqiri" shpallet si shoqëria më e suksesshme në Maqedoni me 6 lëvdata të fituara në manifestimet e organizuara brenda dhe jashtë vendit[117].

4. 19 Ansambli "Ibe Palikuqi" - Shkup

Ky ansambël u themelua më 30 mars të vitit 1979, duke zhvilluar një veprimtari të pandërprerë mbi 40 vite dhe duke lënë prapa një numër të madh të aktiviteteve nëpërmjet 1200 prezantimeve, shumë nga të cilat janë kurorëzuar me çmime të ndryshme në saje të lojës, si rrjedhojë e talentit të artistëve të rinj shqiptarë, që tërë veprimtarinë e tyre e zhvilluan në baza vullnetare.[118]

4. 20 Ansambli "Emin Duraku" - Shkup

Ansambli i Këngëve dhe i Valleve "Emin Duraku" nga Shkupi, është njëri ndër

117 Më gjerësisht shih në ueb faqen e Komunës së Tetovës: https://www.tetova.gov.mk/getartm.aspx?aid=265&men=3&lan=1&sub=9.

118 Më gjerësisht shih në: Rexhep Rifati, "Ibe Palikuqi"- 40-vjet rrugëtim sfidash në afirmimin e kulturës shqiptare", (17.11.2019), në dispozicion në internet në linkun: https://prointegra.ch/ibe-palikuqi-40-vjet-rrugetim-sfidash-ne-afirmimin-e-kultures-shqiptare/.

ansamblet më të vjetra të Shkupit, i themeluar në vitin 1948. Mbi shtatë dekada përkushtim, punë, sakrificë e mund, por gjithmonë me një qëllim, ruajtjen e pasurisë kombëtare dhe mbrojtjen e kulturës shqiptare në Maqedoninë e Veriut[119].

5. Marrëveshja Kornizë e Ohrit dhe shteti multietnik

Marrëveshja Kornizë e Ohrit e 13 gushtit 2001[120], është një burim formal "sui generis" i së drejtës kushtetuese të RMV-së, sepse përmban preambulën e re kushtetuese dhe 15 amendamente kushtetuese si dhe ndryshime legjislative. Kjo Marrëveshje u arrit në Ohër[121], në bisedime të vështira nga qershori deri në gusht të vitit 2001 dhe është nënshkruar në Shkup më 13 gusht të vitit 2001, në tekstin origjinal në gjuhën angleze, si versioni i vetëm autentik i saj nga liderët e katër partive politike: VMRO-DPMNE, LSDM, PDSH dhe PPD, si dhe nga Kryetari i atëhershëm i Republikës. Në cilësinë e dëshmitarëve (garantuesve ndërkombëtarë) janë nënshkruar edhe përfaqësuesi i SHBA-ve, Xhejms Pardju dhe ai i BE-së, Fransoa Leotar. Kjo marrëveshje paraqet një burim parësor të së drejtës kushtetuese të RMV-së, sepse u krijua në një mënyrë origjinale duke përfshirë shtetin multietnik dhe demokracinë konsensuale, si përmbajtje të reja në rendin kushtetues të shtetit. Kjo marrëveshje mund të konsiderohet edhe si burim më i rëndësishëm se vetë Kushtetuta e RMV-së, sepse është miratuar me ndërmjetësimin e SHBA-së dhe të BE-së, që domethënë se krahas vullnetit të shtetit të RMV-së shprehin edhe vullnetin e tyre, për shkak se shërben si bazë për interpretimin e amendamenteve kushtetuese të vitit 2001. Kjo marrëveshje i rregullon këto çështje: parimet e përgjithshme; ndërprerjen e armiqësive; zhvillimin e pushtetit të decentralizuar;

119 Më gjerësisht shih në ueb faqen e Komunës së Çairit: https://cair.gov.mk/70-vjetori-i-ansamblit-te-kengeve-dhe-valleve-emin-duraku-nga-shkupi/.

120 Teksti në gjuhën angleze dhe shqipe i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit në dispozicion në internet në linqet: http://www.ucd.ie/ibis/filestore/Ohrid%20Framework%20Agreement.pdf. https://web.archive.org/web/20180403083229/http://www.siofa.gov.mk/data/file/Ramkoven_dogovor_al.pdf.

121 Në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare "Përtej Ohrit" (13.08.2021) të organizuar nga Ministria për sistem politik dhe marrëdhënie ndërmjet bashkësive, në kuadër të 20 vjetorit të Marrëveshjes së Ohrit, gjatë fjalimit z.Ali Ahmeti shpalosi për herë të parë që përpilimin dhe hartimin e draft-versionit të dokumentit të parë të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit e ka bërë z.Paul Williams.

mosdiskriminimin dhe përfaqësimin e drejtë dhe adekuat; procedurat e veçanta parlamentare; arsimin dhe përdorimin e gjuhëve; shprehjen e identitetit; zbatimin; Aneksin A-amendamentet kushtetuese; Aneksin B-Ndryshimet në legjislacion dhe Aneksin C-Zbatimi dhe ndërtimi i mirëbesimit[122].

Marrëveshja Kornizë e Ohrit në vitin 2001 e kaloi me sukses edhe kontestimin e saj kushtetues para Gjykatës Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj për hedhjen poshtë të nismës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, mes të tjerash, thekson se, duke u nisur nga fakti se Marrëveshja Kornizë është udhëhequr nën kujdesin e Kryetarit të atëhershëm të Republikës dhe në atë cilësi u nënshkrua nga ai, me çka kjo marrëveshje, gjithashtu, u nënshkrua edhe nga katër liderët e partive politike, si dhe nga fakti se edhe përfaqësuesit e Bashkimit Europian dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, janë nënshkruar si dëshmitarë. Marrëveshja Kornizë e Ohrit paraqet një akt politik të liderëve të partive më të mëdha politike në vend për të dalë nga kriza. Prandaj, Marrëveshja Kornizë e Ohrit, nuk është një akt juridik që mund t'i nënshtrohet një vlerësimi të Gjykatës Kushtetuese, duke pasur parasysh juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, të përcaktuar në nenin 110 të Kushtetutës[123].

Marrëveshja Kornizë e Ohrit ngjashëm si kushtetuta për rregullimin e ardhshëm shtetëror të Maqedonisë e vitit 1880, e shpreh konceptin e sovranitetit (shtetit) multietnik, nëpërmjet këtyre elementeve: njohja e komuniteteve si një kategori kushtetuese etnike; përfaqësimi i drejtë dhe adekuat i personave që u përkasin të gjitha komuniteteve në organet publike në të gjitha nivelet dhe lëmenjtë e jetës publike; përbërja e Komitetit të Marrëdhënieve ndërmjet Komuniteteve, si dhe dy llojet e shumicave të nevojshme për ndryshimin e Kushtetutës së RMV-së dhe

122 Më gjerësisht shih në: Shkariq Svetomir, E drejta kushtetuese, Botimi i tetë, Kultura, Shkup, 2015, f. 99-100; Jeton Shasivari, E Drejta Kushtetuese (Botimi i dytë), Furkan-ISM, Shkup, 2020, f. 56; Instituti i Shoqërisë së Hapur, Perspektiva mbi Marrëveshjen Kornizë, Shkup, 2001, f. 14-23.

123 Më gjerësisht shih në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së, U.br. 190/2001 (31.10.2001), në dispozicion në internet në linkun: http://ustavensud.mk/?p=7976.

për miratimin e ligjeve me interes të veçantë për komunitetet[124].

Vlerësimi i një marrëveshjeje paqeje, siç është Marrëveshja Kornizë e Ohrit, gjithmonë është një detyrë e vështirë, sepse marrëveshjet e tilla nuk kanë të bëjnë thjesht me përfundimin e konfliktit, por duhet të japin edhe udhëzime në ristrukturimin e shtetit, për t'i akomoduar kërkesat themelore të palëve[125]. Marrëveshja Kornizë e Ohrit përbën një qasje të re, për të futur në kornizë kapacitetin demokratik të shtetit, për zgjidhjen e kërkesave themelore të palëve, me çka ndryshe nga shumica e marrëveshjeve të paqes, ajo nuk u nënshkrua nga palët në konflikt, por nga partitë parlamentare dhe përmbajtja e saj kryesore u zbatua nëpërmjet reformës kushtetuese dhe ligjore. Duhet theksuar se, këto reforma edhe pse ishin thelbësore, megjithatë në shumë aspekte nuk përbënin një transformim të madh të sistemit kushtetues dhe politik, sepse ishin relativisht të kufizuara si rezultat i vetë intensitetit të ulët të vetë konfliktit, si dhe përfshirjes së hershme ndërkombëtare. Nga parimet kryesore të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit argumentohet fryma kryesore e saj, e cila e mbështet dhe e ruan diversitetin etnik që duhet të ndodhë nëpërmjet politikave të ndryshme qendrore dhe lokale, mirëpo kjo gjë nuk siguron fundin e ndryshimeve kushtetuese, sepse kushtetuta duhet të vazhdojë të evoluojë dhe t'i akomodojë kërkesat dhe nevojat e ndryshme, meqë kjo marrëveshje gjithnjë kërkon një qasje inkluzive dhe evolutive të zhvillimit kushtetues[126].


124 Më gjerësisht shih në: Shkariq Svetomir, E drejta kushtetuese, Botimi i tetë, Kultura, Shkup, 2015, f. 379.

125 Më gjerësisht shih në: Caroline Hartzell, Matthew Hoddie, "Institutionalizing Peace: Power Sharing and PostCivil War Conflict Management" American Journal of Political Science, Vol. 47, 2 (April 2003), p. 312-332.

126 Më gjerësisht shih në: Florian Bieber, "Assessing the Ohrid Framework Agreement", në: One Decade after the Ohrid Framework Agreement: Lessons (to be) Learned from the Macedonian Experience, Friedrich Ebert Stiftung and Center for Research and Policy Making Skopje, 2011, p. 14-16, në dispozicion në internet në linkun: http://www.crpm.org.mk/wp-content/uploads/2017/12/OneDecade.pdf.

6. Të drejtat gjuhësore dhe kulturore të shqiptarëve nëpërmjet prizmit të amendamenteve kushtetuese të vitit 2001

Nga 15 amendamentet kushtetuese të miratura nga Kuvendi i RM-së më 16 nëntor të vitit 2001, për qëllimet e këtij studimi do të përqëndrohemi në amendamentet kushtetuese IV, V dhe VIII.



СЛУЖБЕН ВЕСНИК
НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

"Службен весник на Република Македонија" излегува по потреба. Рок за рекламации 15 дена. | Вторник, 20 ноември 2001 Скопје Број 91 Год. LVII | Претплатата за 2001 година изнесува 8.000 денари. Овој број чини 120 денари. Жиро сметка 30000000188798

1575.

Врз основа на член 131 став 4 од Уставот на Република Македонија, Собранието на Република Македонија, на седницата одржана на 16 ноември 2001 година, донесе

ОДЛУКА
ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА АМАНДМАНИТЕ IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII и XVIII НА УСТАВОТ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Се прогласуваат амандманите IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII и XVIII на Уставот на Република Македонија,

што ги усвои Собранието на Република Македонија, на седницата одржана на 16 ноември 2001 година.

СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

Бр. 07-3795/1
16 ноември 2001 година
Скопје

Претседател
на Собранието на Република Македонија,
Стојан Андов, с.р.

мир и соживот, социјална правда, економска благосостојба и напредок на личниот и заедничкиот живот, преку своите претставници во Собранието на Република Македонија, избрани на слободни и демократски избори, го донесуваат овој

2. Со точката 1 на овој амандман се заменува Преамбулата од Уставот на Република Македонија.

АМАНДМАН V

1. На целата територија во Република Македонија и во нејзините меѓународни односи службен јазик е македонскиот јазик и неговото кирилско писмо.

Друг јазик што го зборуваат најмалку 20% од граѓаните, исто така, е службен јазик и неговото писмо, како што е определено со овој член.

Личните документи на граѓаните кои зборуваат службен јазик различен од македонскиот јазик, се издаваат на македонски јазик и неговото писмо, како и на тој јазик и неговото писмо во согласност со закон.

Кој било граѓанин кој живее во единиците на локалната самоуправа во кои најмалку 20% од граѓаните зборуваат службен јазик различен од македонскиот јазик, во комуникациите со државните органи

Amendamentet kushtetuese të vitit 2001

Me amendamentin IV, me të cilin u zëvendësua preambula e Kushtetutës së vitit 1991, përcaktohet: "Qytetarët e Republikës së Maqedonisë, populli maqedonas, si dhe qytetarët që jetojnë brenda kufijve të saj, të cilët janë pjesë e popullit shqiptar, popullit turk, popullit serb, popullit vllah, popullit rom, popullit boshnjak dhe të tjerëve, duke marrë përsipër përgjegjësinë për të tanishmen dhe të ardhmen e atdheut të tyre, të vetëdijshëm dhe mirënjohës ndaj paraardhësve të tyre, për viktimat dhe përkushtimin ndaj përpjekjeve të tyre dhe luftës për krijimin e shtetit të pavarur dhe sovran të Maqedonisë dhe përgjegjës para brezave të ardhshëm për ruajtjen dhe zhvillimin e tërë asaj që është e vlefshme nga trashëgimia e pasur kulturore dhe bashkëjetesa në Maqedoni, të barabartë në të drejtat dhe detyrimet e tyre ndaj së mirës së përbashkët - Republikës së Maqedonisë - në pajtim me traditat e Republikës së Krushevës dhe vendimet e KAÇKM-së dhe të Referendumit të 8 shtatorit të

vitit 1991, vendosën ta konstituojnë Republikën e Maqedonisë si shtet të pavarur, sovran, me qëllim që të vendoset dhe forcohet sundimi i së drejtës, që të garantohen të drejtat e njeriut dhe liritë civile, të sigurohet paqja dhe bashkëjetesa, drejtësia sociale, mirëqenia ekonomike dhe përparimi i jetës individuale dhe të përbashkët, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në Kuvendin e Repulikës së Maqedonisë, të zgjedhur në zgjedhje të lira e demokratike, e miratojnë këtë"[127].

Në të drejtën kushtetuese krahasimore ka përkufizime të ndryshme të preambulës. Sipas Hans Kelsenit, preambula paraqet pjesën tradicionale, hyrjen solemne, e cila i shpreh idetë politike, morale dhe religjioze, të cilat kushtetuta synon t'i realizojë. Kjo hyrje zakonisht nuk parasheh kurrfarë normash të caktuara për sjelljen e njeriut, sepse ajo së pari ka karakter ideologjik e pastaj edhe juridik. Kjo hyrje shërben që kushtetutës t'ia rrisë autoritetin dhe t'ia shtojë efikasitetin. Thirrja në Zot dhe deklarata se do t'i mbrojë të drejtat, liritë, barazitë dhe mirëqeniet, janë hyrje tipike. Dilema nëse kushtetuta ka karakter demokratik apo autokratik, kjo paraqitet në hyrje si vullnet i popullit ose si vullnet i sundimtarit, i cili është emëruar sipas vullnetit hyjnor.

Sipas Kurtesh Saliut, preambula zakonisht është e shkurtër, e thukët dhe shpreh bazën ideore, qëllimet për të cilat është miratuar kushtetuta dhe paraqet një tërësi të vazhdueshme duke shërbyer si burim i së drejtës kushtetuese, sidomos në rastet kur ajo tërthorazi shpreh qëndrimin e kushtetutës ndaj ndonjë çështjeje e cila nuk është rregulluar në pjesën normative.

Sipas Ratko Markoviqit, preambula paraqet një tekst që u paraprin normave, e cila nuk është e stilizuar në formë të neneve dhe tek e cila diksioni është më i lirë, solemn dhe oratorik. Më shpesh është e formuluar në formë të një fjalie të gjatë me disa paragrafë, por ka edhe shembuj të formulimit të një fjalie të vazhdueshme apo

127 Vendimi për shpalljen e amendamenteve IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII dhe XVIII për Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, "Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 91/01, viti LVII (20.11.2001) në dispozicion në internet në linkun: https://www.slvesnik.com.mk/Issues/4565B8A8CCA245AC99E52A0EE60B3FCD.pdf.

traktateve të tëra ideologjike. Në Kushtetutën e Republikës së Serbisë të vitit 2006 në preambulën e saj thuhet: Krahina Autonome e Kosovës dhe e Metohisë, është pjesë përbërëse e territorit të Serbisë, ku e gëzon pozitën e autonomisë substanciale, prej nga rrjedh detyrimi i të gjitha organeve shtetërore, që t'i përfaqësojnë dhe t'i mbrojnë interesat shtetërore në Kosovë dhe Metohi, në të gjitha raportet e jashtme dhe të brendshme politike. Në kohën e miratimit të kësaj kushtetute ishte duke ardhur zgjidhja përfundimtare e pozitës së Kosovës dhe Metohisë në Kombet e Bashkuara, prandaj Serbia me kushtetutë e përjashtoi vendimin eventual në favor të pavarësisë së Kosovës dhe Metohisë. Mirëpo, kur jemi këtu, si shembull konkret të shpërputhjes midis normatives dhe reales, si dhe preambulës si pengesë të dialogut dhe të zgjidhjes politike midis Beogradit dhe Prishtinës, duhet theksuar hulumtimin e opinionit publik në Serbi, sipas të cilit, mbi 90% e qytetarëve të saj (duke përfshirë këtu edhe elitën shoqërore, intelektuale dhe politike serbe) nuk e dinë se cila është rëndësia e kësaj preambule të Kushtetutës së Serbisë, ku Kosova përkufizohet si pjesë përbërëse e saj, me çka mbi 80% e qytetarëve të Serbisë konsiderojnë se kjo preambulë nuk ka asnjë ndikim ndaj pozitës së sotme dhe statusit të ardhshëm të Kosovës, prandaj edhe duhet të hiqet nga Kushtetuta e Serbisë. Opinione të ngjashme paraqiten edhe në pyetjen nëse duhet të përmendet Kosova edhe në tekstin e ardhshëm të kushtetutës dhe në cilën formë, ku gjysma e të anketuarve konsiderojnë se Kosova nuk duhet të përmendet fare në tekstin e saj.

Sipas Sokolit dhe Smerdelit, preambula paraqet hyrjen parimore të pjesës normative të kushtetutës, prandaj edhe stili i saj është solemn, shpesh edhe patetik, ndërsa mënyra e shprehjes së përmbajtjes së saj është përshkruese, pra deklaruese.

Në këtë aspekt, vlen të theksohen edhe disa qëndrime në literaturën kushtetuese juridike amerikane mbi preambulën, si për shembull: "Preambula paraqet sqarim të thukët dhe prekës të qëllimeve të kushtetutëvënësit"; "Në preambulë bazohet retorika më energjike dhe më e theksuar e kushtetutës"; ose

mbi rëndësinë e preambulës në SHBA flet edhe e dhëna mbi njërin nga etërit e Kushtetutës së SHBA-së, Xhejms Medison, i cili në Konventën Kushtetutëvënëse të Filadelfies ka propozuar që në tekstin e preambulës të përfshihet edhe "e drejta e pakontestueshme, e patjetërsueshme dhe e pandryshueshme e popullit amerikan për reforma dhe ndryshim të qeverisë"[128].

Në këtë aspekt, duke u nisur nga fakti se në preambulë theksohen qëllimet e përgjithshme dhe synimet e kushtetutës, ajo realizon tri funksione themelore: funksionin edukativ, i cili nënkupton qëllimin e kushtetutëvënësit për t'i bindur qytetarët që t'i nënshtrohen së drejtës së shkruar, prandaj edhe gjuha me të cilën shkruhet preambula është një gjuhë e rëndomtë dhe e kapshme për qytetarët, kështu që atë mund ta kuptojnë edhe njerëzit që nuk janë juristë me profesion; funksionin integrues, që nënkupton se preambula paraqet pjesën e kushtetutës e cila ka potencial për t'i bashkuar ose për t'i ndarë qytetarët; dhe funksionin sqarues, që nënkupton se preambula mëton t'i theksojë në mënyrë precize shkaqet e miratimit të kushtetutës.

Mirëpo, një nga çështjet që nuk është sqaruar sa duhet në teorinë kushtetuese juridike ndërlidhet me pyetjen nëse preambulat kanë fuqi detyruese juridike? Lidhur me këtë çështje, në teorinë kushtetuese juridike, ekzistojnë tri qëndrime:

- Preambula e kushtetutës nuk ka natyrë juridike dhe nuk obligon në pikëpamje juridike;

- Preambulat e të gjitha kushtetutave nuk janë të njëjta, prandaj varësisht nga përmbajtja e tyre, disa kanë natyrë juridike dhe juridikisht obligojnë, ndërsa të tjerat - jo; dhe

- Preambula e kushtetutës e ka të njëjtën natyrë juridike sikurse edhe pjesët e tjera të kushtetutës; me çka duhet theksuar se numri më i madh i autorëve anojnë

128 Më gjerësisht mbi përkufizimet e ndryshme të preambulës në të drejtën kushtetuese krahasimore shih në: Jeton Shasivari, "Preambula si pjesë e strukturës së kushtetutës: Deklaratë simbolike apo energji jetësore e kuptimit të kushtetutës", në: KAMBOVSKI LIBER AMICORUM- Studim për nder të shtatëdhjetë viteve të jetës së Akademik Vllado Kambovski, Akademia Maqedonase e Shkencave dhe Arteve & Fakulteti Juridik "Justiniani i Parë" USHKM, Shkup, 2019, fq. 341-356.

nga qëndrimi i parë;

Lidhur me natyrën juridike të preambulës, edhe pse, siç u mor vesh, në të drejtën kushtetuese të krahasuar mbizotërojnë qëndrimet se preambula nuk ka përmbajtje juridike të detyrueshme, sepse zakonisht i paraprin titullit të kushtetutës dhe nuk është pjesë e saj, nuk paraqet rregull që cakton sjelljen e njeriut, nuk ka nene, nuk ka sanksione, nuk është normë juridike, prapëseprapë kohën e fundit, gjithnjë e më tepër po përhapet prirja rritëse e detyrimit juridik të preambulës, sipas së cilës, akteve juridike u njihet karakteri integrues mbi bazën e veçorive formale: miratuesi (subjekti që i miraton) dhe procedura e miratimit, përkatësisht dy tekste kanë natyrë të njëjtë (juridike ose jojuridike) nëse janë miratuar nga subjekti i njëjtë dhe në procedurë të njëjtë, pa marrë parasysh përmbajtjen e tyre, aq më tepër kur gjykata e bazon vendimin e saj në preambulën e kushtetutës, siç është rasti, për shembull, me SHBA-në, ku në vitin 1808, Gjykata Supreme e saj, mbi njëqind vendime i ka bazuar në preambulën e Kushtetutës së SHBA-së, ose gjykatat supreme të Australisë dhe të Kanadasë, të cilave preambulat u kanë shërbyer si bazë për interpretimet juridike, ose Këshilli Kushtetues i Francës, që në vitet 1971 dhe 2008, me vendim formal ka përcaktuar se preambula e Kushtetutës së Francës ka fuqi kushtetuese, ose vendimi i Gjykatës Kushtetuese të RM-së të vitit 2007, që shfuqizoi disa dispozita të Ligjit të Përdorimit të Simboleve të Komuniteteve të vitit 2005, e që në një pjesë të tij bazohej edhe në preambulën e Kushtetutës së RM-së. Këtu duhet shtuar edhe shembullin e vendimit të Gjykatës Supreme të Indisë të vitit 1973, ku përcaktohet se ligji ose amendamenti kushtetues, i cili bie ndesh me strukturën themelore të kushtetutës, që është dhënë në preambulën e saj, mund të shpallet si kundërkushtetues; ose edhe vendimi i Gjykatës Supreme të Kanadasë i vitit 1997, që preambulën e cilëson si "një korridor të madh hyrës në kështjellën e kushtetutës" duke e marrë qartazi si bazë të interpretimit kushtetues.

Në favor të kësaj, po ashtu duhet theksuar edhe shembujt, ku vetë kushtetuta

e zgjidh çështjen e raportit midis preambulës dhe kushtetutës, si për shembull: kushtetutat e Sirisë, Senegalit, Tanzanisë, Çadit, Turqisë, Kroacisë, Hungarisë, Burkina Fasos, Kamerunit, Nepalit, Indonezisë etj., me çka preambula shprehimisht konfirmohet si pjesë përbërëse e kushtetutës, ose parashihet detyrimi i qytetarëve në përmbushjen e synimeve të preambulës, ose ajo parashihet si një mjet ndihmës juridik për interpretimin kushtetues në situata konfuze.

Në këtë aspekt, vlen të theksohet se gjykatat në SHBA në shumë raste i kanë bazuar vendimet e tyre duke u mbështetur në preambulën e Kushtetutës së SHBA-së, si p.sh.: termi i preambulës kushtetuese amerikane: "Ne, populli i..." është përdorur për t'i përcaktuar kufijtë e zbatimit të kushtetutës amerikane; për të arsyetuar se populli, e jo shtetet, janë burimi i pushtetit federativ, si dhe për ta përkufizuar shtetësinë amerikane; ose Gjykata Kushtetuese e Gjermanisë, duke vlerësuar kushtetutshmërinë e ratifikimit të Traktatit të Lisbonës, referohet në preambulën e Kushtetutës së Gjermanisë dhe vlerëson se ratifikimi i traktatit në fjalë nuk e cenon sovranitetin e Gjermanisë, sepse integrimet europiane janë kërkesë e vetë preambulës kushtetuese gjermane; ose Gjykata Kushtetuese e Bosnjës e Hercegovinës, e cila në vitin 2000, me kërkesë të kryetarit Alija Izetbegoviq, me rastin e vlerësimit të kushtetutshmërisë së preambulës së Kushtetutës së Republikës Sërpska, përkatësisht të nocioneve "shteti i popullit serb", "vetëvendosja e popullit serb", "pavarësia e shtetit", ka konstatuar se këto shprehje janë në kundërshtim me preambulën e Kushtetutës së Bosnjës e Hercegovinës, sepse Republika Sërpska është pjesë e saj dhe nuk i përket vetëm popullit serb, duke hedhur poshtë arsyetimin e Republikës Sërpska se preambula paraqet vetëm një pjesë deklarative të kushtetutës dhe nuk ka karakter juridik (normativ). Po ashtu, këtu vlen të theksohet edhe përvoja nga Bashkimi Europian që ndërlidhet me miratimin e Traktatit të Lisbonës të vitit 2009 pas refuzimit të ratifikimit të Traktatit Kushtetues për Europën të vitit 2004, me çka nëse krahasohen këta dy dokumente, vijmë në përfundim se dallimi kryesor

ka të bëjë me preambulën, përkatësisht dallimet janë të natyrës formale, sepse Traktati i Lisbonës mënjanoi pjesën më të madhe të terminologjisë kushtetuese, si dhe simbolet e tekstit paraprak kushtetues, përkatësisht mënjanoi simbolet dhe nocionet që shpienin drejt shtetit, si për shembull, emërtimin, kushtetutën, simbolet e BE-së (flamuri, himni dhe motoja europiane), si dhe mënjanimi i togfjalëshit ligje europiane. Kështu, ndryshimet e tilla mundësuan që Traktati i Lisbonës të miratohet në procedurat përkatëse parlamentare dhe nacionale të shteteve anëtare dhe të bëhet kornizë e re juridike për BE-në[129].

Kur jemi te preambula kushtetuese e vitit 2001, por edhe te preambula kushtetuese aktuale e vitit 2019[130] të Kushtetutës së RMV-së, duhet theksuar se ajo e riktheu popullin maqedonas në tekstin e saj, ndryshe nga Marrëveshja Kornizë e Ohrit, e cila bazohet në konceptin e demosit, që nënkupton tërësinë e qytetarëve, të cilët juridikisht i përkasin RMV-së, si një e mirë e përbashkët, ky rikthim u bë me një ekuilibër me "pjesët e popujve", me çka, ndonëse u ruajt koncepti i sovranitetit multietnik, prapëseprapë problemi kryesor vazhdon të mbetet funksioni inkluziv (gjithëpërfshirës) i preambulës kushtetuese, pra, kapaciteti dhe sfida e saj për t'i bashkuar qytetarët, sado që i vendos ata si element konstituiv të shtetit, prapëseprapë popullin maqedonas e përkufizon si etnos (komb), kurse shqiptarët dhe të tjerët, si pjesë të popujve. Prandaj, preambula aktuale kushtetuese duhet t'i nënshtrohet një procesi të rishikimit serioz kritik, sidomos në aspektin e sendërtimit të funksionit inkluziv të saj si një nga funksionet kryesore të preambulave kushtetuese, për arsye se kjo preambulë e mbithekson karakterin etnik të shtetit, duke u nisur nga fakti se komuniteti etnik maqedonas në veçanti shquhet si etnos (komb), gjë që e

129 Më gjerësisht lidhur me funksionet e preambulës dhe fuqisë së saj juridike shih në: Jeton Shasivari, "Preambula si pjesë e strukturës së kushtetutës: Deklaratë simbolike apo energji jetësore e kuptimit të kushtetutës", në: KAMBOVSKI LIBER AMICORUM- Studim për nder të shtatëdhjetë viteve të jetës së Akademik Vllado Kambovski, Akademia Maqedonase e Shkencave dhe Arteve & Fakulteti Juridik Justiniani I USHKM, Shkup, 2019, fq. 341-356.

130 Amendamenti XXXIV me të cilin u bënë ndryshime në Amendamentin IV, "Gazeta Zyrtare e RMV-së", nr. 6/19, (12.01.2019) në dispozicion në internet në linkun:
https://www.slvesnik.com.mk/Issues/46e75d0202104cb8ba5b2786583518bb.pdf.

forcon bindjen se pjesëtarët e komuniteteve të tjera etnike janë qytetarë të rendit të dytë, gjë që praktikisht domethënë se maqedonasit etnikë si etnos (komb), janë më të barabartë se shqiptarët dhe të tjerët si pjesë e popullit dhe kanë të drejta dhe autorizime më të veçanta se shqiptarët dhe të tjerët ndaj RMV-së, si një e mirë e përbashkët e të gjithë qytetarëve të saj[131].

Nga ana tjetër, me amendamentin V me të cilin u zëvendësua neni 7 i Kushtetutës së vitit 1991 përcaktohet: *"Në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik. Gjuhë tjetër, të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve, gjithashtu është gjuhë zyrtare bashkë me alfabetin e saj, siç është përcaktuar me këtë nen. Dokumentet personale të qytetarëve të cilët flasin gjuhë tjetër zyrtare nga gjuha maqedonase, lëshohen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj, si dhe në atë gjuhë dhe në alfabetin e saj, në pajtim me ligjin. Çdo qytetar që jeton në njësitë e vetëqeverisjes lokale, ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare tjetër nga gjuha maqedonase, në komunikim me njësitë rajonale të ministrive, mund ta përdorë cilëndo nga gjuhët zyrtare dhe alfabetet e tyre. Njësitë rajonale kompetente për ato njësi të vetëqeverisjes lokale përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin të cilin e përdor qytetari. Çdo qytetar, në komunikim me ministritë, mund ta përdorë një nga gjuhët zyrtare dhe alfabetin e saj, ndërsa ministritë përgjigjen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin të cilin e përdor qytetari. Në organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë së Veriut, gjuhë tjetër zyrtare përveç asaj maqedonase, mund të përdoret në pajtim me ligjin. Në njësitë e vetëqeverisjes lokale, gjuha dhe alfabeti që e përdorin së paku 20% e qytetarëve, është gjuhë zyrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeteve të cilat i flasin më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes*

131 Më gjerësisht shiko Shtojcën nr. 1

lokale, vendosin organet e njësive të vetëqeverisjes lokale"[132].

Amendamenti VI vendosi me saktësi një themel të ri të vlerave në rendin kushtetues të Republikës së Maqedonisë. Futja e këtij ndryshimi ka çuar në një gjendje përfaqësimi të barabartë dhe adekuat të qytetarëve nga të gjitha komunitetet, për t'u përfshirë në organet shtetërore dhe në institucionet publike në të gjitha nivelet[133].

Ndërkaq, me amendamentin VIII, me të cilin u zëvendësua neni 48 i Kushtetutës së vitit 1991 përcaktohet: *"Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë lirisht ta shprehin, ta ruajnë dhe ta zhvillojnë identitetin e tyre dhe veçoritë e komuniteteve të tyre, si dhe t'i përdorin simbolet e komunitetit të tyre. Republika ua garanton të gjitha komuniteteve mbrojtjen e identitetit etnik, kulturor, gjuhësor dhe fetar. Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë të themelojnë institucione kulturore, artistike, arsimore, si dhe shoqata shkencore dhe shoqata të tjera me qëllim të shprehjes, të ruajtjes dhe të zhvillimit të identitetit të tyre. Pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë mësimi në gjuhën e tyre, në arsimin fillor dhe atë të mesëm, në mënyrën e përcaktuar me ligj"*[134]. *Në shkollat, ku arsimimi zhvillohet në gjuhë tjetër, mësohet edhe gjuha maqedonase"*[135].

Këto 15 amendamente kushtetuese të vitit 2001 e kaluan me sukses edhe kontestimin e tyre kushtetues në Gjykatën Kushtetuese qysh në fazën e të qenët si projektamendamente kushtetuese. Gjykata Kushtetuese në vendimin e saj për hedhjen poshtë të nismës për vlerësimin e kushtetutshmërisë së këtyre 15 amendamenteve kushtetuese, mes të tjerash, thekson se Gjykata Kushtetuese vendos për pajtueshmërinë e ligjeve me kushtetutën; vendos për pajtueshmërinë e dispozitave të tjera dhe të kontratave kolektive me kushtetutën dhe me ligjet; i mbron liritë dhe të drejtat e njeriut dhe të qytetarit, që kanë të bëjnë me lirinë e bindjes,

132 Vendimi për shpalljen e amendamenteve IV, V, VI, VII, VIII, IX, X, XI, XII, XIII, XIV, XV, XVI, XVII dhe XVIII për Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, "Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 91/01, viti LVII (20.11.2001) në dispozicion në internet në linkun: https://www.slvesnik.com.mk/Issues/4565B8A8CCA245AC99E52A0EE60B3FCD.pdf.

133 Më gjerësisht shiko shtojcën nr. 2

134 Më gjerësisht shiko shtojcën nr. 3

135 Po aty.

ndërgjegjes, mendimit dhe të shprehjes publike të mendimeve, me bashkimin dhe me veprimin politik, si dhe me ndalimin e diskriminimit në baza gjinore, racore, fetare, kombëtare, sociale dhe politike; vendos për konfliktin lidhur me kompetencën midis bartësve të pushtetit ligjvënës, ekzekutiv dhe gjyqësor; vendos për konfliktin lidhur me kompetencën midis organeve të Republikës dhe njësive të vetëqeverisjes lokale; vendos për përgjegjësinë e kryetarit të Republikës; vendos për kushtetutshmërinë e programeve dhe statuteve të partive politike dhe të shoqatave civile, si dhe vendos për çështje të tjera të përcaktuara me kushtetutë. Nga kjo rrjedh, se miratimi dhe ndryshimi i kushtetutës, është në kompetencë ekskluzive të kuvendit, kështu që përmbajtja e materies kushtetuese varet nga vullneti i kushtetutëvënësit. Gjykata Kushtetuese nuk ka kompetencë dhe nuk mund ta vlerësojë kushtetutën si akt më të lartë juridik dhe si shprehje e vullnetit politik të subjekteve brenda shtetit. Pra, kushtetuta për Gjykatën Kushtetuese paraqet aktin në raport me të cilin kjo gjykatë e vlerëson kushtetutshmërinë e të gjitha akteve më të ulëta. Prandaj, vlerësimi i kushtetutshmërisë së tekstit të projektamendamenteve kushtetuese nuk është në kompetencë të Gjykatës Kushtetuese[136].


136 Më gjerësisht shih në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së, U.br. 188/2001 (24.10.2001), në dispozicion në internet në linkun: http://ustavensud.mk/?p=7964.

KREU I TRETË

STATUSI I GJUHËS SHQIPE DE JURE DHE KONTESTIMET KUSHTETUESE TË TIJ

1. Korniza ligjore dhe institucionale e Ligjit të Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale të vitit 2008 dhe 2011, me referencë të veçantë për vetëqeverisjen lokale

Ligji i Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale i vitit 2008 dhe 2011[137] , rregullon përdorimin e gjuhës në disa fusha: në Kuvend (neni 3), komunikimi i qytetarëve me ministritë (neni 4), proceset gjyqësore (nenet 5-14), në organet gjyqësore (nenet 15-17), procedura e përgjithshme administrative (neni 18), ekzekutimi i sanksioneve (neni 19), në institucionin e Avokatit të Popullit (neni 20), në procesin zgjedhor dhe në format e votimit të drejtpërdrejtë (nenet 21-28), dokumentet personale (nenet 29-30), librat e amzës (neni 31), autoritetet policore (neni 32), veprimtaria radiodifuzive (nenet 33-38), objektet e infrastrukturës (nenet 40-43), aktivitetet financiare dhe ekonomike (nenet 44-47), arsimi dhe shkenca (nenet 48-53), kultura (nenet 54-56), në procesin e qasjes së lirë në informacionin publik (neni 57) dhe në shpalljen e akteve (neni 58).



СОБРАНИЕ НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

1919.

Врз основа на член 75 ставови 1, 2 и 3 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

У К А З

ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА УПОТРЕБА НА ЈАЗИК ШТО ГО ЗБОРУВААТ НАЈМАЛКУ 20% ОД ГРАЃАНИТЕ ВО РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА И ВО ЕДИНИЦИТЕ НА ЛОКАЛНАТА САМОУПРАВА

Се прогласува Законот за употреба на јазик што го зборуваат најмалку 20% од граѓаните во Република Македонија и во единиците на локалната самоуправа, што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 4 август 2008 година.


Бр. 07-3430/1
4 август 2008 година
Скопје

Претседател
на Република Македонија,
Бранко Црвенковски, с.р.

Претседател
на Собранието на Република
Македонија,
Трајко Вељаноски, с.р.

Dekreti i shpalljes së Ligjit të Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale të vitit 2008.

137 Ligji i Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", Nr. 101/2008, e disponueshme online në: https://www.slvesnik.com.mk/Issues/DE07B4F6DDFBE948A0DFE2CFF240F02C.pdf. Ligji për ndryshimin e këtij ligji, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", Nr. 100/2011, në dispozicion në internet në: https://www.slvesnik.com.mk/Issues/47D56301AAB3324281A085DAAC0AEF98.pdf



LIGJ
PËR PËRDORIMIN E GJUHËS QË E FLASIN SË PAKU 20% E QYTETARËVE NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË DHE NË NJËSITË E VETADMINISTRIMIT LOKAL

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Me këtë ligj rregullohet përdorimi i gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në njësitë e vetadministrimit lokal.

Neni 2

Në organet e pushtetit shtetëror në Republikën e Maqedonisë mund të përdoret edhe gjuha zyrtare e ndryshme nga gjuha maqedonase në pajtim me këtë ligj.

Gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë përdoret në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë; komunikimin e qytetarëve me ministritë; procedurat gjyqësore; procedurën administrative; zbatimin e sanksioneve; Avokatin e Popullit; procesin zgjedhor; gjatë deklarimit të drejtpërdrejtë të qytetarëve; gjatë leshimit të dokumenteve personale të qytetarëve; gjatë mbajtjes të evidencës së amzës; zbatimit të autorizimeve policore; në veprimtarine radiodifuzive; objektet e infrastrukturës; vetadministrimin lokal; financat; ekonomi; arsim dhe shkence; ne kulture, dhe në sfera dhe institucione të tjera në pajtim me këtë ligj.

alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën zyrtare dhe alfabetin që e përdor qytetari që jeton në njësitë e vetadministrimit lokal në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase.

IV. PËRDORIMI I GJUHËS NË PROCEDURAT GJYQËSORE

1. Procedura penale dhe për kundërvajtje

Neni 5

Në procedurën penale gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

Në procedurën penale gjuhë tjetër zyrtare që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabeti i saj, përdoret në pajtim me këtë ligj.

Neni 6

I akuzuari, i dëmtuari, paditësi privat, deshmitarët dhe personat e tjerë që marrin pjesë në procedurën penale, e që flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, gjatë ndërmarrjes së veprimeve parahetimore, hetimore dhe ndërmarrjes së veprimeve tjera gjyqësore dhe në seancën gjyqësore kryesore, si dhe në procedurën ndaj ankesës ka të drejtë ta përdore gjuhën dhe alfabetin e saj. Gjykata do të siguroje përkthim gojor të asaj që personi, respektivisht të tjerët e paraqesin, si dhe të dokumenteve dhe materialit tjetër të shkruar deshmues. Gjykata do të sigurojë që me shkrim të përkthehet materiali i shkruar që është me rëndësi për procedurën ose për mbrojtjen e të akuzuarit.

Ligji i Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të RM-së dhe në Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale i vitit 2008.

Me fillimin e procesit të decentralizimit në RMV, pas miratimit të ndryshimeve kushtetuese të vitit 2001, filloi përfundimi normativ[138] *"për një nga reformat më thelbësore të vetëqeverisjes lokale, e cila atëherë u vlerësua nga bashkësia ndërkombëtare dhe Bashkimi Europian si historia jonë e suksesit"*[139]. Që në fillim, njësitë e vetëqeverisjes lokale e njohën zbatimin e këtij ligji si nevojë e veçantë që mund të ndikojë shumë në përmirësimin e cilësisë së jetës në to. Deri në vitin 2013, Republika e Maqedonisë ishte e organizuar në mënyrë territoriale dhe administrative në 84 njësi të vetëqeverisjes lokale, nga të cilat 33 ishin urbane, me qendër në qytet dhe 51 rurale, me bazë në fshat, si dhe qytetin e Shkupit, si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale me dhjetë komuna në territorin e saj. Sipas ndryshimeve në Ligjin e Organizimit Territorial të Vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Maqedonisë[140], aktualisht janë 80 komuna (njësi të vetëqeverisjes lokale) dhe Qyteti

138 Pas miratimit të ndryshimeve kushtetuese në 2001, filloi faza e miratimit të një sërë ligjesh të dala nga reformat kushtetuese. Në vitin 2002, u miratua Ligji i Vetëqeverisjen Lokale, në 2004 Ligji i Organizimit Territorial të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 55/2004), Ligji i Qytetit të Shkupit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë", nr. 55/2004.), Ligji i Financimit të Njësive të Vetëqeverisjes Lokale, ("Gazeta Zyrtare e RM-së", nr. 61/04, 96/04,67/07,156/09,47/11 dhe 192/15.).

139 Shihni më shumë në: Hayrettin V., "Decentralizimi në Republikën e Maqedonisë: midis normës dhe realitetit", op.cit. vepër, f. 44.

140 Teksti i zbardhur i Ligjit të Organizimit Territorial të Vetëqeverisjes Lokale në Republikën e Maqedonisë, "Gazeta

i Shkupit, ndërsa komunat Zajaz, Osllome, Drugovë dhe Vraneshticë janë pjesë e komunës së Kërçovës. Sipas të dhënave të regjistrimit të fundit të vitit 2002, mund të konstatohet numri i qytetarëve në gjithë territorin e ndarë në 8 rajone.



Rajonet dhe komunat në Republikën e Maqedonisë - fotografija është marrë nga uebfaqja e Entit Shtetëror të Statistikës.

Maqedonas	Shqiptarë	Turq	Romë	Vlleh	Serbë	Boshnjakë	Të tjerë
1297981	509083	77959	53879	9695	35939	17018	20993

Sipas Regjistrimit të Entit Shtetëror të Statistikës (2002), rajoni jugperëndimor përbëhet nga 9 komuna[141], ku përveç gjuhës maqedonase edhe gjuha shqipe është zyrtare. Sipas shifrave të publikuara të regjistrimit, ky rajon ka një popullsi prej 206.555, nga të cilët 71.479 janë shqiptarë.

Zyrtare Gazeta e Republikës së Maqedonisë" nr. 55/2004, 12/2005 dhe 10/2014.

141 Vevçan, Dibër, Debërc, Kërçovë, Makedonski Brod, Ohër, Pllasnicë, Strugë, Qendra e Zhupës.

Rajoni jugperëndimor	
Popullsia e përgjithshme	206.555
Shqiptarë	71.479

Rajoni i Pollogut përbëhet nga 10 komuna[142] me një popullsi të përgjithshme prej 304.125, prej të cilëve 222.679 janë shqiptarë, ku gjuhë zyrtare është edhe shqipja dhe alfabeti i saj.

Rajoni i Pollogut	
Popullsia e përgjithshme	304.125
Shqiptarë	222.679

Në rajonin e Pellagonisë, i cili përbëhet nga 9 komuna[143], nga popullsia e përgjithshme prej 238.136, 11.689 janë shqiptarë dhe gjuha shqipe është në përdorim zyrtar me kërkesë të palëve.

Rajoni i Pellagonisë	
Popullsia e përgjithshme	238.136
Shqiptarë	11.689

Në rajonin e Vardarit[144], vetëm në komunën e Çashkës, përveç gjuhës maqedonase, përdoret edhe shqipja si gjuhë zyrtare. Sipas regjistrimit, popullsia është 154.535, nga të cilët 5.217 janë shqiptarë.

142 Komuna e Jegunovcës, e Tearcës, e Tetovës, e Bogovinës, e Zhelinës, e Bërvenicës, e Vrapçishtit, e Gostivarit, e Mavrovës dhe e Rostushës.

143 Dollneni, Krusheva, Krivogashtani, Demir Hisari, Prilepi, Mogilla, Novaci, Resnja, Manastiri.

144 Rajoni i Vardarit i përfshin komunat: Shën Nikollë, Llozovë, Veles, Çashkë, Gradsko, Rosoman, Negotinë, Demir Kapi, Kavadar.

Rajoni i Vardarit	
Popullsia e përgjithshme	154.535
Shqiptarë	5.217

Në rajonin e Shkupit, nga 17 komunat[145], në 11[146] prej tyre, shqipja përdoret si gjuhë zyrtare.

Rajoni i Shkupit	
Popullsia e përgjithshme	578.144
Shqiptarë	133.893

Në rajonin verilindor, nga 6 komuna[147], ku popullsia, sipas regjistrimit, është 172.787, 53.651 janë shqiptarë dhe në 2 prej tyre[148], shqipja përdoret si gjuhë zyrtare, krahas maqedonishtes.

Rajoni i verilindor	
Popullsia e përgjithshme	172.787
Shqiptarë	53.651

Pra, si përfundim i përgjithshëm mund të veçojmë faktin se, në gjithsej 5 rajone, ku në 26 komuna dhe në Qytetin e Shkupit, si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale, gjuha shqipe është në përdorim zyrtar.

145 Qyteti i Shkupit, Haraçina, Buteli, Zelenikova, Petroveci, Saraji, Sopishta, Studeniçani, Çairi, Çuçer Sandeva, Shuto Orizarja, Gjorçe Petrovi, Gazi Baba, Ilindeni, Karposhi, Kisella Voda, Komuna e Qendrës, Aerodromi dhe Qyteti i Shkupit.

146 Qyteti i Shkupit, Haraçina, Buteli, Zelenikova, Petroveci, Saraji, Sopishta, Studeniçani, Çairi, Çuçer Sandeva, Shuto Orizarja.

147 Kumanova, Likova, Nagoriçani i Moçëm, Rankovca, Kratova, Kriva-Pallanka.

148 Kumanova dhe Likova.

Tabela e mëposhtme jep një panoramë të qartë të statusit të gjuhës shqipe nga viti 1991 deri në vitin 2019 në nivel lokal. Nga 26 komuna dhe Qyteti i Shkupit, si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale, 17 komuna iu përgjigjën pyetësorit për përdorimin e gjuhës dhe alfabetit të përdorur nga të paktën 20% e banorëve të komunës në periudhën 2002- 2019. Kjo tregon se në të ardhmen e afërt ka nevojë për të kryer një hulumtim të ri empirik mbi situatën me përdorimin e gjuhës dhe alfabetit shqip si gjuhë zyrtare në njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe në Qytetin e Shkupit si njësia e veçantë e vetëqeverisjes lokale.

	Njësia e vetëqeverisjes lokale	Data e Vendimit të Këshillit për përdorimin e gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të RMV-së (shqip), ose sipas Statutit të komunës	A është vepruar në pajtim me nenet 41, 55 dhe 60 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/02)	Përfaqësimi i barabartë në punësim në administratën komunale dhe në shërbimet publike, të vendosura nga komuna.	Në pajtim me nenin 62 dhe nenin 63 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 5/02), rregulloret, aktet (gjedhet) e vendimeve të miratuara nga kryetari i komunës në gjuhën maqedonase dhe në gjuhën e përdorur nga së paku 20% e banorëve të saj
1	Qyteti i Shkupit	Senaca e gjashtë e Këshillit të Qytetit të Shkupit, mbajtur më 22.9.2005	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	- Statuti i Qytetit të Shkupit (teksti i zbardhur) i vitit 2018; - Plani i efikasitetit të energjetikës në Qytetin e Shkupit i vitit 2021; - Programi për shfrytëzimin e transportit publik të qytetit për vitin 2020

					- Vendimi për pranimin e donacionit i vitit 2021; - Ekzemplar nga aktvendimet e tatimit në pronë të vitit 2021; - Ekzemplar të aktvendimit të trashëgimisë të vitit 2021; - Ekzemplar të aktvendimit të taksës komunale të vitit 2021.
2	Komuna e Çairit	Gjuha shqipe gjuhë zyrtare në Komunën e Çairit, e rregulluar me Statutin e Këshillit të Komunës së Çairit, që nga formimi në vitin 2014	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Aktvendimi për publikimin e një përfundimi për miratimin e një raporti të zbatimit të buxhetit të vitit 2021; -Përfundim i vitit 2021; -Vendim për vendosjen e bashkëpunimit ndërkomunal të vitit 2021
3	Komuna e Shuto Orizarës	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Respektohet përfaqësimi në përqindje sipas rregullativave ligjore ekzisituese, kurse më në detaje do të përcaktohen pas përpunimit të Statutit të ri të komunës dhe pas marrjes së rezultateve zyrtare të regjistrimit në vijim	Nuk janë përgjigjur

4	Komuna e Sarajit	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	- Raporti vjetor i vitit 2018; - Vendimi i vitit 2019; - Aktvendimi i vitit 2019
5	Komuna e Butelit	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	- Aktvendimi i publikimit të Vendimit për përcaktimin e çmimeve të shërbimeve – viti 2006 - Vendimi i ndryshimit dhe i plotësimit të Buxhetit – viti 2006
6	Komuna e Kumanovës	Gjuha që flitet nga së paku 20% e qytetarëve të RMV -së (Gjuha shqipe) përdoret në pajtim me dispozitat ligjore pozitive - Në Statutin e Komunës së Kumanovës nr. 07-1503/3, datë 30 qershor 2003 (“Fletore Zyrtare e Komunës së Kumanovës” nr.13/2003) dhe Vendimin statutar për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Komunës së Kumanovës nr. 07-4334/3, datë 27 prill 2007 (“Fletore Zyrtare e Komunës së Kumanovës” nr.13/2007), në nenin 134 paragrafi 2, thotë se në komunë, gjuhë zyrtare përveç gjuhës	Komuna e Kumanovës, si dhe ndërmarrjet publike të krijuara prej saj, gjithmonë respektojnë përfaqësimin e barabartë të bashkësive më të vogla etnike, ku gjatë procedurave të punësimit ato merren parasysh, duke respektuar vazhdimisht rregulloret ligjore.	Po	Aktvendimi për përfundimin e mandatit 2019; -Aktvendim për zgjedhjen e drejtorit 2020; -Aktvendim për konstatimin e përfundimit të mandatit të ushtruesit të detyrës së drejtorit 2020; -Dorëzimi i Aktvendimeve 2021:

		maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, është gjuha shqipe dhe alfabeti i saj, si gjuhë dhe alfabet i përdorur nga së paku 20% e banorëve të Komunës (hyri në fuqi në ditën e tetë nga dita shpalljes së tyre)			
7	Komuna e Sopishtës	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur
8	Komuna e Krushevës	Në statutin e komunës nr. 07 - 643/9, datë 1.6.2006 thuhet se në Komunë gjuha zyrtare përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik është edhe gjuha shqipe. Me Vendimin e këshillit, edhe gjuha vllahe dhe alfabeti i saj janë në përdorim zyrtar.	Të gjitha aktet janë në gjuhën maqedonase.	41 punonjës 30 maqedonas 4 shqiptarë 5 vlleh	Nga viti 2009 deri më 2013, personi i punësuar për përkthim nuk ka përkthyer asnjë dokument. Të gjitha rregulloret komunale janë në gjuhën maqedonase
9	Komuna e Jegunovcës	Gjuha e folur nga së paku 20% e qytetarëve të RMV-së (shqip) përdoret në pajtim me rregulloret ligjore pozitive Gjuhët zyrtare - maqedonishtja dhe shqipja me vendim nga 01-644 / 3, datë 30.10.2003 Në statutin e komunës nr. 07– 2548, datë 27.08.2013 thuhet se në komunë gjuha zyrtare	Të gjitha aktet janë përkthyer në shqip që të vitit1997	18 punonjës në administratën komunale, 15 maqedonas, 3 shqiptarë	Komuna e Jegunovcës që në fillim përdor gjuhën që flasin 20% e qytetarëve të RMV-së (gjuha shqipe).

10	Komuna e Kërçovës	përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik është gjuha dhe alfabeti i përdorur nga të paktën 20% e banorëve të Komunës	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur
11	Komuna e Çashkës	Në statutin e komunës nr. 07-738/3, datë 28.4.2006, është theksuar se në komunë gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, është gjuha dhe alfabeti që përdorin së paku 20% e banorëve të komunës	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur
12	Komuna e Studeniçanit	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur
13	Komuna e Likovës	Asnjë vendim i veçantë nuk është marrë, por ligji po zbatohet	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Aktvendimi 2019; Statuti i vitit 2006
14	Komuna e Haraçinës	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Statuti i Komunës së Haraçinës më 3.9.2019
15	Komuna e Strugës	Nuk ka asnjë vendim nga këshilli, por përdorimi i gjuhës shqipe rregullohet me statutin e komunës të vitit 2002	Të gjitha rregulloret e miratuara nga Komuna e Strugës miratohen në gjuhën maqedonase dhe atë shqipe	Punësimet në administratën komunale dhe në shërbimet publike realizohen plotësisht në bazë të përllogaritësit "Balancer".	Të gjitha aktet të vitit 2002 e në vazhdim janë në gjuhën maqedonase dhe atë shqipe
16	Komuna e Tearcës	Në statutin e komunës nga 1997 që në përdorim zyrtar janë gjuha maqedonase	Po	Me Aktvendim -Shqiptarë-34 -Maqedonas-2 -Turq-1	Kërkesë 1997; -Aktvendim 1997; - Raporti 1997; Statuti 2007

		dhe alfabeti i saj cirilik, gjuha shqipe dhe alfabeti i saj, i përcaktuar me regjistrimin e fundit të popullsisë. Statuti i komunës i vitit 2007 thotë se në komunë, gjuha zyrtare, përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, është gjuha dhe alfabeti i përdorur nga së paku 20% e banorëve të Komunës.	Deri te kontratata në vepër -Shqiptarë-22 -Maqedonas-0 -Turq-0 -Romë-1	
17	Komuna e Tetovës	Gjuha shqipe po zbatohet që në vitin 1992 - qartë e parë nga inspektimi i dokumentacionit	Të gjitha rregulloret e miratuara nga Komuna e Tetovës miratohen në gjuhën maqedonase dhe atë shqipe	Vendimi për zgjedhjen e Kryetarit të Komunës së Tetovës -Aktvendim publikimi Programi i Menaxhimit të Tokës Ndërtimore 2002; -Aktvendim për publikimin e Vendimit për miratimin e llogarisë përfundimtare të buxhetit të vitit 2003; -Aktvendim për publikimin e Vendimit për përcaktimin e institucioneve komunale-të qytetit 2004; -Përfundime 2005; -Raporti 2006; Përfundime 2007

18	Komuna e Bogovinës *Komuna e Kamjanit në vitin 2004 iu aneksua Komunës së Bogovinës.	Nuk ka asnjë vendim të këshillit, por përdorimi i gjuhës shqipe rregullohet me statut të datës 13.4.2007	Po	Nuk është theksuar	Vendim i vitit 2003 (Komuna e Kamjanit) -Zgjidhje nga 2005 -Statuti i Komunës së Bogovinës nga 2007; - Plani operativ për mirëmbajtjen e rrjetit rrugor lokal dhe rrugëve në vendbanimet në territorin e komunës së Bogovinës; -Aktvendim për shpalljen e Vendimit për ndryshimin, plotësimin-zgjerimin e Buxhetit të Komunës së Bogovinës për vitin 2021
19	Komuna e Zhelinës	Përdorimi i gjuhës shqipe në Komunën e Zhelinës është zbatuar në pajtim me ligjet në fuqi. Nuk ka pasur vendim të posaçëm nga ana e këshillit.	Të gjitha aktet përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, janë përkthyer edhe në shqipe.	Nuk janë përgjigjur	-Vendim për zbatimin e buxhetit të vitit 2009; - Urdhër të vitit2010; - Aktvendimi për përdorimin e pushimit vjetor nga 2011-ta
20	Komuna e Bërvenicës	Nuk ka asnjë vendim sepse është zbatuar në pajtim me ligjet. Statuti i komunës nr.01-84 / 1, datë 30.1.2006 thotë se në komunë, përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, gjuha zyrtare është gjuha dhe alfabeti	Për periudhën 2002-2019 përfaqësim i barabartë në administratën komunale	-Maqedonas -Shqiptarë 2002- 75% 25% 2003- 75% 25% 2004- 75% 25% 2005 60% 40% 2006- 58,33% 41,67% 2007- 46,67% 53,33%	Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për inicimin e iniciativës për miratimin e Statutit të Komunës së Brvenicës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 5/2002); - Programi vjetor

	i përdorur nga së paku 20% e banorëve të komunës.	53,33% 2008- 41,18% 58,82% 2009- 37,50% 62,50% 2010- 35% 65% 2011- 35% 65% 2012- 35% 65% 2013- 29,17% 70,83% 2014- 25% 75% 2015- 26,92% 73,08% 2016- 26,92% 73.08% 2017- 28% 72% 2018- 25% 75% 2019- 26,09% 73,91% Për shërbimet publike të themeluara nga komuna nuk kemi të dhëna prej vitit 2002.	i mirëmbajtjes së rrjetit rrugor për vitin 2003; -Aktvendim për shpalljen e konkluzionit lidhur me Raportin nga Komisioni për Financa dhe Buxhet-2004; -Statuti i komunës 2006; -Propozimvendim për ndryshimin e Vendimit për organizimin, fushëveprimin dhe mënyrën e kryerjes së detyrave të administratës komunale-2007; Programi i punës i Këshillit Bashkiak për vitin 2009; -Vendim për pastërtinë publike -2009; Programi i propozuar i punës i këshillit bashkiak për vitin 2010; -Projekt-Vendim për përfshirjen për një objekt ilegal në dokumentacionin urbanistik-2011; -Plani operativ 2013-2014; -Aktvendim për lidhjen e marrëveshjes për shoqërimin e sistemit të menaxhimit të mbeturinave -2015; -Aktvendim për përfshirjen e një objekti ilegal në

					dokumentacionin planifikues-2016; -Programi për përgatitjen e planeve urbanistike-2017, -Aktvendim për shpalljen e Vendimit-2018; -Aktvendim për themelimin e ndërmarrjes së përbashkët publike -2019
21	Komuna e Vrapçishtit	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur
22	Komuna e Gostivarit	Statuti i komunës nga 25.1.2006 thotë se informimi i qytetarëve bëhet në gjuhët zyrtare të përdorura në komunë. Këshilli i Komunës me vendim të veçantë mund të përcaktojë që informacione të caktuara të informohen në gjuhën që nuk është gjuhë zyrtare në komunë, dhe flitet nga disa nga banorët e komunës.	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur
23	Komuna e Dollnenit	Statuti i komunës nga 20.11.2005 thotë se gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik janë në përdorim në komunë, si dhe gjuha dhe alfabeti i komuniteteve që janë mbi 20% të popullsisë në Komunën e	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur

		Dollnenit (“Gazeta Zyrtare” 08/05)			
24	Komuna e Dibrës	Gjuhët zyrtare-gjuha maqedonase dhe ajo shqipe zbatohen nga 3.10.2003 me Vendimin nr. 077-168 / 3	Të gjitha rregulloret e miratuara nga Komuna e Strugës miratohen në gjuhën maqedonase dhe atë shqipe	Administrata deri në vitin 2021 -shqiptarë 11.94%; -maqedonas 76,12%; -turq 8,96%; -romë 2,99%; NSHP “Standard” - Dibër, përqindje deri në vitin 2021 -maqedonas -0; -shqiptarë 74,60%; -turq 0%; -romë 25,39% CSNO “28 Nëntori” - Dibër, përqindja deri në vitin 2021: -maqedonas 6 %; -shqiptarë80%; -turq 12%; -romë 1%; -të tjerë 1% Shkolla fillore “Penestia” - Dibër, përqindje e përfaqësimit të barabartë deri në vitin 2021: -maqedonas 4.95%; -shqiptarë 74.30%; -turq 9,91% -romë 9,91% -të tjerë 0,82%	-Nisma 2008; -Njoftimi 2009;
25	Komuna e Çuçer-Sandevës	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Aktvendim për thirrjen e seancës së 50-të të Këshillit të Komunës së Çuçer - Sandevës
26	Komuna e Zelenikovës	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur

27	Komuna e Petrovecit	Statuti i komunës, datë 14.4.2006 thotë se informimi i qytetarëve bëhet në gjuhët zyrtare të përdorura në komunë. Këshilli i Komunës me një vendim të veçantë mund të përcaktojë që informacione të caktuara të informohen në gjuhën që nuk është gjuhë zyrtare në Komunë, dhe flitet nga disa prej banorëve të komunës.	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur	Nuk janë përgjigjur

Në pajtim me tabelën e lartëpërmendur, përdorimi i gjuhës zyrtare në komunat që e përdorin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, është vërtetuar në pajtim me:

- Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut të vitit 1991;

- Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale ("Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 52/95)

- Marrëveshjen Kornizë të Ohrit – viti 2001;


- Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale (" Gazeta Zyrtare e RM-së" nr. 5/02);

- Ligjin e Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale të vitit 2008;

- Ligjin për ndryshimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në njësitë e vetëqeversisjes lokale të vitit 2011;

- Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019;

Në Komunën e Tetovës, sipas të dhënave të marra në të, gjuha shqipe është përdorur si gjuhë zyrtare që nga viti 1992.



Службен гласник на општина Тетово, бр.2-49/92 год., страница 1

Врз основа на член 236 од Статутот на Општината Тетово ("Службен гласник на општина Тетово", поредел број 1/90 год.), Собранието на општина Тетово на седницата одржана на ден 3.III.1992 година, донесе

Р Е Ш Е Н И Е
за избор на претседател на Собранието
на општина Тетово

1. Се избира м-р Шаќир Алити за претседател на Собранието на општина Тетово.

2. Изборот се смета од 3.III.1992 год.

3. Ова решение влегува во сила со денот на донесувањето, а ќе се објави во "Службен гласник на Општина Тетово".

С О В Р А Н И Е Н А О П Ш Т И Н А Т Е Т О В О

Бр.08-549/2
3.III.1992 година
Тетово

СОВРАНИЕ НА ОПШТИНА ТЕТОВО
ПРЕТСЕДАТЕЛ,
м-р Шаќир Алити

Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës,nr.5/92,faqe 1.

Në bazë të nenit 236 të Statutit të Komunës së Tetovës ("Fletorja zyrtare e Komunës së Tetovës",numri i jashtëzakonshëm 1/90),Kuvendi i Komunës së Tetovës në mbledhjen e bërë më 3.III.1992,mori

A K T V E N D I M

për zgjedhjen e kryetarit të Kuvendit
të Komunës së Tetovës

1. Zgjidhet M-r Shaqir Aliti kryetar i Kuvendit të Komunës së Tetovës.

2. Zgjedhja llogaritet prej 3.III.1992.


3.Ky aktvendim hyn në fuqi ditën e marrjen dhe do të shpallet në "Fletoren zyrtare të Komunës së Tetovë

K U V E N D I I K O M U N Ë S S Ë T E T O V

Nr.08-549/2
3.III.1992
T e t o v ë

Kryetar
i Kuvendit të Komunës së Tetovë
M-r Shaqir Aliti, d.v.

Në Komunën e Jegunovcës, me vendim të këshillit të vitit 1997, përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj, në përdorim zyrtar është edhe gjuha shqipe dhe alfabeti i saj.




Republika e Maqedonisë
KOMUNA E JEGUNOVCIT

1996

RREGULLORJA
E KËSHILLIT TË
KOMUNËS SË JEGUNOVCIT

(Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit nr. 5-6 / 1997)

Në Komunën e Tearcës, në vitin 1997 me statutin e saj, përveç gjuhës maqedonase, gjithashtu në përdorim zyrtar është edhe gjuha shqipe.



Врз основа на член 43 став 1 точка 2 од Законот за локална самоуправа ("Сл.весник на РМ"бр. 52/95 и 60/95), донесувам

РЕШЕНИЕ

За прогласување Статут на Општина Тевриче .

Се прогласува Статутот на Општина Тевриче бр. 08-47/1 што ја донесе Советот на Општина Тевриче на петата седница одржана на ден 02.06.1997 год..

Статутот на Општина Тевриче да се објави во " Службен гласник на Општина Тевриче"

бр.09-50/1
12.06.1997
Тевриче.

Градоначалник
на Општина Тевриче
Локман Елези, с.р.

Në bazë të nenit 43 paragrafi 1 pika 2 të Ligjit për vetadministratën lokale ("Gazeta zyrtare e RM" nr52/95 dhe 60/95), mar

AKTVENDIM

Për shpalljen e Statutit të Komunës së Tearcëas

Shpallet Statuti i Komunës së Tearcës nr.08-47/1 që e miratoi Këshilli i Komunës së Tearcës në seancën e pest të mbajtur më 02.06.1997 .

Statuti i Komunës së Tearcës të shpallet në "Fletoren zyrtare të Komunës sëTearcës "

nr.09-50/1
12.06.1997.
Tearcë

Kryetari
i Komunë së Tearcës
Llokman Elezi ,d.v.

Në Komunën e Strugës, në statutin e vjetër të saj thuhet se, përveç gjuhës maqedonase, edhe gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve është zyrtare, ndërsa në statutin e ri të vitit 2018 theksohet qartë se, përveç gjuhës maqedonase, si gjuhë zyrtare është edhe gjuha shqipe.

Në Komunën e Dibrës, gjuha shqipe është përdorur si gjuhë zyrtare që në vitin 2003.

Në Komunën e Kumanovës, me statutin e saj të vitit 2003 dhe vendimin statutor për ndryshimet në Statutin e Komunës së Kumanovës të vitit 2007, neni 134, paragrafi (2), përcaktohet se, përveç gjuhës maqedonase, gjuhë zyrtare është edhe shqipja.

Në Komunën e Dollnenit, në statutin e saj përcaktohet se, përveç gjuhës maqedonase, si gjuhë zyrtare përdoret edhe gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve.

Në Komunën e Krushevës, Komunën e Gostivarit, Komunën e Çashkës, Komunën e Likovës dhe Komunën e Bërvenicës, me statutet e tyre të vitit 2006,

përveç gjuhës maqedonase, si gjuhë zyrtare është paraparë edhe gjuha shqipe.

Në Komunën e Bogovinës, gjuha shqipe përdoret si gjuhë zyrtare nga viti 2007, e përcaktuar me statutin e kësaj komune.

Gjuhët në përdorim zyrtar të komuniteteve nën 20%

	Njësia e vetëqeverisjes lokale	Gjuhët në përdorim zyrtar të komuniteteve nën 20%	Vendimi i këshillit, hyrja në fuqi e vendimit dhe zbatimi i tij
1	Vrapçishti	Turqishtja	28.12.2006/5.1.2007
2	Dollneni	Turqishtja dhe boshnjakishtja	25.11.2005/3.12.2005
3	Gostivari	Turqishtja	15.7.2009/23.7.2009 1.1.2010
4	Krusheva	Vllahishtja	30.5.2006/30.5.2006
5	Kumanova	Serbishtja dhe romishtja	4.5.2010 / 6.5.2010
6	Nagoriçani i moçëm	Serbishtja	17.5.2010/25.5.2010
7	Studeniçani	Turqishtja	29.4.2013/29.4.2013
8	Çairi	Turqishtja	10.10.2013/17.10.2013

Përbërja etnike e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe gjuhët në përdorim zyrtar të komuniteteve joshumicë[149]

	Njësia e vetëqeverisjes lokale	Gjuhët në përdorim zyrtar	Përbërja e qytetarëve
1	Qyteti i Shkupit	Shqipja	shq: 20,49% maq: 66,75%,
2	Haraçina	Shqipja	shq: 93,81%, maq: 5,14%
3	Bogovina	Shqipja	shq: 95,23%, maq: 4,08%
4	Bërvenica	Shqipja	shq: 61,62%, maq: 37,52%

149 Të dhënat merren dhe përdoren nga Instituti për Demokraci, SOCIETAS CIVILIS-Shkup (IDSCS) botuar në prill 2014.

5	Buteli	Shqipja	shq: 25,19% maq: 62,25%,
6	Vrapçishti	Shqipja dhe turqishtja*	shq: 83,08%, maq: 4,10%, tur:12,34%
7	Gostivari	Shqipja dhe turqishtja*	shq: 66,68%, maq: 19,59%, tur: 9,86%
8	Dibra	Shqipja	shq: 58,07%, maq: 20,01%, tur: 13,73%
9	Dollneni	Shqipja, turqishtja dhe boshnjakishtja	maq: 35,90%, shq: 26,65%, tur: 19,14%, bosh: 17,54%
10	Zhelina	Shqipja	shq: 99,20%
11	Zelenikova	Shqipja	maq: 61,86%, shq: 29,58%,
12	Jegunovci	Shqipja	maq: 55,26%, shq: 43,02%,
13	Kërçova	Shqipja	shq: 54,51%, maq: 35,74%, tur: 5,82%
14	Krusheva	Shqipja dhe vllahishtja*	maq:62,79%, shq:21,31%, vlle:10,53%
15	Kumanova	Shqipja, serbishtja* dhe romishtja*	maq:60,43%, shq:25,87%, ser: 8,59%, rom:4,03%
16	Likova	Shqipja	shq: 97,42%, ser: 1,37%
17	Mavrova dhe Rostusha	Turqishtja	maq: 50,46%, tur: 31,10%, shq: 17,47%
18	Petroveci	Shqipja	maq: 51,44%, shq: 22,86%, bosh: 17,47%
19	Pllasnica	Turqishtja	tur: 97,82%

20	Saraji	Shqipja	shq: 91,53%, maq: 3,89%, bosh: 3,16%
21	Sopishta	Shqipja	maq: 60,18%, shq: 34,34%%, tur: 4,30%
22	Nagoriçani i moçëm	Serbishtja*	maq: 80,70%, ser: 19,13%
23	Struga	Shqipja	shq: 56,85%, maq: 32,09%, tur: 5,72%
24	Studeniçani	Shqipja dhe turqishtja	shq: 68,83%, tur: 19,05%, bosh: 9,64%
25	Tearca	Shqipja	shq: 84,39%, maq: 12,20%, tur: 2,30%
26	Tetova	Shqipja	shq: 70,32%, maq:23,16%
27	Qendra e Zhupës	Turqishtja	tur: 80,17%, maq: 12,49%, shq: 6,96%
28	Çairi	Shqipja dhe turqishtja*	shq: 57%, maq:24,13%, tur: 6,95%, rom: 4,76%, bosh: 4,55%
29	Çashka	Shqipja	maq: 57,28%, shq: 35,23%, tur: 5,10%
30	Çuçer Sandeva	Serbishtja dhe shqipja	maq: 47,32%, ser: 28,56%, shq: 22, 88%
31	Shuto Orizarja	Romishtja dhe shqipja	rom: 60,60%, shq: 30,32%, maq: 6,53

Nga ana tjetër, nga komunikimi i mëparshëm në nivel qendror dhe lokal, zbatimi i të drejtave gjuhësore mori një rëndësi të veçantë me miratimin e Ligjit të ri të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019, i cili i detyroi institucionet në zbatimin e tij, si dhe në ndërgjegjësimin e publikut në zbatimin e këtij ligji.

Agjencia e Zbatimit të Gjuhës e RMV-së gjatë vitit 2019, u dërgoi pyetësor anketues gjithsej 641 institucioneve të sektorit publik, me një sërë pyetjesh të strukturuara, me çka kanë kthyer përgjigje gjithsej 183 institucione.

Nga përgjigjet e marra për pyetjen e parë:

A i keni përmbushur detyrimet në pajtim me nenin 7 të këtij ligji dhe nëse nuk i keni përmbushur plotësisht, deri në cilën fazë keni arritur me ndryshimin e tabelave të institucionit, memorandumet, vulat, logot dhe faqet e internetit? 147 institucione janë përgjigjur se i kanë ndryshuar tabelat, 36 jo; 119 institucione janë përgjigjur se i kanë ndryshuar memorandumet, 64 jo; 151 institucione janë përgjigjur se i kanë ndryshuar vulat, 32 jo; 110 institucione janë përgjigjur se i kanë ndryshuar logot, 73 jo; 113 institucione janë përgjigjur se i kanë ndryshuar faqet e internetit dhe 70 jo.

Përgjigjet e marra nga pyetja e dytë: *Nëse nuk keni filluar me zbatim, a keni nevojë për ndihmë profesionale nga agjencia?* 27 institucione janë përgjigjur se kanë nevojë për ndihmën e AZGJ-së, 63 institucione janë përgjigjur se nuk kanë nevojë për ndihmën e AZGJ-së, 54 institucione nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje, 26 institucione u përgjigjën se do të kërkojnë ndihmë nga AZGJ-ja sipas nevojës dhe 13 institucione u përgjigjën se nuk mund t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Përgjigjet e marra nga pyetja e tretë: *Në aktin tuaj për sistematizimin e vendeve të punës, a keni paraparë sektor ose njësi të përkthimit dhe të lekturës në shqip dhe nga gjuha shqipe?* 30 institucione janë përgjigjur se kanë paraparë sektor dhe njësi të përkthimit dhe të lekturës në shqip dhe nga gjuha shqipe, 135 institucione u përgjigjën se nuk kanë paraparë sektor dhe njësi të përkthimit dhe të lekturës në shqip dhe nga gjuha shqipe dhe 18 institucione u përgjigjën se nuk mund t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Përgjigjet e marra nga pyetja e katërt: *Nëse nuk e keni paraparë, a do ta bëni atë në ndryshimin e ardhshëm të aktit për sistematizimin e vendeve të punës?* 76 institucione janë përgjigjur se do ta parashohin ndryshimin e aktit të sistematizimit

të vendeve të punës, 31 institucione janë përgjigjur se nuk do ta parashohin ndryshimin e aktit për sistematizimin e vendeve të punës, 8 institucione nuk i janë përgjigjur kësaj pyetjeje, 20 institucione janë përgjigjur se do ta parashohin ndryshimin e aktit të sistematizimit të vendeve të punës, nëse është e nevojshme, 23 institucione janë përgjigjur se tashmë kanë paraparë ndryshim të aktit të sistematizimit të vendeve të punës dhe 25 institucione janë përgjigjur se nuk mund t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Përgjigjet e marra nga pyetja e pestë: *Sa përkthyes dhe sa lektorë keni të punësuar në institucionin tuaj?* 124 institucione janë përgjigjur se nuk kanë të punësuar asnjë përkthyes dhe lektor, 23 institucione janë përgjigjur se kanë të punësuar një përkthyes dhe lektor, 11 institucione janë përgjigjur se kanë të punësuar dy përkthyes dhe lektorë, 1 institucion është përgjigjur se ka të punësuar tre përkthyes dhe lektorë, 2 institucione janë përgjigjur se kanë të punësuar katër përkthyes dhe lektorë, 3 institucione janë përgjigjur se kanë të punësuar pesë përkthyes dhe lektorë, 1 institucion është përgjigjur se ka të punësuar 22 përkthyes dhe lektorë dhe 18 institucione janë përgjigjur se nuk mund t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Përgjigjet e marra nga pyetja e gjashtë: *Në buxhetin e vitit 2020, a keni paraparë mjete financiare për përkthyes dhe lektorë të rinj?* 43 institucione janë përgjigjur se kanë paraparë mjete financiare, 96 institucione janë përgjigjur se nuk kanë paraparë mjete financiare, 4 institucione janë përgjigjur se nuk mund t'i përgjigjen kësaj pyetjeje dhe 41 institucione nuk kanë dhënë asnjë përgjigje në lidhje me këtë pyetje.

Përgjigjet e marra nga pyetja e shtatë: *Si mund t'ju ndihmohet për ta shpejtuar fazën e dytë të zbatimit të plotë të ligjit?* 21 institucione janë përgjigjur se kanë nevojë për ndihmën e AZGJ-së, 16 institucione janë përgjigjur se nuk kanë nevojë për ndihmën e AZGJ-së, 60 institucione nuk dhanë asnjë përgjigje në lidhje me pyetjen, 73 institucione janë përgjigjur se do të kërkojnë ndihmë nga AZGJ-ja në rast nevoje dhe 13 institucione janë përgjigjur se nuk mund t'i përgjigjen kësaj pyetjeje.

Nga gjithsej 183 përgjigje të marra: 131 institucione janë përgjigjur vetëm


në gjuhën maqedonase, 4 institucione janë përgjigjur vetëm në gjuhën shqipe, 48 institucione janë përgjigjur edhe në gjuhën maqedonase edhe në gjuhën shqipe[150].

150 Raporti i punës i Agjencisë së Zbatimit të Gjuhës së RMV-së për vitin 2019, Shkup, fq. 21-23, gjendet në internet në linkun:
https://apj.gov.mk/wp-content/uploads/2020/06/RAPORTI-2019-SHQIP-1.pdf.

2. Propozimi, debatimi, miratimi dhe hyrja në fuqi e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019

Në projektligjin e Përdorimit të Gjuhëve, të propozuar nga Qeveria e RMV-së në gusht të vitit 2017, mes të tjerash, thuhet se, në praktikën aktuale dhe në mospërputhjet e shfaqura gjatë zbatimit dhe fushëveprimit të rregulloreve ligjore, ekziston nevoja për ta përcaktuar më tej çështjen juridike që e rregullon përdorimin e gjuhëve, për shkak të së cilës, Qeveria e Republikës së Maqedonisë propozon ligj të ri për këtë. Zbatimi i Marrëveshjes Kornizë të Ohrit është i lidhur pazgjidhshmërisht me procesin e integrimit europian të vendit, siç dëshmohet nga seria e rekomandimeve të Këshillit të BE-së në vitet e fundit, të cilat e tregojnë nevojën për zbatim të plotë si gurthemel për ndërtimin e mëtejshëm të një shoqërie demokratike me karakter multietnik, si kornizë për sigurimin e së ardhmes së demokracisë në Maqedoninë e Veriut dhe mundësimin e zhvillimit të marrëdhënieve më të ngushta dhe më të integruara midis Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe strukturat euroatlantike. Në këtë aspekt, çdo vit, duke filluar nga vitet 2005-2006, qeveria përgatit plan të hollësishëm - Programin nacional për miratimin e ligjit të BE-së, i cili i përcakton të gjitha politikat kryesore, vendimet dhe rregulloret ligjore, si dhe dinamikat e tyre që kanë për qëllim afrimin e Maqedonisë së Veriut me Bashkimin Europian. Duke vepruar kështu, qeveria do të marrë parasysh procesin e stabilizim-asocimit, angazhimet e marra sipas Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit, si dhe detyrimet sipas dialogut për anëtarësimin në nivelin e lartë dhe prioritetet reformuese urgjente. Në seancën e 16-të të qeverisë, të mbajtur më 25.7.2017, u miratua Programi nacional për miratimin e ligjit të BE-së 2017-2019, i cili i përcakton të gjitha masat që qeveria i planifikon për zbatimin e tij brenda dy viteve të ardhshme, kur është paraparë miratimi i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, për të cilin numri i PPE-së 2017.0000.7414 është krijuar në mënyrë të përshtatshme, që rregullohet me nenin 76, paragrafi (1) të Rregullores së punës të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së

Veriut, sipas të cilit të gjitha dokumentet që lidhen me anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Europian, shënohen nën flamurin e Bashkimit Europian dhe numrin e materialit nga Programi për miratimin e ligjit të Bashkimit Europian. Duke marrë parasysh se ky projektligj është pjesë e procesit të integrimit europian, qeveria propozon që të përpunohet në pajtim me KREUN 10-a. Shqyrtimi i sesionit të trupit punues mbi projektligjin nën kompetencën e trupit kryesor punues për financat dhe buxhetin, projektligjin mbi kompetencën e trupit kryesor të punës për çështjet ekonomike dhe projektligjin që harmonizohet me ligjin e Bashkimit Europian, sipas Rregullores së punës të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut[151].



Стр. 10 - Бр. 7 Службен весник на Република Македонија 14 јануари 2019

188.

Врз основа на членот 75 ставови 1 и 2 од Уставот на Република Македонија, претседателот на Република Македонија и претседателот на Собранието на Република Македонија издаваат

У К А З

за прогласување на Законот за употреба на јазиците

Се прогласува Законот за употреба на јазиците,

што Собранието на Република Македонија го донесе на седницата одржана на 14 март 2018 година.

Број 08 - 263/1
14 март 2018 година
С к о п ј е

ПРЕТСЕДАТЕЛ
НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
д-р Ѓорге Иванов[1]

ПРЕТСЕДАТЕЛ
НА СОБРАНИЕТО НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
м-р Талат Џафери

Дека преписот е верен на оригиналот [illegible]


ЗАМЕНИК НА ГЕНЕРАЛНИОТ СЕКРЕТАР
НА СОБРАНИЕТО НА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА
[illegible] Ибрамми

[1] Указот за прогласување на Законот за употреба на јазиците се објавува без потпис на Претседателот на Република Македонија, д-р Ѓорге Иванов од следниве причини:

- Секој е должен да ги почитува Уставот и Законите (Член 51, став 2 од Уставот на Република Македонија);
- Претседателот на Републиката е должен да по потпишување указот за прогласување на законите вако истите повторно се усвоени со мнозинство гласови од вкупниот број пратеници (член 75, став 3 од Уставот на Република Македонија). Законот за употреба на јазиците е повторно усвоен со мнозинство гласови од вкупниот број пратеници на 32-та седница на Собранието на Република Македонија на ден 14.03.2018 година.
- Поради неизвршување на преземените обврски од страна на Претседателот на Републиката, д-р Ѓорге Иванов, а поради обврската од член 52 од Уставот на Република Македонија, Претседателот на Собранието е должен да го достави Законот за употреба на јазиците до Службен весник на Република Македонија за негово објавување.

Dekreti që shpall Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2018.

151 Shih më gjerësisht në Propozimligjin e Përdorimit të Gjuhëve, Qeveria e RMV-së, gusht 2017, f. 3.



L I GJ
PËR PËRDORIMIN E GJUHËVE

Neni 1

(1) Në tërë territorin në Republikën e Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik.

(2) Gjuhë tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve gjuha shqipe), gjithashtu është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i aj, në pajtim me këtë ligj.

(3) Në të gjitha organet e pushtetit shtetëror në epublikën e Maqedonisë, institucionet qendrore, dërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, entet dhe rganizatat, komisionet, personat juridikë që kryejnë utorizime publike në pajtim me ligjin dhe institucionet era, gjuhë zyrtare krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit saj është edhe gjuha që e flasin 20% e qytetarëve të epublikës së Maqedonisë dhe alfabeti i saj, në mënyrë të ërcaktuar me këtë ligj.

(4) Në njësitë e vetëqeverisjes lokale gjuha dhe alfabeti e shfrytëzojnë së paku 20% e qytetarëve është gjuhë yrtare, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj rilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe alfabeteve në të cilat asin më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e tëqeverisjes lokale, vendosin organet e njësive të

Ligji i Përdorimit të Gjuhëve i vitit 2019[152].

Lidhur me qëllimet themelore, me parimet e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, Qeveria e RMV-së, si propozuese e këtij ligji, thekson se qëllimi kryesor për miratimin e tij është përkthimi i qëndrueshëm i ndryshimeve kushtetuese në tekste ligjore, në lidhje me përdorimin dhe zbatimin e gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe alfabetin e saj. Ky ligj i rregullon njëkohësisht parimet, mënyrën dhe përgjegjësinë e institucioneve për ta mundësuar përdorimin zyrtar të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe përdorimin e alfabetit të saj vis a vis të së drejtës së qytetarëve për ta përdorur dhe zbatuar atë në procedurat zyrtare. Në të njëjtën kohë është i rregulluar përdorimi i gjuhëve të tjera që i flasin qytetarët e komuniteteve, të cilat janë më pak se 20%[153].

152 Ligji i Përdorimit të Gjuhëve, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 7/19 (14.01.2019), i qasshëm në:
https://www.slvesnik.com.mk/Issues/1c2c606e0a894e1ea3f2cd277ff6a1fa.pdf.

153 Më gjerësisht shih: Propozimligji i Përdorimit të Gjuhëve, Qeveria e RMV-së, gusht 2017, f. 4.

Projektligji për përdorimin e gjuhëve ishte në leximin e parë para deputetëve më 13 shtator 2017. 71 deputetë morën pjesë aktive në diskutimin e leximit të parë të tij, i cili përfaqësonte 59% të numrit të përgjithshëm të deputetëve në kuvend. Shikuar nga aspekti i përkatësisë politike të deputetëve që morën pjesë aktive në diskutim, analiza tregon se pak më shumë se gjysma e tyre ishin deputetë të VMRO-DPMNE-së dhe të koalicionit "Për një Maqedoni më të mirë", rreth 27% ishin nga koalicioni i udhëhequr prej LSDM-së, 8% prej BDI -së, 6% ishin deputetë të pavarur dhe rreth 3% ishin të Besës dhe të Aleancës për Shqiptarët. Atmosfera u polarizua gjatë debatit. Folësit kishin pikëpamje diametralisht të kundërta, si për nga aspekti i nevojës dhe i dobisë së ligjit të ri, po ashtu edhe nga ai i kushtetutshmërisë, i procedurës së miratimit dhe i cilësisë së përmbajtjes së tij. Megjithatë, për shkak të pjesëmarrjes së ulët të deputetëve të shumicës në pushtet, rreth 85% e deklaratave në leximin e parë kishin një konotacion negativ në lidhje me projektligjin e përdorimit të gjuhëve. Në këtë aspekt, ka vërejtje rreth 3% të deklaratave të deputetëve, të cilët nuk e mbështetën këtë projektligj duke theksuar se shumica parlamentare dhe qeveria e shmangën pjesëmarrjen në debat ose nuk iu përgjigjën pyetjeve. Në fjalimet e tyre 19 deputetë kërkuan në mënyrë eksplicite që ky projektligj të tërhiqej[154].

Deri në fund të janarit të vitit 2018, 35.569 amendamente u paraqitën në Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve. Ky numër i paraqitur është rekord në historinë e Kuvendit të RMV-së. Nga numri i përgjithshëm i amendamenteve, 35.563 janë paraqitur nga VMRO-DPMNE-ja, 4 nga LSDM-ja dhe 2 nga Besa. Rekordi i mëparshëm në ndryshimet e paraqitura ishte vendosur nga BDI-ja, e cila në vitin 2012, për Ligjin e Veteranëve, kishte paraqitur 15.451 amendamente. Pa praninë e deputetëve të VMRO-DPMNE-së dhe të koalicionit, më 11 janar të vitit 2018, me shumicë votash, Kuvendi i RM-së e miratoi Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve. Nga gjithsej 69 deputetë

154 Më gjerësisht, mbi analizën e debatit parlamentar dhe miratimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, shih: Aleksandra Jovevska Gjorgjeviq, "Analiza e debatit parlamentar mbi Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve", Instituti i Demokracisë "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS), 2019, f. 1-15.

të pranishëm në sallë, të gjithë votuan miratimin e ligjit, pa abstenime dhe pa asnjë kundër. Nga komunitetet joshumicë, 27 deputetë votuan për. Disa ditë më vonë, më 17 janar, kryetari i Republikës, Gjorge Ivanov deklaroi se nuk e nënshkroi dekretin për shpalljen e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, duke shpjeguar se ai u miratua pa debat publik, pa përfshirjen e akademisë dhe të opozitës. Aq më tepër, kryetari i atëhershëm Ivanov theksoi se flamuri europian ishte keqpërdorur gjatë miratimit të ligjit, i cili nuk ishte në frymën e ndërtimit të një shoqërie ndëretnike, domethënë ishte i padrejtë, shtypës dhe favorizon vetëm gjuhën shqipe. Kryetari Ivanov deklaroi se e kishte informuar me shkrim kuvendin për vendimin e tij, që mos ta nënshkruajë ligjin duke dhënë një shpjegim ligjor prapa vendimit, si dhe duke i nxitur deputetët që t'i kenë parasysh vërejtjet dhe të veprojnë me përgjegjësi[155].

Pas këtij vendimi të kryetarit të Republikës, ligji iu kthye Kuvendit për rishqyrtim dhe miratim. Pothuajse dy muaj më vonë, më 14 mars 2018, në një atmosferë të tensionuar, Ligji i Përdorimit të Gjuhëve u miratua për herë të dytë me 64 vota për, dhe asnjë kundër, si dhe asnjë abstenim. Gjithashtu 24 deputetë nga komunitetet joshumicë e votuan ligjin. Sipas nenit 75 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, kryetari i Republikës ka të drejtë t'ua kthejë ligjin deputetëve vetëm një herë, dhe nëse ai miratohet përsëri me shumicë votash, atëherë kryetari është i detyruar ta nënshkruajë dekretin. Pavarësisht nga kjo detyrë imperative, kryetari Ivanov nuk e nënshkroi dekretin për shpalljen e këtij ligji. Më 14 janar 2019, Ligji i Përdorimit të Gjuhëve u shpall në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe hyri në fuqi ditën e shpalljes së tij, vetëm me nënshkrimin e kryetarit të Kuvendit, Talat Xhaferi.

Në fakt, dekreti i shpalljes së Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve nr. 08-263 / 1 datë 14 mars 2018, përmban vetëm nënshkrimin e kryetarit të Kuvendit, Talat Xhaferi, si dhe nënshkrimin e zëvendëssekretarit të përgjithshëm të Kuvendit, Nexhbedin

155 Po aty.

Ibraimi, së bashku me vulën e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Ndërkaq, menjëherë pas mbiemrit të kryetarit të Republikës, Gjorge Ivanov ka vendosur fusnotën numër 1 me 3 rreshta, ku shënohet: dekreti për shpalljen e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve shpallet pa nënshkrimin e kryetarit të Republikës, Gjorge Ivanov për arsyet e mëposhtme:

- Të gjithë janë të detyruar të respektojnë kushtetutën dhe ligjet (neni 51, paragrafi (2)) i Kushtetutës së RMV-së;

- Kryetari i Republikës është i detyruar ta nënshkruajë dekretin për shpalljen e ligjeve nëse ato miratohen përsëri me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të përfaqësuesve (neni 75, paragrafi (3) i Kushtetutës së RMV-së). Ligji i Përdorimit të Gjuhëve u miratua me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve në seancën e 32-të të Kuvendit të RMV-së, më 14 mars 2018.

- Për shkak të mospërmbushjes së detyrimeve të mësipërme nga kryetari i Republikës, Gjorge Ivanov, si dhe për shkak të obligimit sipas nenit 52 të Kushtetutës së RMV-së, kryetari i Kuvendit është i obliguar që Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve t'ia dorëzojë "Gazetës Zyrtare të RMV-së" për shpallje[156].

Nga ana tjetër, kryetari i Republikës, Ivanov reagoi në një deklaratë se botimi i ligjit në këtë gazetë shkel nenin 75 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, ndërkaq shpallja e tij është bërë në mënyrë të paligjshme dhe ka bazë për ndjekje penale. Së këndejmi, Ndërmarrja Publike "Gazeta Zyrtare" deklaroi se shpallja e ligjit është në pajtim me kushtetutën dhe ligjet, duke cituar, ndër të tjera, nenin 52, paragrafi (2) të Kushtetutës, ku thuhet: me përjashtim, në ditën e shpalljes së tij, të cilin e përcakton Kuvendi[157].

156 Ligji i Përdorimit të Gjuhëve, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 7/19 (14.01.2019), faqja 10, më gjerësisht në:
https://www.slvesnik.com.mk/Issues/1c2c606e0a894e1ea3f2cd277ff6a1fa.pdf.

157 Më gjerësisht, mbi analizën e debatit parlamentar dhe miratimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, shih: Aleksandra Jovevska Gjorgjeviq "Analiza e debatit parlamentar mbi Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve", Instituti i Demokracisë "Societas Civilis" - Shkup (IDSCS), 2019, f. 1-15; Pellagija Stojançova, "Ligji i Gjuhëve, i shpallur në Gazetën Zyrtare, kushtetues apo jo?", 15.1.2019, Radio Europa e Lirë, më gjerësisht shih: https://www.slobodnaevropa.mk/a/29711038.html.

3. Përmbajtja e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019

Ligji i Përdorimit të Gjuhëve përmban 25 nene[158].

Neni 1 përcakton se në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, gjuhë zyrtare është maqedonishtja dhe alfabeti i saj cirilik. Gjithashtu, gjuhë tjetër që flitet së paku nga 20% e qytetarëve, është zyrtare dhe alfabeti i saj (shqip), në pajtim me këtë ligj. Në të gjitha organet qeveritare, shtetërore në Republikën e Maqedonisë, institucionet qendrore, ndërmarrjet publike, agjencitë, drejtoritë, institucionet dhe organizatat, komisionet, personat juridikë që ushtrojnë autoritet publik në pajtim me ligjin dhe institucionet e tjera, përveç maqedonishtes dhe alfabetit të saj gjuhë zyrtare është edhe ajo që flitet së paku nga 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe që përdoret alfabeti i saj, i përcaktuar me këtë ligj. Gjithashtu, në njësitë e vetëqeverisjes lokale, gjuha dhe alfabeti i përdorur së paku nga 20% e qytetarëve është zyrtare, përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik. Përdorimi i gjuhëve që fliten së paku nga 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, si dhe përdorimi i alfabeteve të tyre, vendoset nga organet e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Neni 2 përcakton se qytetarët kanë të drejtë ta përdorin ndonjërën nga gjuhët zyrtare të renditura, si dhe alfabetin e tyre, sipas nenit 1, paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji. Institucionet, sipas nenit 1, paragrafi (3) të këtij ligji, si dhe institucionet e tjera, janë të detyruara qytetarëve t'u mundësojnë që t'i përdorin dhe t'i zbatojnë ato gjuhë dhe alfabetet e tyre në çdo procedurë, si dhe t'i kryejnë ato procedura në gjuhët zyrtare dhe alfabetet e tyre. Në pajtim me të drejtën e qytetarëve për ta përdorur ndonjërën nga gjuhët zyrtare të përmendura në nenin 1, paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji në gjykatë, procedura administrative, përmbarimore, parahetimore dhe hetimore, penale dhe kundërvajtëse, proceset gjyqësore dhe jogjyqësore, procedura

158 Ligji për Përdorimin e Gjuhëve, "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut", nr. 7/19 (14.01.2019), i disponueshëm në linkun:
https://www.slvesnik.com.mk/Issues/1c2c606e0a894e1ea3f2cd277ff6a1fa.pdf.

për zbatimin e sanksioneve, si dhe procedurat e tjera të parashikuara sipas ligjeve të tjera, gjykatat, prokuroritë publike, si dhe të gjitha organet dhe institucionet e tjera, janë të detyruara ta mundësojnë përdorimin dhe zbatimin e ndonjërës prej gjuhëve zyrtare të përmendura në nenin 1, paragrafi (1) dhe (2) dhe alfabetet e tyre në to dhe në procedura të tjera. Në institucionet e përmendura në nenin 1, paragrafi (3) të këtij ligji të pushtetit qendror në Republikën e Maqedonisë, përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj, gjuhë zyrtare është edhe ajo që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe që e përdorin alfabetin e saj, në komunikim, përdorim dhe zbatim, në të gjitha procedurat e qytetarëve para organeve që e përbëjnë pushtetin qendror (Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Kryetari i Republikës së Maqedonisë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë, gjyqësori, prokuroria publike), Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë, Avokati i Popullit i Republikës së Maqedonisë, në procesin zgjedhor, arsim, shkencë, shëndetësi, kulturë, në zbatimin e kompetencave policore, në aktivitetin radiodifuziv, në noteriat, në përmbarim, në objektet e infrastrukturës, në evidencat e amzës, në dokumentet personale, në financa, në ekonomi, si dhe në fusha të tjera.

Neni 3 i referohet përdorimit të gjuhës nga zyrtarë të zgjedhur ose të emëruar në institucionet e përmendura në nenet 1 dhe 2 të këtij ligji. Respektivisht, ky nen përcakton se zyrtarët e zgjedhur ose të emëruar të institucioneve të përmendura në nenin 1, paragrafi (3) dhe nenin 2, paragrafi (3) të këtij ligji, si dhe institucionet e tjera me seli në Shkup ose në komunat në të cilat së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë tjetër përveç maqedonishtes, e përdorin gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik në komunikimin e tyre zyrtar, si dhe gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, nëse të paktën njëri nga zyrtarët e zgjedhur ose të emëruar, flet një gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja.

Neni 4 e rregullon çështjen e përdorimit të gjuhëve në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë. Respektivisht, sipas këtij neni, në punën e Kuvendit të Republikës së

Maqedonisë, gjuhë zyrtare është maqedonishtja dhe alfabeti i saj cirilik, si dhe gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetin e saj. Paragrafi (2) përcakton që një deputet, një zyrtar i zgjedhur ose i emëruar, i cili flet gjuhë tjetër përveç asaj maqedonase, e cila flitet nga të paktën 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, në seancë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe seancat e trupave punues, flasin gjithashtu në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë. Paragrafi (3) e rregullon përdorimin e gjuhëve nga një deputet kur ai drejton një seancë të kuvendit ose seanca të trupave punues. Respektivisht, sipas këtij paragrafi, deputeti i cili flet një gjuhë të ndryshme nga gjuha maqedonase të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë kur drejton një seancë të Kuvendit ose seanca të trupave punues, i drejton ato në atë gjuhë. Paragrafi (4) e përcakton që një deputet që flet gjuhë tjetër përveç asaj maqedonase dhe të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, i merr materialet në kohë, d.m.th. i dorëzon ato në gjuhën dhe alfabetin e saj, për t'i përdorur në një seancë të kuvendit ose seanca të trupave punues. Paragrafi (5) e përcakton që stenogramet nga seanca e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe nga seancat e trupave punues, si dhe materialet dhe dokumentet e tjera lëshohen dhe ruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetin e saj. Paragrafi i fundit i këtij neni i referohet shpalljes së ligjeve dhe akteve të tjera të miratuara nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë. Respektivisht, në pajtim me këtë paragraf, të gjitha ligjet dhe aktet e tjera të miratuara nga kuvendi, publikohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

Neni 5 rregullon përdorimin e gjuhëve në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë. Paragrafi (1) i këtij neni përcakton që në punën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, gjuhë zyrtare është gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, si dhe

gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabeti i saj. Sipas këtij neni, seancat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë zhvillohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik. Paragrafi (3) e përcakton se kur seancat e qeverisë, komisionet, si dhe kolegjiumi i përgjithshëm i sekretarëve shtetërorë kryesohet nga zyrtari i zgjedhur, ose i emëruar, i cili flet gjuhë tjetër nga maqedonishtja dhe e cila flitet nga së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, i udhëheq ata në atë gjuhë dhe në atë alfabet. Paragrafi (4) e përcakton që zyrtari i zgjedhur ose i emëruar, i cili flet gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja dhe të cilën gjuhë e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, në seancë qeveritare dhe në komisione, si dhe në kolegjiumin e përgjithshëm të sekretarëve shtetërorë, gjithashtu flet në atë gjuhë. Zyrtari i zgjedhur ose i emëruar, i cili flet një gjuhë tjetër përveç asaj maqedonase dhe të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, i merr materialet në kohë, respektivisht i dorëzon në gjuhën dhe alfabetin e saj, që t'i përdorë në seancë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, në komision ose në kolegjiumit të përgjithshëm të sekretarëve shtetërorë. Në bazë të paragrafit (6) stenogramet seancë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, në komision ose në kolegjiumit të përgjithshëm të sekretarëve shtetërorë si dhe materiale dhe dokumente të tjera lëshohen dhe ruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj. Paragrafi (7) i këtij neni i rregullon të gjitha aktet e miratuara nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë shpallen dhe publikohen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

Neni 6 e rregullon çështjen e përdorimit të gjuhëve në institucionet e përmendura në nenin 1, paragrafi (3) dhe nenin 2 paragrafi (3) të këtij ligji. Respektivisht, paragrafi (1) i këtij neni përcakton se institucionet e përmendura në nenin 1, paragrafi (3) dhe

nenin 2, paragrafi (3) të këtij ligji, si dhe të gjitha institucionet e tjera, janë të detyruara, me detyrë zyrtare, të sigurojnë përdorim, komunikim dhe procedura që zhvillohen në gjuhën e folur nga së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj, nëse personi, d.m.th. përfaqësuesi flet gjuhë që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë. Paragrafi (2) përcakton që të gjitha vendimet dhe aktet e tjera, si dhe letërnjoftimet që rrjedhin nga kompetenca e institucioneve të përmendura në nenin 1, paragrafi (3) dhe nenin 2, paragrafi (3) të këtij ligji, si dhe të gjitha institucionet e tjera janë në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj, nëse personi, d.m.th. përfaqësuesi flet gjuhë që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë. Paragrafi (3) përcakton se personi i zgjedhur ose i emëruar, i cili flet gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja, të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë, emrin personal në vendime dhe akte të tjera brenda kompetencave të institucioneve, të përmendura në nenin 1, paragrafi (3) dhe nenin 2, paragrafi (3) të këtij ligji, si të gjitha institucionet e tjera, e shkruan në gjuhën dhe alfabetin e saj. Gjithashtu, ky nen e përcakton që faqet e internetit të institucioneve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe përmbajtja e faqeve të internetit, përveç gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj, detyrimisht publikohen në gjuhën tjetër, përveç gjuhës maqedonase, të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në alfabetin e saj.

Neni 7 e rregullon çështjen e gjuhës së alfabetit të emrave të institucioneve të përmendura në nenin 1, paragrafi (3) dhe nenin 2, paragrafi (3) të këtij ligji. Respektivisht, në pajtim me këtë nen, emrat e institucioneve të përmendura në nenin 1, paragrafi (3) dhe nenin 2, paragrafi (3) të këtij ligji, si dhe të gjitha institucionet e tjera dhe njësitë e tyre rajonale në njësitë e vetëqeverisjes lokale, në të cilën të paktën 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase si dhe në Shkup, do të shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si

dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, ashtu si edhe në anglishte. Në zyrat rajonale të organeve të administratës shtetërore, që mbulojnë të paktën një njësi të vetëqeverisjes lokale, në të cilën së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë tjetër nga ajo maqedonase, emrat e zyrave do të shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20 % e qytetarëve dhe në alfabetin e saj. Në paragrafin (3) të këtij neni është paraparë që emrat sipas paragrafit (1) dhe (2), do të shkruhen me shkronja dhe madhësi të njëjtë në të dyja gjuhët zyrtare, sipas nenit 1, paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji. Gjithashtu, vulat e institucioneve të përmendura në nenin 1, paragrafi (3) dhe nenin 2, paragrafi (3) të këtij ligji dhe të gjitha institucionet e tjera me seli në Shkup ose në njësitë e vetëqeverisjes lokale, në të cilat së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga gjuha maqedonase, shkruhen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj. Shkronjat e vulave të përmendura në paragrafin (4) të këtij neni do të shkruhen me shkronja dhe madhësi të njëjtë në të dyja gjuhët zyrtare të përmendura në nenin 1, paragrafi (1) dhe (2) të këtij ligji. Në paragrafin (6) të këtij neni është paraparë që institucionet sipas paragrafit 1 të këtij neni, do të mundësojnë dhe do të kontribuojnë në punë për t'u përdorur, për t'u shfrytëzuar dhe për t'u zbatuar në mënyrë efektive, gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, si dhe gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabeti i saj.

Neni 8 e rregullon çështjen për gjuhën e pullave postare, e fletëpagesave, e raporteve fiskale të lëshuara nga institucionet e përmendura në nenin 1, paragrafi (3) dhe në nenin 2, paragrafi (3) të këtij ligji, faturat nga institucionet e përmendura në nenin 1, paragrafi (3) dhe neni 2, paragrafi (3) të këtij ligji dhe banderolat. Respektivisht, sipas këtij neni, ato janë të shkruara në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj. Pullat, fletëpagesat, raportet fiskale të lëshuara nga institucionet e përmendura në

nenin 1, paragrafi (3) dhe në nenin 2, paragrafi (3) të këtij ligji, faturat e institucioneve të përmendura në nenin 1, paragrafi (3) dhe në nenin 2, paragrafi (3) të këtij ligji, banderolat, shkruhen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj. Gjithashtu, kartëmonedhat dhe monedhat, si dhe pullat postare do të përmbajnë simbole që e paraqesin trashëgiminë kulturore të qytetarëve që e flasin gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe gjuhën që flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj. Paragrafi (3) përcakton që uniformat e policisë; zjarrfikësve; shëndetësisë; në Shkup dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale ku të paktën 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, janë të shkruara në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë dhe alfabetin e saj.

Neni 9 përcakton përdorimin e gjuhëve në gjykatë, në procedurat administrative, përmbarimore, në procedurat e ekzekutimit të sanksioneve, në procedurat parahetimore dhe hetimore, në procedurat penale dhe kundërvajtëse, në proceset gjyqësore dhe jashtëgjyqësore, si dhe në procedurat e tjera gjyqësore, në prokurorinë publike, në zyra dhe në të gjitha organet dhe institucionet e tjera. Në procedurat e përmendura përdoret gjuha maqedonase dhe alfabeti i saj cirilik, si dhe gjuha që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe që e përdorin alfabetin e saj. Të gjitha procedurat e përmendura në paragrafin (1) të këtij neni, do të mbahen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe në alfabetin e saj, nëse gjyqtari, prokurori publik, pala ose pjesëmarrësi tjetër në procedurë është person i cili e flet gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë. Gjithashtu, të gjitha vendimet, aktet e shkruara dhe aktet e tjera që rrjedhin nga procedurat e përmendura në paragrafin (1) të këtij neni, do të miratohen dhe lëshohen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së

paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj nëse gjykatësi, prokurori publik, pala ose pjesëmarrësi tjetër në procedurë, është person që e flet gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë. Paragrafi (4) i këtij neni përcakton se institucionet e përmendura në paragrafin (1) të këtij neni, janë të detyruara ta sigurojnë përkthimin e të gjitha dokumenteve dhe të materialeve të nevojshme, si dhe përkthimin e njëkohshëm të deklaratave dhe të dëgjimeve në punë ose në procedurat vijuese. Mossigurimi i përkthimit të të gjitha dokumenteve dhe të materialeve të nevojshme, përkatësisht mossigurimi i përkthimit të njëkohshëm gjatë tërë rrjedhës së procedurës, është një shkelje thelbësore e saj. Paragrafi (6) përcakton se emrat e institucioneve të renditura në paragrafin (1) të këtij neni në Shkup dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, janë të shkruara në maqedonisht dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj. Paragrafi (7) përcakton se në institucionet e përmendura në paragrafin (1) të këtij neni, në rajonin që përfshin disa gjykata themelore, prej të cilave së paku njëra gjendet në njësinë e vetëqeverisjes lokale, ku flitet gjuhë zyrtare e ndryshme nga maqedonishtja, por që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, emrat do të shkruhen gjithashtu në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj. Materia e shpenzimeve që bëhet nga përkthimi për palët dhe pjesëmarrësit në procedurë, si dhe shpenzimet për përkthyes gjyqësor që bëhen në zbatimin e dispozitave të këtij ligji, rregullohen në paragrafin (8) i cili përcakton se ato bien mbi institucionet e theksuara në paragrafin (1) të këtij neni.

Neni 10 rregullon përdorimin e gjuhëve në procedurat para noterëve dhe përmbaruesve. Në bazë të këtij neni, në procedurat para një noteri publik, dokumentet dhe vërtetimet noteriale mund të lëshohen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë

dhe në alfabetin e saj. Në procedurën para një përmbaruesi, nëse pjesëmarrësi është një person që e flet gjuhën të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, urdhëresat, konkluzat, procesverbalet, shënimet zyrtare dhe aktet e tjera të përmbaruesve lëshohen në maqedonisht dhe në alfabetin e saj, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në alfabetin e saj.

Neni 11 rregullon çështjen e përdorimit të gjuhëve në fushën e zbatimit të sanksioneve. Në të vërtetë, institucionet kompetente për menaxhimin e institucioneve për zbatimin e sanksioneve, si dhe institucionet kompetente për zbatimin e sanksioneve, janë të detyruara ta përdorin gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj në komunikim dhe në procedura, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20 % e qytetarëve dhe alfabetin e saj, nëse personi në fjalë e përdorë gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve në Republikën e Maqedonisë. Institucionet kompetente për menaxhimin e institucioneve për ekzekutimin e sanksioneve, si dhe institucionet kompetente për ekzekutimin e sanksioneve, janë të detyruara t'u mundësojnë personave që janë në to, t'u drejtohen në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj.

Neni 12 përcakton se evidencat e amzës në Shkup dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale, ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, mbahen në gjuhën zyrtare që e flet qytetari. Vendimet, certifikatat, vërtetimet si dhe aktet e tjera lëshohen në gjuhën zyrtare të folur nga qytetari. Dokumentet personale dhe pasaportat e qytetarëve, të cilët e përdorin gjuhën që e flasin së paku 20% e tyre dhe alfabetin e saj, lëshuar me detyrë zyrtare në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj.

Neni 13 rregullon materien e gjuhës dhe të alfabetit për shtypjen e formularit të letërnjoftimit. Në të vërtetë, për qytetarët që flasin gjuhë tjetër nga maqedonishtja,

të cilën e flasin më pak se 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, formulari i letërnjoftimit shtypet në gjuhën dhe në alfabetin e përdorur nga qytetari. Qytetarët që flasin gjuhë tjetër nga maqedonishtja, të cilën e flasin më pak se 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me kërkesën e tyre personale, të dhënat për emrin personal të shënuara në letërnjoftim, shkruhen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën dhe në alfabetin e përdorur nga qytetari.

Neni 14 rregullon materien e gjuhës dhe të alfabetit për shtypjen e formularit të pasaportës dhe të dokumentit të udhëtimit. Në të vërtetë, qytetarët që flasin gjuhë tjetër nga ajo maqedonase, të folur nga më pak se 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë së Veriut, me kërkesën e tyre, formulari i pasaportës shtypen në gjuhën dhe alfabetin e përdorur nga qytetari. Qytetarët që flasin gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja, e cila flitet nga më pak se 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me kërkesën e tyre, të dhënat në pasaportë shënohen në atë gjuhë dhe në atë alfabet. Qytetarët që flasin gjuhë të ndryshme nga maqedonishtja, të cilën e flasin më pak se 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, me kërkesë të tyre personale, të dhënat për emrin personal në dokumentet dhe në listën e udhëtimit, shënohen në gjuhën dhe në alfabetin e përdorur nga qytetari.

Neni 15 përcakton se në seancat e Komisionit Shtetëror të Zgjedhjeve dhe të komisioneve komunale të zgjedhjeve në Shkup dhe në njësitë e vetëqeverisjes lokale, ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë zyrtare të ndryshme nga maqedonishtja, gjatë mbajtjes së zgjedhjeve në punën dhe në procedurat e të gjitha komisioneve dhe organeve e institucione të tjera, e përdorin dhe e zbatojnë njëlloj gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, si dhe gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj.

Neni 16 përcakton se emri i një rruge, sheshi, ure dhe objekti tjetër infrastrukturor në të gjitha njësitë e vetëqeverisjes lokale, ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë tjetër të ndryshme nga maqedonishtja, si dhe në Shkup, shkruhet në gjuhën

maqedonase dhe në alfabetin e tij cirilik, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj, si dhe gjuhët e pranuara përgjithësisht nga bashkësia ndërkombëtare. Në pikat kufitare të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe në aeroportet që gjenden në rajonet ku së paku 20% e qytetarëve flasin gjuhë tjetër të ndryshme nga maqedonishtja, emrat e institucioneve, mbishkrimet e tjera dhe shenjat sinjalizuese të rrugëve, shkruhen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj cirilik, si dhe në gjuhën që flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj.

Neni 17 përcakton se të gjitha ligjet, aktet nënligjore, vendimet dhe njoftimet e institucioneve, sipas nenit 1, paragrafi (3) dhe nenit 2, paragrafi (3) të këtij ligji, të cilat shpallen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", do të publikohen në gjuhën maqedonase dhe në alfabetin e saj, si dhe në gjuhën që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe në alfabetin e saj.

Neni 18 përcakton se për arritjen e qëllimeve të këtij ligji, promovimi, mbrojtja dhe zbatimi uniform të gjuhës zyrtare të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetin e saj, themelohet Agjencia e Zbatimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, në cilësinë e personit juridik, kompetent për standardizimin dhe për përdorimin uniform të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetin e saj, me organe ndihmëse për mbështetjen e institucioneve sipas nenit 1, paragrafi (3) dhe nenit 2, paragrafi (3) të këtij ligji, si dhe të gjitha institucionet e tjera. Drejtori i Agjencisë zgjidhet nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë pas shpalljes së thirrjes publike me mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Përveç përkthyesve të certifikuar gjyqësorë, Agjencia punëson edhe gjuhëtarë dhe filologë të diplomuar të gjuhës shqipe, si dhe lektorë të licencuar. Drejtori përfaqëson Agjencinë, menaxhon punën e saj, kryen aktivitetet e përcaktuara me këtë ligj dhe miraton programin vjetor të punës së Agjencisë. Drejtori paraqet raport pune Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, së paku një herë në vit deri më 31 mars të vitit vijues për atë paraprak.

Fondet për punën dhe për funksionimin e Agjencisë sigurohen nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë.

Neni 19 i përcakton kompetencat e Agjencisë, si më poshtë: mbështetja e institucioneve në përmbushjen e detyrimeve sipas këtij ligji, duke përfshirë këtu përkthimin dhe lekturimin e dokumenteve; lekturimin e të gjitha akteve të shpallura në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë"; promovon dhe merr masa për përparimin e përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë; përgatit raporte për informimin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë lidhur me zbatimin e kompetencave të saj; për nevojat e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, për të përgatitur materiale eksperto-analitike, brenda kompetencës së saj; jep mendime ekspertësh për materialet që janë në funksion të zbatimit dhe të përparimit të përdorimit të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë; çështje të tjera që lidhen me realizimin e objektivave të përcaktuara me këtë ligj.

Një risi e rëndësishme që vendoset me këtë ligj është Inspektorati i Përdorimit të Gjuhëve. Në të vërtetë, me nenin 20 është përcaktuar se për mbikëqyrjen mbi zbatimin e plotë dhe të përpiktë të dispozitave të këtij ligji, që i referohen përdorimit të gjuhëve, krijohet Inspektorati i Përdorimit të Gjuhëve në suazat e Ministrisë së Drejtësisë, në cilësinë e personit juridik. Inspektorati do të rregullohet me ligj të veçantë.

Neni 21 përcakton se Qeveria e Republikës së Maqedonisë dhe të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e dispozitave të këtij ligji, do të miratojnë masa për të promovuar përdorimin e të gjitha gjuhëve zyrtare, si dhe për të garantuar mbrojtjen e gjuhëve të komuniteteve të tjera, gjuhë amtare e të cilëve nuk është zyrtare.

Neni 22 përcakton përgjegjësi kundërvajtëse dhe gjoba përkatëse.

Neni 23 përcakton afatet për detyrimet e disa subjekteve, të cilat duhet t'i

marrin për ta zbatuar ligjin. Në të vërtetë, është paraparë që në afat njëvjeçar nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjitha institucionet kompetente janë të detyruara t'i miratojnë aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji. Gjithashtu, është paraparë që në afat gjashtëmujor nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, institucionet janë të detyruara t'i zbatojnë detyrimet e përmendura në nenin 7 të këtij ligji. Qeveria e Republikës së Maqedonisë, menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zhvillojë një program për ngritjen e vetëdijes publike për zbatimin e këtij ligji. Gjithashtu, ky nen përcakton se brenda një viti dispozitat e ligjeve të tjera harmonizohen me dispozitat e këtij ligji. Në rast të mospërputhjes së dispozitave të këtij ligji me dispozitat gjuhësore të një ligji tjetër, organet janë të detyruara t'i zbatojnë dispozitat e këtij ligji.

Neni 24 përcakton se me miratimin e këtij ligji, Ligji i Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale, shfuqizohet ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 101/08 dhe 100/11).

Neni 25 rregullon çështjen e hyrjes në fuqi të këtij ligji, përkatësisht ky ligj hyn në fuqi ditën e shpalljes së tij në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

4. Analiza e aspekteve ligjore të kontestimeve kushtetuese të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019 në dritën e praktikës gjyqësore-kushtetuese dhe të së drejtës kushtetuese krahasimore

Me qëllim analizimi të aspekteve kushtetuese të kontestimeve të gjertanishme kushtetuese më të rëndësishme të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019 në publik, në dritën e praktikës aktuale gjyqësore-kushtetuese dhe të së drejtës kushtetuese krahasimore, lënda e kësaj analize do të ndahet në dy tërësi tematike: në pjesën e parë do të shtjellohen parimet e aspekteve të kontestuara procedurale dhe në pjesën e dytë do të shtjellohen parimet e aspekteve të kontestuara materiale në Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019.

4. 1 Për kontestimet e pretenduara procedurale të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019

Para së gjithash, për Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019, pretendimet u bënë publike se nuk ishte miratuar në pajtim me Rregulloren e Punës së Kuvendit të RMV-së dhe se nuk ishte në pajtim me ligjet e tjera ose me dispozitat ligjore të tjera. Në lidhje me pretendimet e tilla, duhet të merret parasysh se sipas praktikës aktuale gjyqësore-kushtetuese, çështje të tilla nuk janë në juridiksionin dhe fushëveprimin e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së, sepse ato shkojnë përtej kësaj dhe nuk janë çështje kushtetuese, dhe ajo nuk vendos për pajtueshmërinë e ligjeve me rregulloren e kuvendit, nuk është kompetente për ta vlerësuar pëlqimin e ndërsjellë të ligjeve në tërësi, si dhe pëlqimin e ndërsjellë të dispozitave të veçanta ligjore[159].

Aq më tepër, në lidhje me pretendimet se Ligji i Përdorimit të Gjuhëve i vitit 2019 nuk është miratuar me shumicën e kërkuar siç përcaktohet në Kushtetutën e RMV-së, duhet të merret parasysh fakti se, sipas amendamentit X, paragrafëve (1) dhe (2), (që është vendosur në pjesën III të kushtetutës kushtuar "Organizimit

159 Shih më gjerësisht në vendimet e mëparshme të Gjykatës Kushtetuese të RMV-së: Vendimi K. nr. 232/2008 të 25.11. 2009; Vendimi K. nr. 236/2008 nga 17.6.2009; dhe Vendimi K. nr. 42/2007 të 4.7.2007.

të pushtetit shtetëror" dhe në njësinë 1 që ka të bëjë me kuvendin dhe rregullohet mënyra e vendimmarrjes së kuvendit në seancat e tij):

1. Kuvendi mund të vendosë nëse shumica e numrit të përgjithshëm të përfaqësuesve është e pranishme në seancë. Ai vendos me shumicë votash nga deputetët e pranishëm dhe së paku me një të tretën e numrit të përgjithshëm të tyre, nëse kushtetuta nuk parasheh një shumicë të veçantë.

2. Për ligjet që prekin drejtpërdrejt kulturën, përdorimin e gjuhëve, arsimin, dokumentet personale dhe përdorimin e simboleve, kuvendi vendos me shumicë votash të deputetëve të pranishëm, gjatë së cilës patjetër duhet të ketë shumicë votash nga deputetët e pranishëm që u përkasin komuniteteve joshumicë në Republikën e Maqedonisë. Kontestin në lidhje me zbatimin e kësaj dispozite e zgjidh Komiteti i Marrëdhënieve ndërmjet Bashkësive.

Nga kjo rrjedh se, amendamenti X i cituar, paragrafi (2), e përcakton shumicën e nevojshme për miratimin e ligjit që ka të bëjë me përdorimin e gjuhëve dhe për këtë është përcaktuar shumica e votave nga të pranishmit, gjatë së cilës kjo dispozitë kushtetuese i konkretizon amendamentet V dhe XVIII të kushtetutës, për arsye se në mënyrë kushtetuese e autorizon kuvendin ta miratojë Ligjin e Përdorimit të Gjuhëve të bashkësive joshumicë, me shumicë votash nga deputetët e pranishëm, gjatë së cilës duhet të ketë shumicë votash nga deputetët e pranishëm, të cilët u përkasin bashkësive joshumicë në Republikën e Maqedonisë.

Më tej, në lidhje me Dekretin e shpalljes së Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019, duhet të merret parasysh se neni 75 i kushtetutës, në tërësi ka të bëjë me shpalljen e ligjeve si fazë e fundit e procedurës legjislative. Sipas nenit 75 të kushtetutës, ligjet shpallen me dekret. Dekreti i shpalljes së ligjeve nënshkruhet nga kryetari i republikës dhe nga kryetari i kuvendit. Kryetari i republikës mund të vendosë të mos e nënshkruajë dekretin e shpalljes së ligjit. Kuvendi sërish e shqyrton ligjin dhe nëse e miraton me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i

deputetëve, kryetari i republikës është i detyruar ta nënshkruajë dekretin. Kryetari është i detyruar ta nënshkruajë dekretin, nëse sipas kushtetutës, ligji miratohet me shumicën e dy të tretave të numrit të përgjithshëm të deputetëve.

Shpallja e ligjeve është kusht për hyrjen e tyre në fuqi. Njoftimi i paraprin shpalljes së ligjeve. Ligjet shpallen me dekret. Dekreti nënshkruhet nga kryetari i republikës dhe nga kryetari i kuvendit. Menjëherë pas miratimit të ligjit, kryetari i kuvendit ia paraqet atë kryetarit të republikës, me qëllim të nënshkrimit të dekretit për shpalljen e ligjit. Nëse kryetari i republikës vendos të mos e nënshkruajë dekretin e shpalljes së ligjit, ai i kthehet kuvendit për rishqyrtim, brenda 30 ditësh nga miratimi i tij.

Nga përmbajtja e normës kushtetuese të cituar është e qartë se kryetari i shtetit mund të vendosë që të mos e nënshkruajë dekretin e shpalljes së ligjit, ndërsa kryetari i kuvendit nuk e ka mundësinë e zgjedhjes dhe patjetër duhet ta nënshkruajë. Nëse kryetari i republikës vendos të mos e nënshkruajë ligjin, siç është vepruar në rastin konkret, ligji kthehet në kuvend për rishqyrtim, dhe nëse këtë e miraton me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve (shumica absolute), kryetari i republikës është i detyruar që ta nënshkruajë dekretin. Së këndejmi, shihet qartë se kusht themelor për miratimin e ligjit të kthyer është arritja e shumicës absolute për miratimin e tij, përkatësisht është e nevojshme që ai të marrë shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, që do të thotë se është e nevojshme 61 deputetë të votojnë në mënyrë të plotfuqishme për miratimin e tij, pas së cilit kryetari i republikës është i detyruar ta nënshkruajë dekretin.

Në të vërtetë, për shkak se Ligji i Përdorimit të Gjuhëve u vu përsëri në votim në seancën e kuvendit më 14 mars 2018, në pajtim me nenin 75, paragrafi (3) të kushtetutës, pas vetos paraprake nga kryetari i republikës, atëherë ky ligj mori më shumë legjitimitet dhe u miratua me shumicë absolute votash (64 deputetë, asnjë abstenim, asnjë kundër) dhe (24 deputetë që u përkasin bashkësive joshumicë), siç

përcaktohet në nenin 75, paragrafi (3) të kushtetutës, normë kjo e cila është imperative kushtetuese-juridike. Aq më tepër, amendamenti X, paragrafi (1) i kushtetutës përcakton se kuvendi vendos me shumicë votash nga deputetët e pranishëm, por së paku me një të tretën e numrit të përgjithshëm të deputetëve, vetëm nëse me kushtetutë nuk parashihet shumicë e veçantë. Në këtë rast, kushtetuta parasheh shumicë të veçantë, ndërkaq, në situatën juridike kjo është përcaktuar në nenin 75, paragrafi (3) të kushtetutës ku është shumicë absolute, përkatësisht konsensus i 61 deputetëve, gjatë së cilës konsiderohet se Ligji i Përdorimit të Gjuhëve është miratuar në mënyrë të plotfuqishme nga Kuvendi i RM-së.

Në vazhdim, në lidhje me shpalljen e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019, pas skadimit të afatit prej shtatë ditësh nga miratimi i tij, duhet të merret parasysh praktika e gjertanishme gjyqësore-kushtetuese, në të vërtetë: Vendimi K. nr. 56/2004, datë 29.9.2004, si dhe Vendimi K. nr. 175/2012, datë 13.2.2013. Për sa i përket kësaj, në arsyetimin e Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të RM-së K. nr. 56/2004, datë 29.9.2004, thuhet: *"Njëri nga qëllimet themelore të kushtetutës është vendosja e sundimit të së drejtës në sistemin e pushtetit. Ky parim kushtetues, sipas nenit 8 të kushtetutës, përcaktohet si vlerë themelore e rendit kushtetues. Sipas nenit 52, paragrafi (1) të kushtetutës, ligjet dhe rregullat e tjera shpallen para se të hyjnë në fuqi, ndërkaq, sipas paragrafit (2), ligjet dhe rregulloret e tjera shpallen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" më së voni shtatë ditë nga miratimi i tyre. Në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni të kushtetutës, ligjet do të hyjnë në fuqi më së herti ditën e tetë nga shpallja e tyre, por me përjashtim, gjë që e përcakton kuvendi, ditën e shpalljes së tyre. Duke u nisur nga dispozitat e theksuara kushtetuese, rrjedh se shpallja e ligjeve dhe e rregullave të tjera është në funksion të sigurimit të sundimit të së drejtës dhe të realizimit të lirive dhe të të drejtave të njeriut dhe të qytetarit, si supozim për sigurinë juridike të qytetarëve dhe të subjekteve të tjera juridike. Shpallja e ligjeve dhe e rregullave të tjera paraqet akt*

të vënies së tyre në shërbim të publikut. Si njëri nga elementet themelore të sigurisë juridike të qytetarëve, sado që shpallja e ligjeve dhe e rregullave të tjera nuk paraqet akt juridik, e kjo shkakton pasoja të tjera të shumta juridike nga akti i miratuar. Në të vërtetë, ligji, përkatësisht rregulla, me miratimin, promolgimin (nënshkrimin) dhe shpalljen e tij, bëhet akt i zbatueshëm (i përsosur). Duke marrë parasysh natyrën dhe rëndësinë e shpalljes së ligjeve dhe të rregullave të tjera, kushtetuta ka përcaktuar detyrim që ato të shpallen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë", si organ zyrtar i republikës. Dispozita për shpalljen e ligjeve dhe të rregullave të tjera në kushtetutë është paraparë që në kreun mbi liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe të qytetarit, në pjesën e garancive të lirive dhe të të drejtave themelore. Vetë fakti tregon se kushtetuta, për shpalljen e ligjeve dhe të rregullave të tjera, nuk qaset si çështje teknike, por si çështje që depërton thellë në garancitë kushtetuese të lirive dhe të të drejtave themelore. Kushtetuta, përveç përcaktimit të qartë në nenin 52 për shpalljen e ligjeve dhe të rregullave të tjera në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" më së voni në afat prej shtatë ditësh nga dita e miratimit të tyre, nuk normëzon asnjë pasojë kufizuese të shkaktuar nga momenti i përmbushjes së parimit të shpalljes, përkatësisht realizimin e prolonguar të shpalljes së rregullave, si kusht për fuqizimin dhe zbatimin e tyre juridik. Së këndejmi, përcaktimi kushtetues se shpallja duhet të bëhet në afat prej shtatë ditësh, nga miratimi i ligjeve dhe i rregullave të tjera, që nuk e normëzon ndërprerjen e veprimit juridik të rregullave të miratuara, të botuara pas kalimit të afatit në fjalë, ka si qëllim kryekëput përcaktimin kushtetues që të arrihet shpejtësia e matur në rrjedhën procedurale të shpalljes. Garancia kushtetuese për shpalljen e ligjeve dhe të rregullave të tjera, në të vërtetë u afirmua pikërisht në përcaktimin e kohës për arsye të intensifikimit të procedurës së shpalljes. Megjithatë, kjo garanci kushtetuese nuk cenohet nëse ligjet e miratuara dhe të shpallura dhe rregullat e tjera të përfshira në rendin juridik e kanë përmbushur parimin e shpalljes, me prolongimin e kohës së përcaktuar për të, nga dita e miratimit

të tyre, sepse akti i botimit si thelb i normës së theksuar kushtetuese, prapëseprapë është përmbushur. Duke u nisur nga vlerat themelore të rendit kushtetues të RM-së, lirive dhe të të drejtave themelore të njeriut dhe të qytetarit, si dhe ndarja e pushtetit në legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor, rrjedh se kushtetutëdhënësi, me përcaktimin se çështja e shpalljes së ligjeve dhe të rregullave të tjera, të jetë parim kushtetues i përfshirë pikërisht në pjesën e kushtetutës për garancitë e lirive dhe të të drejtave themelore, në mënyrë thelbësore e përcaktoi karakterin e tij që implikon marrje dhe jo kufizim ose zvogëlim të të drejtave të qytetarëve. Në të vërtetë, sipas gjykatës, realizimi i të drejtave dhe i lirive të qytetarëve dhe siguria juridike, si element i sundimit të së drejtës në rendin kushtetues, është determinuar nga rregullat të cilat kanë hyrë në fuqi në rendin juridik. Këto vlera kushtetuese do të viheshin në pikëpyetje nëse ndërpritet rrjedha e efektit juridik të rregullave të miratuara, të shpallura dhe të hyra në fuqi në rendin juridik, kryekëput për shkak të prolongimeve faktike të krijuara në afatin e shpalljes së tyre. Afati i përcaktuar kushtetutes i shpalljes nuk mund të pranohet se është normë kushtetuese me qëllim kufizues në raport me zbatimin e rregullave, të cilat janë botuar me prolongim në afat dhe kanë hyrë në rendin juridik, sepse kjo normë është pjesë e tërësisë së normave kushtetuese për garancitë e lirive dhe të të drejtave të qytetarëve, të cilëve, edhe në këtë rast, në mënyrë të pakontestueshme u sigurohet dhe u përmbushet e drejta e garantuar e shpalljes, për arsye të njohjes së ligjeve dhe të rregullave të tjera në rendin juridik"[160].

Në këtë kontekst dhe në shpjegimin e Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të RM-së nr. 175/2012, datë 13.2.2013, thuhet: *"Pas miratimit të ligjit, i dërgohet kryetarit të republikës për ta shpallur me dekret. Dekreti është akt i përgjithshëm deklarativ me të cilin kryetari i republikës i shpall ligjet. Dekreti është akt deklarativ për arsye se me anë të tij kryetari vetëm e deklaron (e dekreton) vullnetin e tij se ligjin e shpall ose*

160 Shih më shumë për këtë në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së, K. nr. 56/2004 datë 29.09.2004, në dispozicion në internet në lidhjen: http://ustavensud.mk/?p=8614.

nuk e shpall, pa hyrë në sferën legjislative të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë. Nëse kryetari i republikës vendos të mos e nënshkruajë dekretin e shpalljes së ligjit, ai kthehet në kuvendit për rishqyrtim, dhe nëse ai (kuvendi) e miraton ligjin me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve (shumica absolute), kryetari i republikës është i detyruar që ta nënshkruajë dekretin. Duke analizuar përmbajtjen e nenit 38 të kontestuar, paragrafi (2) të Ligjit të Kuvendit, i cili është zhvendosur në një kapitull të veçantë (XI) të ligjit me titull: "Nënshkrimi dhe shpallja e akteve", por në korelacion me lidhshmërinë e ndërsjellë dhe me koordinimin e dispozitave kushtetuese të lartpërmendura (neni 8, paragrafi (1), nënparagrafi 4), neni 52 dhe neni 75), gjykata vlerësoi se të gjitha këto norma është e domosdoshme të trajtohen në mënyrë sistemore si një tërësi, për arsye se ato korrespondojnë me përmbajtjen, madje edhe me titullin e nënndarjeve ku janë sistemuar. Gjatë analizës dhe zbatimit të tyre është marrë parasysh ndërlidhja e tyre e ndërsjellë, si dhe kushtëzimi i tyre. Sipas gjykatës, afati i parashikuar në dispozitën e kontestuar të nenit 38, paragrafi (2) të ligjit, në të cilin kryetari nënshkruan dekretin për shpalljen e ligjit ose përdorimin e së drejtës së vetos pezulluese, është në korrelacion dhe kushtëzim të ndërsjellë të nenit 75, paragrafi (3) dhe nenit 52, paragrafi (2) të kushtetutës. Në të vërtetë, kushtetuta bën dallim kohor ndërmjet miratimit, shpalljes, publikimit dhe hyrjes në fuqi të ligjeve. Nga normat kushtetuese del qartë se ligji është miratuar atëherë kur në kuvend (si subjekti i vetëm që miraton ligje, në pajtim me parimin e ndarjes së pushtetit shtetëror - neni 8, paragrafi (1), nënparagrafi 4), do ta marrë shumicën e nevojshme të votave. Por, për të filluar zbatimi i ligjit, ai medoemos duhet të hyjë në fuqi, të cilit i paraprin shpallja dhe publikimi në "Gazetën Zyrtare". Nga ana tjetër, nga përmbajtja e dispozitës kushtetuese të nenit 52, paragrafi (2) të kushtetutës, në mënyrë të prerë del se afati prej shtatë ditësh, nga miratimi e deri në shpalljen e ligjit, është afat në të cilin dekreti i shpalljes së ligjit duhet të nënshkruhet për t'u publikuar, përkatësisht afat në të cilin kryetari i republikës mund ta shfrytërojë të

drejtën e vetos pezulluese. Duke u nisur nga kjo që u tha, gjykata vlerësoi se sipas përmbajtjes, si dhe konsistencës, dispozita e nenit 38, paragrafi (2) të Ligjit të Kuvendit nuk hyn në të drejtën origjinare të përcaktuar kushtetuese të kryetarit për veton pezullese, as edhe, sipas vlerësimit vetjak, ligjvënësi cakton afat për shfrytëzimin e së drejtës së vetos, e cila do të paraqiste dalje nga korniza e përcaktuar me kushtetutë. Përkundrazi, norma e kontestuar juridike në tërësi e heq të drejtën kushtetuese të kryetarit për veton pezulluese sipas neni 75, paragrafi (3), si dhe afatin brenda të cilit mund të përdoret, ku është paraparë në nenin 52, paragrafi (2) të kushtetutës"[161].

4. 2 Për kontestimet e pretenduara materiale të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019

Së pari, në publik u përhapën konstatime në lidhje me pasaktësinë e pretenduar të emrit të *Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve, si dhe ky ligj në tërësi e barazon gjuhën tjetër që flitet së paku nga 20% e qytetarëve, me maqedonishten dhe alfabetin e saj cirilik*, si gjuhë zyrtare në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare.

Lidhur me këto pretendime, duhet të merret parasysh se, sipas praktikës së gjertanishme gjyqësore-kushtetuese, këto çështje nuk janë në kompetencën dhe në fushëveprimin e Gjykatës Kushtetuese të RM-së, sepse ato dalin jashtë kompetencës së saj, për shkak se ligjvënësi i krijon rregullat, i ndryshon dhe i plotëson, dhe njëherësh, nëpërmjet mekanizmave të tij, kryen edhe përmirësime dhe korrigjime teknike të rregullave që i miraton. Kjo do të thotë se në situatën konkrete, emri i Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve nuk është rregull juridike, me të cilën rregullohen marrëdhëniet midis personave juridikë, por përcaktohet emri i ligjit për arsye të identifikimit dhe të njohjes së rendint juridik në RM gjatë referimit të asaj, ku në rendin juridik do të ekzistonin dy ligje me emra të ndryshëm, ku bëhet dallimi

161 Shihni më shumë për këtë në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së, K. nr. 175/2012 e datës 13.02.2013, në dispozicion në internet në lidhjen: http://ustavensud.mk/?p=10942.

qartë, për përdorimin e cilës gjuhë ka të bëjë secili nga dy ligjet, përkatësisht Ligji i Përdorimit të Gjuhës Maqedonase dhe Ligji i Përdorimit të Gjuhëve, prandaj këto aspekte janë në kompetencë ekskluzive të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

Në këtë aspekt, në arsyetimin e Vendimit të Gjykatës Kushtetuese të RM-së nr. 119/2016, datë 7.2.2018, thuhet: *"Në pajtim me nenin 28, paragrafi (1) të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese, Gjykata Kushtetuese do ta hedhë poshtë nismën nëse nuk është kompetente të vendosë për kërkesën. Sipas nenit 1 të Ligjit të Prokurorisë Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 150/2007 të 12 dhjetorit 2007), me këtë ligj rregullohen kompetenca, themelimi, ndërprerja, organizimi dhe funksionimi i Prokurorisë Publike, bazat dhe procedurat e emërimit dhe shkarkimit të prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë, bazat e ndërprerjes së funksionit të prokurorit publik të Republikës së Maqedonisë, bazat e zgjedhjes dhe të shkarkimit të prokurorëve publikë, bazat e ndërprerjes së funksionit të prokurorit publik, si dhe çështje të tjera në lidhje me punën e Prokurorisë Publike. Në pajtim me nenin 4, paragrafët (1) dhe (2) të Ligjit të Akademisë së Gjykatësve dhe të Prokurorëve Publikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 20/2015 të 12 shkurtit 2015), akademia ka cilësinë e personit juridik dhe selia e saj është në Shkup. Ndërsa, në pajtim me nenin 5, paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji, akti themelor i akademisë është statuti i saj, me të cilin rregullohet: emri, organizimi i brendshëm dhe mënyra e ushtrimit të veprimtarisë së akademisë. Me iniciativë u kontestua: "neni 44, paragrafi (8), neni 49, paragrafi (1), neni 50, paragrafi (1), neni 56, paragrafi (4), neni 80, paragrafi (5), neni 95, paragrafët (1) dhe (2) në pjesën "trajnimi" të Ligjit të Prokurorisë Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 150/2007 dhe 111/2008) dhe neni 2 i Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Prokurorisë Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 111/2008), në pjesën:"trajnimi i" i Ligjit të Akademisë së Gjykatësve dhe të Prokurorëve Publikë, për arsye se, nga gazetat e botuara zyrtare, të cilat kanë të bëjnë me rregullën që i ka paraprirë Ligjit*

aktual të Akademisë së Gjykatësve dhe të Prokurorëve Publikë, ato nuk kanë qenë pjesë e përmbajtjes së emrit të akademisë, e cila ishte përcaktuar me ligj dhe e cila ishte në qarkullim ligjor, por që është theksuar në nenet e kontestuara të Ligjit të Prokurorisë Publike e që mund të shkaktojë huti në operacionalizimin e këtij ligji, ku diçka nuk ka qenë në pajtim me parimin kushtetues të sundimit të së drejtës. Ligji i parë që e rregullonte materien e funksionimit të Akademisë së Gjykatësve dhe të Prokurorëve Publikë, si institucion publik për pranimin dhe për përsosjen profesionale të kandidatëve për gjykatës dhe prokurorë publikë, qëllimi thelbësor i të cilit është trajnimi i vazhdueshëm dhe avancimi i profesionalizmit të gjykatësve dhe të prokurorëve publikë, si dhe i subjekteve që marrin pjesë në zbatimin e ligjeve në fushën e jurisprudencës, ishte Ligji i Akademisë "për trajnimin" e Gjykatësve dhe të Prokurorëve Publikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 13/2006). Ligji i lartpërmendur u shfuqizua me miratimin e Ligjit të Akademisë së Gjykatësve dhe të Prokurorëve Publikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 88/2010, 166/2012 dhe 26/2013), megjithatë edhe ky ligj u shfuqizua me miratimin e Ligjit "aktual" të Akademisë së Gjykatësve dhe të Prokurorëve Publikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 20/2015, 192/2015 dhe 231/2015). Ligjdhënësi gjatë rregullimit të përmbajtjes së nenit 44, paragrafi (8), nenit 49 paragrafi (1), nenit 50, paragrafi (1), nenit 56, paragrafi (4), nenit 80, paragrafi (5), nenit 95, paragrafët (1) dhe (2), në pjesën "trajnimi" të Ligjit të Prokurorisë Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 150/2007 dhe 111/2008) dhe nenit 2 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Prokurorisë Publike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 111/2008), në ligjin aktual, tek emri i ka përmendur edhe fjalët "trajnimi i", me çka shihet qartë se nga gazetat zyrtare të cituara, ku ka qenë i botuar teksti themelor i Ligjit të Akademisë së Gjykatësve dhe të Prokurorëve Publikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 20/2015), si dhe ndryshimet dhe plotësimet e mëvonshme të tij, fjalët e theksuara "trajnimi i" tek emri, nuk qëndrojnë. Ato fjalë

kanë qëndruar tek emri i ligjit të parë të miratuar në këtë fushë, i cili ishte Ligji i Akademisë së Trajnimit të Gjykatësve dhe të Prokurorëve Publikë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 13/2006). Parashtruesi me iniciativën e tij kërkon që Gjykata Kushtetuese, nëpërmjet mekanizmave kushtetuese, të bëjë korrigjimin e ligjit të cituar, duke e hequr pjesën e kontestuar: "trajnimi i" të përfshir në nenet e kontestuara në iniciativën sipas Ligjit të Prokurorisë Publike. Megjithatë, kjo është në kompetencën e ligjvënësit, i cili i krijon, i ndryshon dhe i plotëson rregullat, por njëherësh, nëpërmjet mekanizmave të tij, bën përmirësime dhe korrigjime teknike të rregullave të cilat i miraton. Duke i marrë parasysh kompetencat e përcaktuara të Gjykatës Kushtetuese sipas nenit 110 të kushtetutës, gjykata ka konstatuar se në rastin konkret janë plotësuar kushtet sipas nenit 28, nënparagrafi 1) të Rregullores së Gjykatës Kushtetuese, për hedhjen poshtë të iniciativës, për faktin se pretendimet kanë të bëjnë me kërkesën për veprim, e cila është në kompetencë të ligjvënësit, e jo të Gjykatës Kushtetuese"[162].

Më tej, në publik u shpërndanë konstatime *për mospajtimin e pretenduar të nenit 1, paragrafi (2) të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve në pjesën: "(gjuha shqipe)" dhe në pjesën: "në pajtim me këtë ligj"*, me amendamentin V të Kushtetutës së RM-së, si dhe me nenin 8, paragrafi (1), nënparagrafi 3), nenin 9 dhe nenin 51 të kushtetutës. Në lidhje me këtë, duhet të merret parasysh praktika e gjertanishme gjyqësore-kushtetuese, përkatësisht Vendimi i Gjykatës Kushtetuese të RM-së, nr. 57/2018, datë 31.3.2020.

Në këtë aspekt, në arsyetimin e Vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 57/2018, datës 31.3.2020 theksohet: *"Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë i është dorëzuar iniciativë për fillimin e procedurës së vlerësimit të kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë së nenit 7, paragrafi (2) të Statutit të Komunës së Strugës në pjesën*

162 Shihni më shumë për këtë në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së, K. nr. 119/2016 datë 07.02.2018, në dispozicion në internet në lidhjen: http://ustavensud.mk/?p=13070.

"përkatësisht gjuha shqipe dhe alfabeti i saj" e shënuar në pikën 1 të këtij vendimi. Sipas pretendimeve të parashtruesve të iniciativës, neni i kontestuar sipas Statutit të Komunës nuk ka qenë në pajtim me amendamentin V të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, si dhe me nenet 89 dhe 90 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale. Bartësit e iniciativës e citojnë përmbajtjen e nenit 7 të kontestuar, paragrafi (2) sipas statutit ku është përcaktuar: "Në komunë, gjuhë zyrtare, krahas maqedonishtes dhe alfabetit të saj cirilik, është edhe gjuha dhe alfabeti që e përdorin së paku 20% e banorëve të komunës, përkatësisht gjuha shqipe dhe alfabeti i saj", gjatë së cilës theksohet se dispozita e kontestuar, përkatësisht pjesa e fundit e fjalisë ku është theksuar "përkatësisht - gjuha shqipe dhe alfabeti i saj" është në kundërshtim me amendamentin V të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe me nenin 90, paragrafi (1) të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale dhe këto i citojnë. Më tej, sipas bartësve, me nenin 7, paragrafi (2) të Statutit të Komunës së Strugës, krahas gjuhës maqedonase dhe alfabetit të saj cirilik, edhe gjuha shqipe dhe alfabeti i saj bëhen zyrtare në Komunën e Strugës dhe barazohen me gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik, që është në kundërshtim me nenin 7 të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë dhe me nenet 89 dhe 90 të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale. Përveç faktit se është në kundërshtim me dispozitat e theksuara kushtetuese dhe ligjore, me nenin e kontestuar bëhet diskriminim i drejtpërdrejtë në bazë përkatësie nacionale të banorëve të Komunës së Strugës, të cilët janë pjesëtar të nacionaliteteve të tjera, përveç maqedonasve dhe shqiptarëve, për arsye se me këtë dispozitë u shkurtohet e drejta kushtetuese dhe ligjore dhe mundësia e të gjitha nacionaliteteve të tjera që jetojnë në Komunën e Strugës, nëse në të ardhmen do të përfaqësohen me mbi 20% nga numri i përgjithshëm i banorëve të komunës, në mënyrë që gjuha dhe alfabeti i tyre të bëhen zyrtare në Komunën e Strugës. Sipas bartësve të iniciativës, do të ishte e rëndësishme të theksohet se edhe nëse Ligji i Përdorimit të Gjuhëve miratohet dhe hyn në fuqi në të ardhmen, në komuna do të zbatohet Ligji i Vetëqeverisjes

Lokale, sepse është ligj i veçantë për komunat dhe dispozitat e tij i derogojnë, pra i përjashtojnë nga përdorimi dispozitat e ligjeve të tjera.

Gjykata në këtë seancë përcaktoi se më 27 shkurt 2018, Këshilli i Komunës së Strugës, në bazë të nenit 36, paragrafi (1), pika 1) të Ligjit të Vetëqeverisjes Lokale miratoi Statutin e Komunës së Strugës. Sipas nenit 7 të statutit në fjalë, gjuhë zyrtare në komunë është maqedonishtja dhe alfabeti i saj cirilik. Në komunë, krahas maqedonishtes dhe alfabetit të saj cirilik, gjuhë zyrtare është edhe gjuha dhe alfabeti që e përdorin së paku 20% e banorëve të komunës, përkatësisht gjuha shqipe dhe alfabeti i saj. Për përdorimin e gjuhëve dhe të alfabeteve, të cilën e flasin dhe e shkruajnë më pak se 20% e banorëve të komunës, vendos këshilli komunal.

Sipas nenit 8, nënparagrafi 3) të kushtetutës, sundimi i së drejtës është njëra nga vlerat themelore të rendit kushtetues të Republikës së Maqedonisë.

Sipas nenit 9 të kushtetutës, qytetarët e Republikës së Maqedonisë janë të barabartë për nga liritë dhe të drejtat pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, origjina kombëtare dhe shoqërore, bindjet politike dhe fetare, statusi pronësor dhe shoqëror. Qytetarët janë të barabartë para kushtetutës dhe ligjeve.

Në pajtim me amendamentin V, pika 1), paragrafi (1) të Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, gjuhë zyrtare është maqedonishtja dhe alfabeti i saj cirilik.

Në pajtim me paragrafin (2) të pikës 1) të këtij amendamenti, gjuhë tjetër të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve, po ashtu është gjuhë zyrtare dhe alfabeti i saj, siç përcaktohet me këtë nen.

Në paragrafin (6) të kësaj pike përcaktohet se në njësitë e vetëqeverisjes lokale, gjuhën dhe alfabetin të cilët i përdorin së paku 20% e qytetarëve, janë zyrtare, krahas maqedonishtes dhe alfabetit të saj cirilik. Për përdorimin e gjuhëve dhe të alfabeteve, të cilët i flasin dhe i shkruajnë më pak se 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, vendosin organet e njësive të vetëqeverisjes lokale.

Nga dispozitat e theksuara të amendamentit rrjedh se kushtetuta në parim parasheh në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare, se gjuhë zyrtare është maqedonishtja dhe alfabeti i saj cirilik. Megjithatë, si gjuhë zyrtare, krahas maqedonishtes, kushtetuta parasheh edhe gjuhë tjetër, me kusht që ta flasin së paku 20% e qytetarëve.

Duke u nisur nga përmbajtja e dispozitave të theksuara të amendamentit V të kushtetutës, rrjedh se në Republikën e Maqedonisë, gjuhë zyrtare është maqedonishtja dhe alfabeti i saj cirilik në gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë dhe në marrëdhëniet e saj ndërkombëtare. Kushtetuta e njeh edhe gjuhën tjetër që e flasin së paku 20% e qytetarëve, e cila gjithashtu është gjuhë zyrtare, së bashku me alfabetin e saj, e cila përdoret në mënyrën siç është përpunuar në amendamentin V të kushtetutës, në dispozitat e tjera kushtetuese dhe në ligjet përkatëse. Njëherësh, kushtetuta bazohet në sundimin e së drejtës, si njëra nga vlerat themelore të rendit kushtetues dhe barazisë së qytetarëve para kushtetutës dhe ligjeve pavarësisht nga gjinia, raca, ngjyra e lëkurës, origjina kombëtare dhe shoqërore, bindjet politike dhe fetare, statusi pronësor dhe shoqëror, si njëri nga parimet themelore të saj.

Me miratimin e Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 7/2019), u shfuqizua Ligji i Përdorimit të Gjuhës që e Flasin së Paku 20% e Qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe në Njësitë e Vetëqeverisjes Lokale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 101/08 dhe 100/11 (neni 24)).

Në nenin 1, paragrafët (2) dhe (4) të Ligjit të Përdorimit të Gjuhëve është paraparë:

(2) Gjuhë tjetër të cilën e flasin së paku 20% e qytetarëve (gjuha shqipe), gjithashtu është gjuhë zyrtare me alfabetin e saj, në pajtim me këtë ligj.

(4) Në njësitë e vetëqeverisjes lokale, gjuhën dhe alfabetin që e përdorin së paku 20% e qytetarëve, janë zyrtare, krahas maqedonishtes dhe alfabetit të saj cirilik.

Për përdorimin e gjuhëve dhe të alfabeteve, të cilët i flasin dhe i shkruajnë së paku 20% e qytetarëve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, vendosin organet e njësive të vetëqeverisjes lokale. Duke marrë parasysh këtë, në mënyrë të qartë dhe të pamëdyshur rrjedh se rregullimi i çështjeve për përdorimin e gjuhëve në punën dhe funksionimin e komunave, e në rastin konkret - në Komunën e Strugës, nuk cenohet thelbi i amendamentit V, pika 6) e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, në pikëpamje të nivelit dhe të legjitimitetit për rregullimin e kësaj çështjeje, për arsye të së cilës gjykata ka vlerësuar se nuk mund të shtrohet çështja për pajtueshmërinë e nenit të kontestuar të Statutit të Komunës së Strugës me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë, si dhe me ligjet e theksuara që e rregullojnë çështjen e mundësisë së përdorimit të gjuhëve të tjera zyrtare të qytetarëve të Republikës së Maqedonisë, të cilët i flasin, përkatësisht i përdorin së paku 20% e tyre.

Lidhur me pretendimet nga iniciativa se me nenin e kontestuar bëhet diskriminim i drejtpërdrejtë në bazë të përkatësisë kombëtare të nacionaliteteve të tjera (përveç maqedonasve dhe shqiptarëve), sepse me këtë dispozitë nuk do ta kishin të drejtën kushtetuese dhe ligjore për ta përdorur gjuhën e tyre, si zyrtare, dhe në rastin kur do të ishin më shumë se 20%, gjykata ka vlerësuar se janë të pabazuara. E drejta për të përdorur gjuhën e tyre në dispozitat e statutit, është pasqyrë e përfaqësimit real të pjesëtarëve të bashkësive. Nëse në të ardhmen në këtë komunë, sipas gjendjes së ndryshuar faktike, konstatohet se ka edhe popullatë tjetër e cila duhet ta përdorë gjuhën e saj si zyrtare, për shkak të përfaqësimit më shumë se 20% (turq, vlleh, serbë dhe të tjerë), kjo do të çonte në një ndryshim të nevojshëm të dispozitave statutore, por në këtë rast nuk ka nevojë të tillë[163].


Në fund të kësaj pjese, duhet nënvizuar se Ligji i Përdorimit të Gjuhëve të vitit 2019 në kuptimin kushtetues materialo-juridik është në pajtim me amendamentin V,

163 Shihni më shumë për këtë në Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të RMV-së, K. nr. 57/2018 e datës 31.03.2020, në dispozicion në internet në lidhjen: http://ustavensud.mk/?p=18941.

paragrafi (5) të Kushtetutës së RM-së ku është përcaktuar: "Në organet e pushtetit shtetëror të Republikës së Maqedonisë, gjuhë zyrtare e ndryshme nga maqedonishtja, mund të përdoret në pajtim me ligjin". Siç u theksua më lart, qëllimi kryesor për miratimin e këtij ligji është rrjedha e përpiktë e amendamenteve kushtetuese që lidhen me të drejtat gjuhësore në tekstet e ligjeve në lidhje me përdorimin dhe me zbatimin e gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve të Republikës së Maqedonisë dhe alfabetin e saj. Në të vërtetë, me këtë ligj paralelisht janë rregulluar parimet, mënyra dhe përgjegjësia e institucioneve për të mundësuar përdorimin zyrtar të gjuhës që e flasin së paku 20% e qytetarëve dhe alfabetin e saj kundrejt të drejtës së qytetarëve për ta përdorur dhe për ta zbatuar atë gjuhë në procedurat zyrtare. Njëherësh, rregullohet edhe përdorimi i gjuhëve të tjera në të cilat flasin qytetarët e bashkësive më pak se 20%. Gjithashtu, Ligji i Përdorimit të Gjuhëve i vitit 2019 është nevojë e domosdoshme për zbatimin e Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, e cila në mënyrë të pandashme është e lidhur me procesin e integrimit europian të RMV-së, për të cilën dëshmojnë një varg konkluzionesh të Këshillit të BE-së gjatë viteve të kaluara, të cilat tregojnë nevojën për zbatimin e plotë të tij si një gur themeli për ndërtimin e mëtejshëm të një shoqërie demokratike me karakter multietnik dhe shumëgjuhësor, si një kornizë për sigurimin e së ardhmes së demokracisë në Maqedoninë e Veriut dhe mundësimin e zhvillimit sa më të afërt dhe me marrëdhënie më gjithëpërfshirëse ndërmjet Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe NATO-s e BE-së.

Dhe krejtësisht në fund të kësaj pjese, konstatimet e pretenduara se udhëheqja e procedurave gjyqësore dhe të tjerave në gjuhën shqipe do ta bllokonte sistemin gjyqësor të RMV-së, duhet të merret parasysh faktin se bëhet fjalë për të drejtën e fituar gjuhësore, të garantuar që me Kushtetutën e RSM-së të vitit 1974, si dhe me Ligjin e Gjykatave të Rregullta të vitit 1976. Në të vërtetë, në Ligjin e Gjykatave të Rregullta "Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Maqedonisë", nr. 10/76 të 29.3.1976, në dispozitën e nenit 17 ishte përcaktuar: *"Në zonat e komunave ku jetojnë*

pjesëtarët e kombësive, nëse me statutin e komunës është paraparë përdorimi i gjuhës së një kombësie të caktuar, procedura para gjykatës komunale, që vepron në atë zonë, zhvillohet në gjuhën e asaj kombësie"[164].



СЛУЖБЕН ВЕСНИК
НА СОЦИЈАЛИСТИЧКА РЕПУБЛИКА МАКЕДОНИЈА

„Службен весник на СРМ" излегува по потреба. Рокописите не се враќаат. Огласи по тарифата.

Понеделник, 29 март 1976
Скопје
Број 10 Год. XXXII

Претплатата за 1976 година изнесува 350 динари. Овој број чини 8 дин. Жиро сметка 40100-601-123

89.

Врз основа на член 376, став 1, алинеја 6 од Уставот на Социјалистичка Република Македонија, Претседателството на Социјалистичка Република Македонија издава

УКАЗ
ЗА ПРОГЛАСУВАЊЕ НА ЗАКОНОТ ЗА РЕДОВНИТЕ СУДОВИ

Се прогласува Законот за редовните судови, што Собранието на Социјалистичка Република Македонија го донесе на одделни седници на Соборот на здружениот труд и Општествено-политичкиот собор, одржани на 16 март 1976 година.

Бр. 06-940
16 март 1976 година
Скопје

Претседател на Собранието на СРМ,
Благоја Талески, с. р.

Претседател на Претседателството на СРМ,
Видое Смиленски, с. р.


своите функции и на собранието на општината односно Собранието на Социјалистичка Република Македонија и другите државни органи и на самоуправните организации и заедници им даваат предлози за спречување на општествено-опасните и штетните појави и за зацврстување на законитоста, општествената одговорност и социјалистичкиот морал.

Судовите во рамките на својот делокруг имаат право и должност да го известуваат собранието на општината односно Собранието на Социјалистичка Република Македонија за примената на законите и за својата работа.

Стопанските судови, освен работите од став 1 и 2 на овој член, ги следат и односите и појавите што се од интерес за развојот на општествено-економските односи како и за правилното стопанско и финансиско работење на организациите на здружениот труд и другите самоуправни организации и заедници.

За своите ставови и оценки по прашањата што спаѓаат во делокругот на државните органи, организациите на здружениот труд и други организации и заедници, до кои дошле во работата, судовите имаат право и должност да ги известуваат тие органи, организации и заедници заради преземање

Ligji i Gjykatave të Rregullta, "Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Maqedonisë", nr. 10/76, datë 29.3.1976



Член 17

На подрачјата на општините на кои живеат припадници на народностите, ако со статутот на општината е предвидена употреба на јазикот на одделна народност, постапката пред општинскиот суд што дејствува на тоа подрачје се води и на јазикот на таа народност.

Neni 17 i Ligjit të Gjykatave të Rregullta, "Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Maqedonisë", nr. 10/76, datë 29.3.1976

4. 3 Vetoja presidenciale në të drejtën kushtetuese krahasimore

Vetoja presidenciale në Republikën e Maqedonisë së Veriut është rregulluar me dispozitën kushtetuese të nenit 75 të kushtetutës. Në të vërtetë, sipas nenit 75 të

164 Ligji i Gjykatave të Rregullta "Gazeta Zyrtare e Republikës Socialiste të Maqedonisë", nr. 10/76, datë 29.3.1976, Neni 17, në dispozicion në internet në lidhjen: https://www.slvesnik.com.mk/Issues/31C695CA2185400087F1918482D-D115A.pdf.

kushtetutës, ligjet shpallen me dekret. Dekreti për shpalljen e ligjeve nënshkruhet nga kryetari i republikës dhe kryetari i kuvendit. Kryetari i republikës mund të vendosë të mos e nënshkruajë dekretin për shpalljen e ligjit. Kuvendi e rishqyrton ligjin edhe nëse e miraton me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, kryetari i republikës është i detyruar ta nënshkruajë dekretin. Kryetari është i detyruar ta nënshkruajë dekretin, nëse sipas kushtetutës, ligji miratohet me shumicën e dy të tretave të numrit të përgjithshëm të deputetëve. Në të drejtën kushtetuese krahasimore, në lidhje me afatin për shpalljen e ligjeve nga ana e kryetarit të shtetit, ka afate më të shkurtra dhe më të gjata, duke filluar nga tri ditë deri në një muaj. Në këtë aspekt, si për shembull: në Mal të Zi ky afat është tri ditë, sipas dispozitës kushtetuese të nenit 94; në Hungari ky afat është pesë ditë sipas dispozitës kushtetuese të nenit 6; në Kosovë ky afat është tetë ditë sipas dispozitës kushtetuese të nenit 80; në Lituani (neni 71), Letoni (neni 69) dhe SHBA (neni 1, pjesa 7) ky afat është dhjetë ditë; në Rusi ky afat është katërmbëdhjetë ditë sipas dispozitës kushtetuese të nenit 107; në Serbi (neni 113), Bullgari (neni 88), Ukrainë (neni 94), Republikën Çeke (neni 50) dhe Francë (neni 10) ky afat është pesëmbëdhjetë ditë; në Shqipëri (neni 84) dhe Rumani (neni 77) ky afat është njëzet ditë; në Itali (neni 73) dhe Greqi (neni 42) ky afat është një muaj.

Në këtë kuptim, qëllimi kryesor i këtij afati shtatëditor është t'i japë Kryetarit të Republikës së Maqedonisë së Veriut një kohë të arsyeshme dhe të përshtatshme për të shprehur vullnetin e tij në lidhje me nënshkrimin e dekretit për shpalljen e ligjit, por jo edhe të shërbejë si mekanizëm sabotimi të punës së kuvendit si organ përfaqësues i qytetarëve dhe bartës i pushtetit kushtetutëdhënës dhe ligjdhënës nëpërmjet mundësisë që kryetari i republikës ta ngrijë ligjin për një periudhë më të gjatë kohore me qëllim që ligji të harrohet, sepse një gjë e tillë është në kundërshtim me thelbin dhe qëllimin e vetos presidenciale, sipas së cilës kryetari mund ta ngadalësojë ligjin, por nuk mund ta pengojë hyrjen e tij në fuqi, nëse kuvendi pas vetos së kryetarit sërish

mund ta miratojë ligjin me shumicën e nevojshme të përcaktuar me kushtetutë. Kjo ndodh për arsye se vetoja presidenciale sipas përkufizimit nënkupton të drejtën e kryetarit, brenda afatit të përcaktuar që ta kthejë ligjin, të miratuar një herë nga kuvendi, për shqyrtim dhe miratim të sërishëm, kur do ta vlerësojë si jokushtetues dhe jodobiprurës, por me kusht që të mos mund ta pengoj ligjin për të hyrë në fuqi nëse kuvendi e miraton përsëri me shumicën e nevojshme të votave të përcaktuara me kushtetutë[165].

Kjo është veçanërisht e rëndësishme sepse në Maqedoninë e Veriut ka mendime sipas të cilave nuk është përcaktuar ndonjë afat tjetër në të cilin kryetari i republikës është i detyruar ta nënshkruajë dekretin për shpalljen e ligjit, pasi kuvendi të shqyrtojë dhe miratojë sërish ligjin me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve[166]. Lidhur me këtë çështje, për të parandaluar fuqinë personale të kryetarit, si dhe bllokimi i ndryshimeve nga ana e shumicës së re parlamentare në pushtet, duhet theksuar se ai afat tjetër i dytë sipas analogjisë, si mjet interpretues për plotësimin e zbrazëtirave kushtetuese-juridike, duhet të jetë i njëjtë si afati i parë, përkatësisht shtatë ditë siç është përcaktuar me Ligjin e Kuvendit të vitit 2009, si afat i përgjithshëm ligjor për shpalljen e ligjeve në Maqedoninë e Veriut. Ky vendim lidhur me afatin e dytë rrjedh nga konteksti i dispozitave kushtetuese të neneve 75 dhe 52 të Kushtetutës së RMV-së, si dhe nga dispozita ligjore e nenit 38 të Ligjit të Kuvendit, sepse afati i parë prej shtatë ditësh nënkupton afati përfundimtar në të cilin kryetari e shpall ose nuk e shpall ligjin, që në të vërtetë nënkupton përdorimin e vetos, por nëse kuvendi e shqyrton dhe e miraton sërish ligjin me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i deputetëve, atëherë kryetari i republikës është i detyruar që brenda këtij afat prej shtatë ditësh ta shpallë ligjin, sepse nuk ka të drejtë kushtetuese për

165 Për më shumë për përkufizimin e vetos presidenciale, shihni: Darko Simoviq, Vlladan Petrov, E Drejta Kushtetuese, Beograd, 2018, f. 250.

166 Më gjerësisht shih: Vlladimir Mirçeski, Cili do të jetë fati i Ligjit për gjuhët? Analiza e opsioneve ligjore, 20.03.2018, në dispozicion në: https://360stepeni.mk/kakva-ke-bide-sudbinata-na-zakonot-za-j/.

të vendosur veton ndaj ligjit për herë të dytë. Kjo çështje është shumë e rëndësishme, për arsye se mungesa e këtij afati të përgjithshëm prej shtatë ditësh, në të vërtetë e përuron të drejtën e vetos së xhepit, që nënkupton veton absolute, e drejtë kjo që kushtetuta nuk ia përcakton Kryetarit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Vetoja e xhepit është e mundur vetëm atëherë kur në mënyrë eksplicite përcaktohet në tekstin kushtetues dhe si e tillë është e pranishme në formën e saj të pastër vetëm në Shtetet e Bashkuara. Vetoja e xhepit nënkupton situatën, kur projektligji iu dorëzua presidentit amerikan, për promolgim me më pak se dhjetë ditë të mbetura deri në fund të sesionit të kongresit. Kështu, presidenti amerikan mund ta fusë këtë projektligj në xhep dhe ai kurrë nuk do të bëhet ligj, sepse sipas kushtetutës amerikane, nëse presidenti nuk e kthen projektligjin e votuar brenda dhjetë ditësh (duke mos llogaritur të dielat) nga dorëzimi i tij, atëherë ai bëhet ligj njësoj sikur të ishte nënshkruar, përveç nëse kongresi nuk e pengon kthimin e tij duke e shtyrë punën e vet, në këtë rast ai nuk bëhet ligj[167]. Lidhur me këtë, duhet të theksohet edhe dallimi thelbësor, i cili konsiston në faktin se Kongresi i SHBA-së punon në sesione të caktuara, ndërkaq Kuvendi i RMV-së është në seanca të vazhdueshme[168].

